

DASHURIA PËR EHLI BEJTIN
DHE
VIRTYTET E TYRE NË KUR'AN DHE NË SUNNET

SEJJID TEKIJ JUSUF EL-HAKIJM

TIRANË, 2013

Titulli: **DASHURIA PËR EHLI BEJTIN**

Autori: **Sejjid Tekij Jusuf EL-HAKIJM**

E përktheu: **Vullnet MERJA**

E redaktoi: **Liseda RAMAJ**

E korrektoi: **Vullnet MERJA**

Përkujdesja kompjuterike: **Vullnet MERJA**

E botoi: **SHOQATA "FLLADI"**

FJALA E SHOQATËS

Falënderimi i përket Allahut, Zotit të botëve, paqja dhe bekimet qofshin mbi të Dërguarin e Allahut, zotërinë e krijesave dhe vulën e profetëve, Muhamedin dhe Ehli Bejtin e dlirë e të pastër.

Në të vërtetë, e drejta e të Dërguarit të madh për pasuesit dhe ndjekësit e tij është një e drejtë madhështore. Individët ndryshojnë në njohjen e tij dhe në nivelet e kryerjes së detyrimeve ndaj tij.

Nuk ka dyshim se dashuria për të është një nga të drejtat më primare, është prologu i domosdoshëm për atë që e ndjek atë në gjurmët e tij, prirjen e traditës së tij, ringjalljen e çështjes së tij dhe ndjekjen në mënyrë të përsosur dhe model të tij.

Përderisa nuk realizohet dashuria e vërtetë dhe e sinqertë, atëherë nuk mund të presim ndjekje, udhëzim dhe shembull.

Për këtë, Profeti ka thënë: "*Nuk do të më besojë ndonjëri prej jush, derisa të jem më i dashur sesa vetja e tij, prindi i tij, fëmija i tij dhe e gjithë njerëzia.*"

Me të vërtetë, dashuria ndaj tij është degë e dashurisë ndaj Allahut të Lartësuar. Që të dyja janë nga aksiomat e besimit dhe nga përparësitë e tij.

Po ashtu, dashuria ndaj Profetit duhet të shoqërohet me dashurinë ndaj njerëzve më parësorë e më të afërt të tij,

të cilët janë më të merituarit për mbartjen e amanetit dhe përhapjen e mesazhit të tij.

Me këtë plotësohen hallkat e domosdoshme të zinxhirit të dashurisë. Pa këtë nuk ka dashuri ndaj Allahut dhe ndaj të Dërguarit të Tij.

Për këtë, ai ka thënë: *"Duajeni Allahun për atë që ju ushqen nga begatitë e Tij. Më doni mua për hir të dashurisë ndaj Allahut dhe duajeni Ehli Bejtin tim për hir të dashurisë ndaj meje."*

Ehli Bejti i tij dhe njerëzit më me përparësi pas tij janë ata, të cilët i zgjodhi kur e urdhëroi Allahu i Lartësuar të ballafaqohej nëpërmjet lutjes për mallkim (*mubaheleh*) me të krishterët në thënien e Tij: **"Atyre që të kundërshtojnë ty për çështjen e Isait, pasi të ka ardhur njohuria, thuaju: "Ejani t'i thërrasim bijtë tanë dhe bijtë tuaj, gratë tona dhe gratë tuaja, veten tonë dhe ju vetë, pastaj, të lutemi që mallkimi i Allahut t'i godasë gënjeshtarët!"** (Surja "Ali Imran", ajeti 61)

Janë ata, të cilët i specifikoi në ajetin e pastrimit, në momentin që zbriti: **"…O Familje e Profetit! Në të vërtetë, Allahu do që ta largojë prej jush papastërtinë dhe t'ju pastrojë plotësisht."** (Surja "El-Ahzab", ajeti 33) Pastaj mantelin e tij e hodhi mbi veten e Tij, Aliun, Fatimen, Hasanin dhe Hysejnin e tha: *"O Zoti im! Këta janë Ehli Bejti, kështu që largoje prej tyre papastërtinë dhe pastroji ata plotësisht."*

Janë ata, të cilët i specifikoi me urdhrin për t'u falur, në momentin që zbriti thënia e Tij e Lartësuar: **"Urdhëro të afërmit e tu me namaz…"**

Kështu që në çdo agim shkonte dhe trokiste tek porta e Aliut e Fatimesë dhe thoshte: "Namazi, namazi…!" pastaj lexonte ajetin: **"…O Familje e Profetit! Në të vërtetë, Allahu do që ta largojë prej jush papastërtinë dhe t'ju pastrojë plotësisht."**

Janë ata, për të cilët na kanë urdhëruar që të dërgojmë salavate (bekime) për ta sa herë që përmendet emri i Profetit, i cili ka thënë: *"Thoni: 'Zoti ynë, bekoje Muhamedin dhe familjen e Muhamedit, ashtu siç bekove Ibrahimin dhe familjen e Ibrahimit."*

Kjo dashuri nuk ndahet nga sinqeriteti i pasimit, nga udhëzimi dhe ndjekja e udhëzimit të tyre. **"Nëse me të vërtetë e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, në mënyrë që t'ju dojë juve Allahu…"** Ashtu siç është dashuria prologu i parë i ndjekjes, si rrjedhojë, edhe ndjekja është kusht i domosdoshëm dhe vërtetim i sigurt i dashurisë së sinqertë. Përndryshe, është thjesht një thirrje e cunguar në kuptimin dhe qëllimin e saj.

Që këtu, dashuria për Ehli Bejtin e Profetit është një prolog i shembullit më të mirë të ndjekjes së tyre, ecjes në udhën e tyre dhe zbatimit të traditës së tyre.

Profeti Muhamed *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: *"Unë po ju lë juve dy gjëra. Nëse kapeni pas tyre, nuk keni për të humbur kurrë pas meje: Librin e Allahut dhe pasardhësit e mi, Ehli Bejtin tim."*

Pra, ajo dashuri, nga shenjat e së cilës është respekti ndaj tyre dhe animi i zemrës për t'i kujtuar ata, nuk është qëllimi i vetëm nëse nuk realizohen domosdoshmëritë dhe

vërtetësitë e kësaj dashurie në ndjekje të rrugës së tyre, të udhëzuarit me udhëzimet e tyre dhe mbrojtja e tyre.

Pa këto, ajo dashuri mbetet koncept i ngushtë, kuptimi i të cilit nuk e realizon synimin dhe qëllimin e saj.

Nga e gjitha kjo, del se dashuria për Allahun, dashuria për të Dërguarin e Tij dhe dashuria për Ehli Bejtin e të Dërguarit të Tij është një parim madhështor që përfshin dimensione të rëndësishme në jetën e individit dhe të shoqërisë.

Për më tepër, kjo dashuri është çelësi i marrëdhënieve të individit dhe të bashkësisë (ummetit) me mësimet qiellore. Këtë na e tregon Allahu i Lartësuar dhe i Dërguari i Tij.

Me këtë jemi urdhëruar, jo për shkak të afërsisë së mishit dhe gjakut të tyre me Profetin (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), por për fisnikërinë e tyre të lartë, ngaqë ata janë mbartës të diturisë së tij dhe përcjellës të amanetit të tij, më të zgjedhurit ndër njerëzit pas tij për nga fisnikëria, dituria, urtësia dhe udhëzimi.

Në këtë libër do të mundohemi të afrohemi sa më shumë drejt njohjes së tyre, njohjes së të drejtës së tyre ndaj nesh. E gjithë kjo është nga njohuritë e domosdoshme, me të cilat duhet të pajiset çdo mysliman.

Allahu qëndron pas qëllimit, Ai është Udhëzuesi për në rrugën e drejtë.

Shoqata "FLLADI"

HYRJE

Falënderimi i takon vetëm Allahut, Zotit të botëve! Bekimi më i mirë e paqja më e plotë qofshin mbi Muhamedin e zgjedhur e besnik dhe mbi familjen e tij të udhëzuar e të besës!

Në të vërtetë, dashuria për Ehli Bejtin, Pasardhësit e Profetit të zgjedhur, konsiderohet si një domosdoshmëri prej domosdoshmërive të padyshimta e të prera në fenë islame, në Libër (*Kur'an*) dhe në traditën profetike (*Sunnet*). Allahu i Lartësuar thotë: **"Nuk ju kërkoj për një gjë të tillë shpërblim, veçse dashuri për të afërmit."**

Në një hadith autentik të përcjellë nga Profeti Muhamed *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, thuhet: "*Duajeni Allahun për atë që ju ushqen nga begatitë e Tij. Më doni mua për hir të dashurisë ndaj Allahut dhe duajeni Ehli Bejtin tim për hir të dashurisë ndaj meje.*"

Dhe: "*Dashuria për ta është shenjë besimi dhe urrejtja për ta është shenjë hipokrizie.*"

Dhe: "*Ai që i do ata, e do Allahun dhe të Dërguarin e Tij dhe ai që i urren ata, e urren Allahun dhe të Dërguarin e Tij.*" E dhjetëra hadithe të tilla të cilat ftojnë për dashuri ndaj Ehli Bejtit dhe ndalojnë urrejtjen ndaj tyre.

Ajo që s'ka dyshim, është se i Lartësuari e obligoi dashurinë dhe dashamirësinë ndaj tyre përkrah obligimit të

kapjes me ta, sepse ata janë familja e dashurisë dhe e vilajetit për shkak të afërsisë së tyre tek i Lartësuari, pozitës së tyre tek Ai dhe pastërtisë së tyre prej idhujtarisë, politeizmit (*shirk*), mëkateve dhe prej çdo gjëje që i largon prej mejdanit të bujarisë e kënaqësisë së Tij.

Për këtë, dashuria ndaj Ehli Bejtit është një bindje, zanafilla e së cilës është Libri i Allahut të Lartësuar dhe Sunneti i (tradita e) Profetit të Tij të zgjedhur.

Dashuria ndaj tyre nuk është thjesht një dashuri kalimtare apo thjesht një ndjenjë, por është një princip që ka lidhje me dashurinë për udhëheqësit bartës të Mesazhit, të cilët Allahu i Lartësuar i bëri udhërrëfyes për njerëzinë pas Profetit të Tij fisnik *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

U dhuroi atyre cilësitë e përsosura si: trimëria, falja, sinqeriteti, dituria, urtësia dhe etika e morali. Ata i ka bërë porta të Tij udhërrëfyes të rrugës së Tij, bartës të diturisë së Tij, depozitë të njohurive të Tij, përcjellës të Shpalljes së Tij dhe të shtyllave të Njësimit (*teuhid*) të Tij.

Në të vërtetë, ai është një parim që lidhet me dashurinë ndaj një prej dy gjërave më të rënda, për të cilat i Dërguari ka urdhëruar umetin e tij që të kapet fort me ato të dyja deri sa të shkojnë te burimi i Keutherit.

I ka bërë amanet për banorët e Tokës, ashtu siç janë amanet yjet për banorët e qiellit.

Ata janë si varka e Nuhut: ata që hipën në të shpëtuan dhe ata që kundërshtuan u mbytën e u zhdukën.

Në këtë kërkim jemi përpjekur të hedhim dritë mbi disa aspekte të rëndësishme që janë specifike për dashurinë ndaj Ehli Bejtit, duke e konsideruar si detyrim nga ana jonë. Dhe kjo përmes pesë kapitujve:

Kapitulli i parë: Kush është Ehli Bejti?

Kapitulli i dytë: Dashuria ndaj tyre në Libër (Kur'an), Traditë Profetike (Synet) dhe letërsi

Kapitulli i tretë: Disa nga mirësitë e tyre në Libër dhe Synet

Kapitulli i katërt: Përfitimet nga dashuria për Ehli Bejtin

Kapitulli i pestë: Ehli Bejti ndërmjet teprimit "*el-guluv*" dhe urrejtjes (*el-bugd*)

Lusim Allahun e Lartësuar që t'u sjellë dobi me këtë vëllezërve besimtarë dhe ta bëjë këtë vepër të mirë për ne në këtë botë dhe pasuri në Jetën e Përtejme.

Allahu është Poseduesi i suksesit.

KAPITULLI I PARË

KUSH ËSHTË EHLI BEJTI?

KËRKIMI I PARË

Ehli Bejti në gjuhë dhe terminologji

Koncepti gjuhësor i fjalës ***ehl*** përcaktohet nga ajo që i shtohet asaj. Kështu ***ehlu'l-kura*** ka kuptimin 'banorët e fshatrave'; ***ehlu'sh-shej'*** ka kuptimin 'poseduesi i diçkaje', ***Ehlu'l-Kitab*** (Ithtarët e Librit) domethënë ndjekësit e tij ose lexuesit e tij.

E njëjta gjë është edhe për ***Ehlu't-Teurat*** dhe ***Ehlu'l-Inxhil*** (ithtarët e Teuratit dhe ithtarët e Ungjillit). Në Kur'an janë transmetuar disa nga këto terma.[1]

Ehlu'r-rexhul: Fisi dhe të afërmit e dikujt[2] dhe njeriu më i veçantë për të.[3] Gjithashtu, ata të cilët i bashkon lidhja farefisnore ose kauza fetare.[4] I Lartësuari ka thënë: **"Urdhëro të afërmit e tu me namaz!"[5]** Pra, të afërmit e tu dhe ata që kanë lidhje gjenealogjike me ty.

Dhe: **"O Nuh! Me të vërtetë, ai nuk është nga të afërmit e tu."[6]** duke folur për të birin e tij, pasi ai është nga të afërmit e tij, përsa i përket gjenealogjisë. Por i Lartësuari

---

[1] Shih *El-Enba bima fi Kelimati'l-Kur'ani min Edua* i Muhamed Xha'fer El-Kirbasij, f. 241-242. Menshuratu'l-Uifak, Nexhefi i bekuar.

[2] *El-Kamusu'l-Muhijt* i Mexhduddijn Fejruzabadit, 1: 331, lënda *ehl*, Muessesetu'r-Risale, Bejrut.

[3] *Lisanu'l-'Arab* i Ibn Mendhurit, 11: 28-29, lënda *ehl*, Edebu'l-Hauze, Kum.

[4] *Mufredatu'r-Ragib*, 29, fjala *ehl*. El-Mektbetu'l-Murtedauije.

[5] Surja "TaHa", ajeti 132.

[6] Surja "Hud", ajeti 46.

me këtë thënie do të thotë se ai nuk është nga ithtarët e fesë tënde, as nga bashkësia jote dhe as nga ata që ecin në rrugën tënde.

Ehlu bejti'r-rexhul: të afërmit e tij dhe ai që ka lidhje gjenealogjike me të.[7]

Është thënë në Kur'an për fëmijët e Ibrahimit dhe fëmijët e fëmijëve të tyre, ku i Lartësuari ka thënë: **"Mëshira e Allahut dhe bekimi i Tij qoftë mbi ju – familjen e të Dërguarit. Me të vërtetë, Ai është i Falënderuar dhe i Lavdëruar!"**[8]

Kështu pra, termi ***"Ehlu'l-Bejt"*** u bë i njohur ndërmjet myslimanëve për familjen e Profetit *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*[9] në zbatim të teksteve.

Ata, ashtu siç është transmetuar në Hadithin e Mbulojës (*Hadithu'l-Kisa*) e në të tjerë si ai, janë: Muhamedi - i Dërguari i Allahut, Imam Aliu, Zahraja, Hasani dhe Hysejni; për të gjithë këta zbriti Ajeti i Pastrimit: **"...O Familje e Profetit! Në të vërtetë, Allahu do që ta largojë prej jush papastërtinë dhe t'ju pastrojë plotësisht."**[10]

---

[7] *Mufredatu'r-Ragib*, 29, fjala *ehl*. El-Mektbetu'l-Murtedauije.

[8] Surja "Hud", ajeti 73.

[9] *Mufredatu'r-Ragib*, 64, fjala *bejt*.

[10] Surja "El-Ahzab", ajeti 33. Shih: *Sahihu Muslim*, Kitab Fadailu's-Sahabe 4: 1883/2424. *Sunenu't-Tirmidhij*, Kitabu't-Tefsijr, 5: 351/3205. *Mesabijhu's-Sunneh* i Bagaviut, 4: 183/4796. *Xhamiu'l-Usul*, 9: 155/6702, 6703, 6705. *Musnedi* i Ahmedit, 4: 107. *Mustedreku'l-Hakim*, 2: 416, dhe 3: 147-148.

Thuhet për ta, gjithashtu, ***Ãlu'n-Nebijj*** – familja e Profetit ose ***'itretuhu*** (pasardhësit e tij).

Fjala ***Ãl*** është shndërruar nga fjala ***Ehl***.[11] Kështu që thuhet Ãlu'll-llah dhe Ãlu Resulihi, pra *eulija*të e tij. Origjina e saj është ***Ehl***, e më pas, germa **He** u shndërrua në **hemze** dhe u bë në formën e **Aal** (أأل) dhe në momentin që u takuan dy **hemzet**, u shndërrua e dyta në **elif**.[12]

El-Itreh (pasardhësit) janë Ehli Bejti.

Ibn Mendhuri, duke e argumentuar thënien e tij me thënien e Profetit: "*Unë po ju lë juve dy gjëra të rëndësishme. Nëse kapeni për këto të dyja, nuk keni për të humbur kurrë pas meje: Librin e Allahut dhe pasardhësit e mi, Ehli Bejtin tim.*" Ka thënë: Profeti e ka përcaktuar *'itre*-n me Ehli Bejtin.[13]

Ka një dallim kur themi *ehlu'r-rexhuli* dhe *ehlu bejti'r-rexhuli*. Në gjuhësi, "ehlu'r-rexhuli" në mënyrë metaforike përdoret për bashkëshorten e tij. Zubejdiu në librin "***Taxhu'l-'Arus"*** ka thënë: "Prej metaforës është *ehlu'r-rexhuli* - bashkëshortja e tij."[14]

Ndërsa "ehlu bejti'r-rexhuli" janë të afërmit e shtëpisë së dikujt, janë ata që i bashkon lidhja gjenealogjike me të. Ky term përdoret gjerësisht për familjen e Profetit *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.[15]

---

[11] *Mufredatu'r-Ragib*, f. 30, (*Ãl*).

[12] *Lisanu'l-'Arab*, 1: 28- 29, (*Ehl*).

[13] *Lisanu'l-'Arab*, 9: 34, (*'atera*).

[14] *Taxhu'l-'Arus min Xhevahiri'l-Kamus* i Muhamed Murteda Ez-Zubejdij, 7: 217, fjala "ehl". El-Matba'atu'l-Khajrijeh, Egjipt, botimi I.

[15] *Mufredatu'r-Ragib*, 29, (*ehl*).

Së dyti: Ehli Bejti në terminologjinë e Librit (Kur'anit) dhe të Synetit

Ehli Bejti në gjuhën e Kur'anit dhe të Synetit ka kuptim të veçantë. Në të dyja këto burime qëllimi i fjalës Ehli Bejt është për të Dërguarin e Allahut, imam Aliun, Fatime Zahranë dhe dy zotërinjtë e të rinjve të Xhenetit, Hasanin dhe Hysejnin. Këta i pasojnë pasardhësit e pastër, të cilët janë nëntë imamët e pagabueshëm nga linja e Imam Hysejnit. Ata janë njerëzit më të afërt të Profetit *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e më të veçantët në lidhje me diturinë, më të diturit e fesë së tij dhe më të diturit e traditës dhe rrugës së tij.

Ekziston një grup i pasur transmetimesh të sakta nga Profeti nga të dy palët (sunnitë e shiitë) që deklarojnë qartë emrat e tyre[16], kjo përveç masivitetit (*tevatur*) të teksteve që janë transmetuar nga imamët paraardhës për pasardhësit e tyre tek imaminjtë.

Kjo përputhet në mënyrë të plotë me atë që transmetohet në *Dy Sahihet* nga Profeti *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* që ka thënë: "*Imamët janë dymbëdhjetë e që të gjithë janë prej Kurejshëve.*"[17]

Është specifikuar titulli *Ehlu'l-Bejt* vetëm për ta dhe për askënd tjetër, sado i afërt me Profetin që të jetë, qofshin këto gratë e tij, ndjekësit e tij apo të afërmit e tij.

---

[16] Shih: *Jenabiu'l-Meueddeh* i El-Kunduzi'l-Hanefijut, 3: 281/1, Daru'l-Usueh, botimi I.

[17] *Sahihu* i Buhariut, 9: 147/79, Babu'l-Istikhlaf. E botoi 'Alemu'l-Kutub, Bejrut, botimi 5; *Sahihu* i Muslimit, 4: 1883.

Kjo është ajo për të cilën ka folur Kur'ani, ka përmendur Syneti i pastër profetik dhe që kanë transmetuar sahabët (shokët, bashkëkohësit), tabiinët (ndjekësit e tyre) dhe transmetuesit e haditheve.

Është përcjellë nga Ummu Selemeja se kur zbriti ajeti: **"...O Familje e Profetit! Në të vërtetë, Allahu do që ta largojë prej jush papastërtinë dhe t'ju pastrojë plotësisht."** ajo ka thënë: *"I Dërguari i Allahut thirri Aliun, Fatimenë, Hasanin dhe Hysejnin dhe tha: "Këta janë Ehli Bejti im."*[18]

Transmetohet nga Aisheja e cila ka thënë: "Ka qenë burri më i dashur te i Dërguari i Allahut – duke aluduar për Imam Aliun. - E kam parë atë duke e futur poshtë mantelit të tij bashkë me Fatimen, Hasanin dhe Hysejnin, pastaj tha: *'O Zoti im. Këta janë Ehli Bejti im.'"*[19]

Transmetohet nga Imam Aliu se kur ka zbritur Ajeti i Pastrimit, i Dërguari i Allahut *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: *"O Ali, ky ajet ka zbritur për ty, për dy nipat e mi dhe për imamët nga djali yt."*[20]

Përveç sa u tha, qëllimi nga fjala ***Bejt*** në termin *Ehlu'l-Bejt* nuk është banesa, por qëllimi është për shtëpinë e Mesazhit, pra, shtëpia profetike dhe Ehli Bejti.

---

[18] *El-Mustedrek 'ala's-Sahijhejn*, 3:158/4705; *Es-Sunenu'l-Kubra* i Bejhakiut, 7: 63.

[19] Biografia e Imam Aliut nga *Tarijkhu Medineti Dimashk*, 2: 163-164/642. *Shevahidu't-Tenzijl li Kaua'idi't-Tafdijl* i El-Hakim El-Hasekanij, 2: 61/682–684, Mexhma'u Ihjai'th-Thekafeti'l-islamijeh, botimi I. *'Umdetu 'Ujun Sihahi'l-Ahkbar fi Menakibi Imami'l-Ebrar* i Ibn Batrijkut, 40/23, Muessesetu'n-Neshri'l-Islamij, Kum.

[20] *Kifajetu'l-Ether fi'n-Nassi li'l-Eimmeti'l-Ithnej'asher* i Ebu'l-Kasimi'l-Khazzaz Er-Razij, f. 156, Muessesetu'n-Neshri'l-Islamij, Kum.

Ata janë ata të cilët u edukuan dhe ngjitën shkallët e tyre në krahët e Mesazhit, u rritën në shtëpinë e pastërtisë e të diturisë, njohën çdo të vogël e të madhe, njohën çdo fragment dhe transmetim. Kjo është arsyeja që i gjen ata t'i përgjigjen çdo çështjeje që u drejtohej atyre në të gjitha aspektet e fesë e të shkencave të saj. Këtë nuk e gjen tek të tjerët, sado njohuri e dituri të kenë patur.

Transmetohet se kur i Dërguari i Allahut *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, ka lexuar thënien e Allahut Lartësuar: **"Në shtëpitë, që Allahu ka urdhëruar të ngrihen e të përmendet aty emri i Tij…"**[21] është pyetur: *"Cilat shtëpi janë këto?"* Ka thënë: *"Shtëpitë e profetëve."* Ebu Bekri i ka thënë: *"O i Dërguari i Allahut, kjo shtëpi është prej tyre?"* – nënkuptonte shtëpinë e Aliut dhe të Fatimesë. *"Po, prej më të preferuarave të tyre."*- i ka thënë Profeti.[22]

Transmetohet nga prijësi i besimtarëve *(paqja qoftë mbi të!)* i cili ka thënë: *"Ne jemi shtëpia e profetësisë, minerali i urtësisë, siguri për banorët e Tokës dhe shpëtimtarë të atyre që kërkojnë shpëtim."*[23]

Imam Hysejni *(paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: *"Me të vërtetë, ne jemi shtëpia e profetësisë."*[24]

---

[21] Surja "En-Nur", ajeti 36.

[22] *Ed-Durru'l-Menthur*, 5: 50. Tefsiri *"Ruhu'l-Me'anij"* i Alusijut, 18: 174. *Sheuahidu't-Tenzijl*, 1: 567-568.

[23] *Nethru'd-Durer*, 1: 310.

[24] *Maktelu'l-Imami'l-Husejn* i Khavarizmiut, 1: 184. Mektebetu'l-Mufijd, Kum. *El-Lehuf fi Katla't-Tufuf* i Ibn Tavusit, f. 10, Mektebetu'd-Dauerij, Kum.

KËRKIMI I DYTË

Ehli Bejti në Ajetin e Purifikimit (pastrimit)

Me Ajetin e Purifikimit (*Ajetu't-Tat'hir*) synohet thënia Allahut të Lartësuar: **"…O Familje e Profetit! Në të vërtetë, Allahu do që ta largojë prej jush papastërtinë dhe t'ju pastrojë plotësisht."**[25]

Burimet e hadithit dhe të komentimit të Kur'anit përforcojnë se qëllimi me Ehli Bejtin, për të cilët ka zbritur ky ajet, janë: i Dërguari i Allahut, Muhamedi *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, Ali ibn Ebi Talibi, Fatime Zahraja dhe dy nipat, Hasani dhe Hysejni *(paqja e Allahut qoftë mbi të gjithë ata!)*.

Muslimi ka përcjellë në *Sahihun* e tij me zinxhir tek Aishja e cila ka thënë: "Doli Profeti sapo u zgjua nga gjumi dhe kishte veshur një gunë leshi të zezë. Në këtë moment, erdhi Hasani, i biri i Aliut, pastaj erdhi Hysejni, Fatimeja dhe Aliu e pastaj tha: **"…O Familje e Profetit! Në të vërtetë, Allahu do që ta largojë prej jush papastërtinë dhe t'ju pastrojë plotësisht."**[26]

E ka përmendur këtë transmetim Fakhruddin Er-Razij në *Tefsirin* e tij dhe më pas ka thënë: "Dije se për

[25] Surja "El-Ahzab", ajeti 33.
[26] *Sahihu* i Muslimit, Kitabu Fadaili's-Sahabe, 4: 1883 / 2424.

vërtetësinë e këtij transmetim janë dakord dijetarët e hadithit dhe komentuesit."[27]

Tirmidhiu ka nxjerrë në librin e tij *"Es-Sunen"* nga Ummu Seleme se Profeti mbuloi Hasanin, Hysejnin, Aliun dhe Fatimenë me mantel dhe tha: *"O Zoti im! Këta janë Ehli Bejti im dhe të afërmit e mi të ngushtë! Largoji prej tyre papastërtitë dhe pastroji plotësisht ata!"* I thotë Ummu Selemeja: *"Po unë, a jam me ta, o i Dërguari i Allahut?"* I tha: *"Me të vërtetë, ti je në të mirë."*[28]

Hakimi ka nxjerrë në librin e tij *"El-Mustedrek"* nga Ummu Selemeja, e cila ka thënë: "Në shtëpinë time ka zbritur: **"…O Familje e Profetit! Në të vërtetë, Allahu do që ta largojë prej jush papastërtinë dhe t'ju pastrojë plotësisht."** I Dërguari i Allahut thirri Aliun, Fatimenë, Hasanin dhe Hysejnin e tha: *"Këta janë Ehli Bejti im."*

Hakimi ka thënë: "Ky hadith është i saktë, sipas kushtit të Buhariut dhe nuk e kanë cituar ata të dy (Buhariu e Muslimi)."[29]

Është transmetuar nga Uathile ibnu'l-Eska' i cili ka thënë: "Shkova tek Aliu, por nuk e gjeta atë. Fatimeja më tha: "Shkoi tek i Dërguari i Allahut; ai e thërriti atë!" Ndërkohë, Aliu erdhi me të Dërguarin e Allahut e hynë që të dy. Edhe unë hyra bashkë me ta. I Dërguari i Allahut thërriti Hasanin dhe Hysejnin, duke e ulur secilin prej tyre

[27] *Et-Tefsiru'l-Kebijr*, 8: 85 tek ajeti 61 i sures "Ali Imran".
[28] *Sunenu't-Tirmidhij*, 5:351/3205, Kitabu't-Tefsijr, 5: 663/3787, 669/3871, Kitabu'l-Menakib.
[29] *El-Mustedrek 'ala's-Sahijhejn*, 3: 146.

në prehërin e tij. Pastaj, afroi Fatimen dhe Aliun tek kraharori i tij, i mbështolli ata me një rrobë dhe tha: **"...O Familje e Profetit! Në të vërtetë, Allahu do që ta largojë prej jush papastërtinë dhe t'ju pastrojë plotësisht."** Pastaj tha: *"Këta janë Ehli Bejti im. O Allah! Ehli Bejti im kanë më shumë të drejtë."* Hakimi ka thënë: "Ky hadith është i saktë, sipas kushteve të dy shejhëve (Buhariut dhe Muslimit) dhe ata nuk e kanë cituar atë.[30]

Hadithi i Mbulesës (*Hadithu'l-Kisa*) mes transmetuesve dhe burimeve

Transmetuesit e hadithit nga të dyja grupet:

Hadithin e Mbulesës, sqaruesin e Ajetit të Pastrimit, e kanë transmetuar në librat e Ehli Sunnetit një grup i madh prej sahabëve dhe tabiinëve, duke vërtetuar zbritjen e ajetit për pesë pjesëtarët e mbulesës.

Ndër transmetuesit janë: Enes ibn Maliku, Berae ibn 'Azibi, Theubani, Imam Hasani El-Muxhteba *(paqja qoftë mbi të!)*, Ebu'l-Hamra, Hakijm ibn Sa'di, Hamad ibn Selemeh, Dihjeh ibn Khalife El-Kelbij, Ebu'd-Derdai, Zejd ibn Erkami, Zejneb bint Ebi Selemeh, Sa'd ibn Ebi Uekasi, Ebu Said El-Khuderij, Ummu Selemeja, Sheddad ibn 'Ammari, Shehr ibn Haushebi, Aisheja, Abdullah ibn Xha'feri, Abdullah ibn Abbasi, Abdullah ibn Mu'ijni, 'Ata ibn Ebi Rebah, 'Ata ibn Jesari, 'Atije El-Aufij, Imam Ali ibn Ebi Talibi, Imam Ali ibn Hysejni (Zejnu'l-Abidijni), Umer ibn Ebi Seleme, 'Amretu

[30] *El-Mustedrek*, 3: 146-147.

bint Ef'a, Katadeja, Muxhahid ibn Xhebr El-Mekkij, Muhamed ibn Seukah, Ebu Muaddel Et-Tafauij, Ma'kil ibn Jesari dhe Uathile ibn El-Eska'[31]…etj.

Komentuesit dhe muhadithët shiitë e transmetojnë nga prijësi i besimtarëve, Imam Aliu dhe djali i tij, Imam Hasani, nga Imam Ali ibn Hysejn Zejnu'l-Abidijni, nga Imam Muhamed ibn Ali El-Bakiri, nga Imam Xha'fer ibn Muhamed Es-Sadiku dhe nga Imam Ali ibn Musa Er-Rida.

Këtë hadith e kanë transmetuar, gjithashtu, nga Ebu'l-Esued ed-Duelij, Enes ibn Malik, Xhabir ibn Abdil'lah el-Ensarij, Ebu'l-Hamra, Ebu Dherr el-Gifarij, Sa'd ibn Ebi Uekasi, Ebu Said el-Khudrij, Ummu Selemeja, Shehr ibn Hausheb, Aishja, Abdullah ibn Abbasi, 'Ata ibn Jesari, 'Atije el-'Aufij, Ali ibn Zejdi, Umer ibn Mejmun el-Eudij, Uathile ibnu'l-Eska' etj.[32]

---

[31] Shih te *Musnedi* i Ahmedit, 2: 18, 3: 285 e 359 dhe 6: 292, 296, 298, 304, 323. *Tefsiri* i Tabariut, 22: 5-7, i cili e ka transmetuar atë nga katërmbëdhjetë rrugë. *Tefsiri* i Kurtubiut, 14: 182. *Tefsiri* i Ibn Kethirit, 3: 492-495, i cili e ka transmetuar nga nëntëmbëdhjetë rrugë. E*l-Bahru'l-Muhijt*, 7: 228. *Ed-Durru'l-Menthur*, 5: 198-199. *Fet'hu'l-Kadijr*, 4: 349-350 në të cilin ka thënë: Kjo thënie është e shumicës (*xhumhur*).

[32] Shih *Tefsijru Furati'l-Kufij*, 121, El-Matbaatu'l-Hajdarije, Nexhefi i nderuar. *Tefsijru'l-Habrij*, 297-311, Muessesetu Ali'l-Bejt, bot. 1. *Tefsijru't-Tibjan*, 8: 339. *Tefsijru Mexhma'ul Bejan*, i Tabrasijut, 8: 462-463 Daru'l-Ma'rife, Bejrut. *Tefsiru'l-Mijzan*, 16: 311. *Usulu'l-Kafij* i Kulejnit, 1: 286-287/1, Daru'l-Edua, Bejrut, bot. 3. *Kemalu'd-Dijn ue Temamu'n-Ni'meh* i Sadukut, 1: 278/25, Muessesetu'n-Neshri'l-Islamij, bot. 3. *Sa'du's-Su'ud* i Ibn Tausit, 106-107, Menshuratu'r-Radij, Kum. *El-'Umde* i Ibn Batrikut, 31-46. *Nehxhu'l-Hakk ue Keshfu's-Sidk* i Al'lame Hil'lit, 1: 88 Muessesetu'n-Neshri'l-Islamij, bot. 3. *Es-Siratu'l-Mustekijm ila Mustehikkiji't-Takdijm*, Zejnuddijn El-'Amilij En-Nabatij, 1: 184-188, El-

Mirëpo, ajo që duhet thënë këtu është se rrugët e transmetimit të Hadithit të Mbulesës tek shumica (Ehli Sunneti) arrijnë në dyzet rrugë dhe rrugët te shiitët imamitë arrijnë deri në tridhjetë rrugë.[33]

Burimet e Hadithit të Mbulesës

Burimet në të cilët gjendet Hadithi i Mbulesës që thekson se Ajeti i Pastrimit ka zbritur për pesë njerëzit të cilët i mbështolli i Dërguari i Allahut me rrobën e tij, janë të shumtë.

Ne po përmendim këtu shkurtimisht disa burime të Ehli Sunetit:

1. *Musnedi* i Ahmed ibn Hanbelit, 1: 331 dhe 3: 259, 285 dhe 4: 107 dhe 6: 292, 296, 298, 304, Daru'l-Fikr, Bejrut.

2. *Fadailu's-Sahabe* i Ahmed ibn Hanbelit, 2: 66-67/102 etj., Muessesetu'r-Risale, Bejrut, bot. 1.

3. *Et-Tarijkhu'l-Kebijr* i Buhariut, 1: pjesa e dytë: 69-70 dhe 110, Daru'l-Kutubi'l-'Ilmije, Bejrut.

4. *Sahihu* i Muslimit, 4: 1883/2424, Daru'l-Fikr, Bejrut, bot. 2.

5. *El-Xhamiu's-Sahih* i Tirmidhiut, 5: 351, 352, 663, 669, Daru Ihjai't-Turathi'l-Arabij, Bejrut.

6. *Khasaisu Emiri'l-Mu'minin* i Nisaiut: 37, 49, etj, Mektebetu'l-Mual'la, Kuvajt, bot. 1.

Mektebetu'l-Murtedauijeh, bot. 1. *Gajetu'l-Meram fi 'Ilmi'l-Kelam* i Amidijut, 259, Kajro.

[33] Shih *Tefsiru'l-Mijzan* i Al'lame Tabatabait, 16: 311, Mussesetul A'lemij, Bejrut, bot. 2.

7. *El-Mu'xhemu'l-Kebijr* i Taberaniut, 3: 46/2662 dhe 3: 47/2666 dhe 3: 49/2698, e shumë të tjerë, Daru Ihjai't-Turathi'l-Arabij, Bejrut, bot. 2.

8. *El-Mu'xhemu's-Sagijr* i Taberaniut, 1: 135, Daru'l-Kutubi'l-Ilmije, Bejrut.

9. *Ensabu'l-Eshraf* i Beladheriut, 2: 104, Muesssetu'l-A'lemij, Bejrut, bot. 1.

10. *Mesabihu's-Sunneh* i Begaviut, 4: 183/3796, Daru'l-Ma'rife, Bejrut, bot. 1.

11. *Me'alimu't-Tenzijl* i Begaviut, 4: 464, Daru'l-Fikr, Bejrut.

12. *El-Ihsan bi Tertijbi Sahihi Ibn Hibban*, 9: 61/6937, Daru'l-Kutubi'l-Ilmije, Bejrut, bot. 1.

13. *Mushkilu'l-Athar* i Tahaviut 1: 332, Daru's-Sadir, Bejrut, bot. 1.

14. *El-'Akdu'l-Ferijd* i Ibn Abdi Rabbihi El-Andalusij 4: 311, Daru'l-Kitabi'l-Arabij, Bejrut.

15. *El-Mustedrek 'ala's-Sahihejn* i Hakim Nisaburiut, 2: 416 dhe 3: 133, 146, 147, 158, 172, Daru'l-Fikr, Bejrut.

16. *Esbabu'n-Nuzul* i Uahidiut: 203, Daru'l-Kutubi'l-Arabije, Bejrut, bot. 1.

17. *El-Isti'ab fi Ma'arifeti's-Sahabe* i Ibn Abdu'l-Berrit, 3: 1100, Daru'l-Xhijl, Bejrut, bot. 1.

18. *Tarijkhu Bagdad* i Khatijb El-Bagdadij, 10: 278/5396, Daru'l Kitabi'l-Arabij, Bejrut.

19. *Tefsijru'l-Khazin*, 5: 259, Daru'l-Me'arif, Bejrut.

20. *Usdu'l-Gabe fi Ma'rifeti's-Sahabe* i Ibnu'l-Ethijrit, 2: 10, 13, 19, 21, dhe 4: 46-47, dhe 4: 110 dhe 5: 407 dhe 6: 78-79, Daru Ihjai't-Turathi'l-Arabij, Bejrut.

21. *Xhamiu'l-Usul* i Ibnu'l-Ethijr El-Xhezeriut, 9: 155/ 6702, 6703 dhe 6705, Daru'l-Fikr, Bejrut, bot. 2.

22. *Ahkamu'l-Kur'an* i Xhessasit, 3: 529, El-Mektebetu't-Tixharije, Meka e Shenjtë.

23. *Ahkamu'l-Kur'an* i Ibn Arabiut, 3: 1538, Daru'l-Me'arif, Bejrut.

24. *Tedhkiretu'l-Khauass* i Sibt Ibn Xheuziut, 233, Muessesetu Ehli'l-Bejt, Bejrut.

25. *El-Kesh'shaf* i Zemakhsheriut, 1: 369, Daru'l-Kitabil-Arabij, Bejrut, bot. 3.

26. *Mefatihu'l-Gajb* i Raziut, 8: 71.

27. Biografia e Imam Aliut nga *Tarijkhu Dimashk* i Ibn Asakirit, realizuar nga Muhamed Bakir El-Mahmudij, 1: 273-274/322, Daru't-Te'aruf, Bejrut, bot. 1. Biografia e Imam Hysejnit, 7: 61-77, Muessesetu'l-Mahmudij, Bejrut, bot. 1.

28. *Minhaxhu's-Sunneh* i Ibn Tejmijes, 3: 4 dhe 4: 20, El-Mektebetu'l-'Ilmije, Bejrut.

29. *Tarijkhu'l-Islam* i Dhehebiut, 3: 44 dhe 5: 95-96 Daru'l-Kitabi'l-Arabij, Bejrut, bot. 1.

30. *Sijeru A'lami'n-Nubela* i Dhehebiut, 2: 122 i cili e saktësoi atë, Muessesetu'r-Risale, Bejrut, vëll.1.

31. *El-Bidaje uen-Nihaje* i Ibn Kethirit, 7: 338, Daru'l-Fikr, Bejrut, bot. 3.

32. *El-Isabeh fi Temjizi's-Sahabeh* i Ibn Haxherit, 4: 270, Daru'l-Kutubil-Ilmije, Bejrut.

33. *Mexhma'uz-Zeua'id ue Menba'ul-Feuaid*, 7: 91 dhe 9: 119, 121, 146, 167-169, 172, Daru'l-Kitabil-Arabij, Bejrut, bot. 3.

34. *Tehdhijbu't-Tehdhijb* i Ibn Haxher El-Askalaniut, 2: 297, Hajdarabad, Indi, bot. 1.

35. *El-Itkan* i Sujutiut, 4: 277, Menshuratu'r-Rida, Kum, bot. 2.

36. *Ed-Durru'l-Menthur* i Sujutiut, 5: 198, 199, Mektebetu Ajetil'lah El-Mer'ashij En-Nexhefij, Kum.

37. *Es-Saua'iku'l-Muhrika* i Ibn Haxher El-Hejtemiut, 139, 143, 144, 229, Mektebetu'l-Kahire, Egjipt, bot. 2.

38. *Kenzu'l-'Ummal* i Muttekil-Hindit, 13: 163/36496 etj, Muessesetu'r-Risale, Bejrut, bot. 5.

39. *Fet'hu'l-Kadijr* i Sheukaniut, 4: 349-350, Daru'l Ma'rife, Bejrut, bot. 2.

40. Të gjithë librat jetëshkrimorë për Ehli Bejtin, tek Ajeti i Pastrimit.

Ekzistojnë edhe shumë burime të tjera, që po t'i përmendim të gjitha do të zgjatemi. Të gjitha transmetimet vërtetojnë se Ehli Bejti janë Profeti Muhamed, Imam Aliu, Fatimeja, Hasani dhe Hysejni.

Është ajo që përputhet me transmetimet e shiitëve imamitë e që dijetarët e tyre kanë rënë dakord në unanimitet.[34]

[34] Shumë nga dijetarët imamij e kanë veçuar Ajetin e Pastrimit me shkrime të veçanta.

Shumica (Ehli Suneti) e kanë transmetuar këtë hadith në *Sahih*ët dhe *Sunen*et e tyre, në zinxhirët transmetues. Këtë hadith e pranojnë komentuesit në unanimitet dhe pjesa më e madhe e dijetarëve e mbështesin një gjë të tillë, siç u përmendën më lart transmetuesit e hadithit dhe burimet e tij.

Saktësia e hadithit

Transmetuesit e hadithit nuk janë mjaftuar vetëm me trasmetimin e hadithit, por shumë prej tyre kanë deklaruar vërtetësinë e tij dhe mosdyshimin në të. Prej tyre: Ahmed ibn Hanbeli në *Musned*in e tij, Hakim Nijsaburiu në librin "El-Mustedrek", Dhehebiu në *Telkhisu'l-Mustedrek*, Bejhakiu në librin e tij "Es-Sunen" etj.

Disa dijetarë kanë deklaruar edhe thëniet e tyre: "*me pajtueshmëri unanime të komentuesve*" dhe "*është transmetuar nga shumica*".[35]

Nga ata, të cilët kanë deklaruar mbi vërtetësinë e hadithit është edhe Ibn Tejmije, i njohur për armiqësinë e tij ndaj Ehli Bejtit, si dhe përpjekjen e tij për të mjegulluar dhe njollosur virtytet e tyre.

Për Hadithin e Mbulesës ai ka thënë: "*Përsa i përket Hadithit të Mbulesës, ai është i saktë. Atë e ka transmetuar Ahmedi dhe Tirmidhiu nga biseda e Ummu Selemesë. Atë e ka*

[35] Shih *Nehxhu'l-Hakk*, 173.

transmetuar edhe Muslimi në Sahihun e tij nga hadithi i Aishes."[36]

Pasi përmendi një grup transmetimesh të cilat vërtetojnë se ajeti është i veçantë për Ehli Bejtin, tha: "E kur i Lartësuari sqaron se Ai dëshiron t'i largojë papastërtitë nga Ehli Bejti i Profetit e t'i pastrojë ata plotësisht. Profeti ftoi më të afërmit e tij, Ehli Bejtin e tij dhe më të lartit në pozitë tek ai, që janë: Aliu dhe Fatimeja *(Allahu qoftë i kënaqur me ta!)* dhe dy zotërinjtë e banorëve të Xhenetit. Allahu i Lartësuar bashkoi për ta mes vendimit për pastrimin e tyre dhe mes plotësimit të lutjes së Profetit."[37]

Për Hadithin e Mbulesës Dhehebiu ka thënë: *"Është vërtetuar se Profeti i ka mbuluar Fatimen, bashkëshortin e saj dhe dy fëmijët e tyre me një rrobë, duke thënë: "O Zoti im! Këta janë Ehli Bejti im! O Zoti im! Largoji prej tyre papastërtitë dhe pastroji ata plotësisht."*[38]

Hedhja e dyshimit në konceptin e Ehli Bejtit

Nga tekstet e sakta të lartpërmendura, të cilat i kaluan kufijtë e autenticitetit, sqarohet mëse qartë dhe dukshëm se qëllimi me Ehli Bejtin e lartpërmendur në ajet janë pesë personat e mbuluar e jo të tjerë.

---

[36] *Minhaxhu's-Sunneh*, 3: 4, dhe 4: 20.

[37] *Risaletu Fadli Ehli'l-Bejt ue Hukukihim* i Ibn Tejmijes, shqyrtimi (*ta'lijk*) i Ebi Turab Dhahirijut: 22, Daru'l-Kible li'th-Thekafeti'l-Islamije, Arabi Saudite, bot. 1.

[38] *Sijeru A'lami'n-Nubela* i Dhehebiut, 2: 122.

Pavarësisht sqarimit në përcaktimin e konceptit të Ehli Bejtit, për të cilët zbriti Ajeti i begatë i Pastrimit dhe që i mblodhi e i kufizoi ata i Dërguari i Allahut nën petkun e tij, në mënyrë që të vërtetojë veçantinë e tyre në ajet dhe t'i presë rrugën kujtdo që mundohet të përfshijë në të edhe të tjerë, gjithësesi, disa janë përpjekur të hedhin dyshime e ta përgjithësojnë këtë koncept, duke shkelur kufirin e saktësisë e të vërtetësisë nga Syneti i të Dërguarit *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i transmetuar nga imamët e udhëzuar dhe një numër i madh sahabësh, bashkëkohësish dhe ithtarësh – ndjekës të fesë.

Në këtë kontekst, gjen mendime dhe thënie të tjera për përcaktimin e qëllimit të Ehli Bejtit në Ajetin e Pastrimit. Të gjitha bien në kundërshtim me shkakun e zbritjes së ajetit të sqaruar haptazi në të shumtën e komentimeve dhe librave të haditheve.

Gjithashtu, ato mendime dhe thënie kundërshtojnë synetin e saktë të Profetit *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* të përfaqësuar nga thëniet, veprat dhe vendimet e tij, siç do ta sqarojmë më vonë.

Aspektet më të rëndësishme të tyre janë:

Së pari: Qëllimi me Ehli Bejtin është vetëm i Dërguari.[39]

Kjo është thënie e çuditshme dhe në kundështim me të vërtetën dhe me transmetimet e Profetit në përcaktimin e Ehli Bejtit në librat e të dy grupeve (sunnitë e shiitë).

[39] *Es-Savaiku'l-Muhrikah*, 143.

Së dyti: Qëllimi me Ehli Bejtin është: "Janë ata, të cilëve u është ndaluar lëmosha (*sadakaja*) nga të afërmit e Profetit, si familja e Aliut, familja e Akilit, familja e Xha'ferit, familja e Abbasit". Baza e kësaj thënieje është një transmetim që i atribuohet Zejd ibn Erkamit.[40]

Kjo thënie është e papranueshme në shumë aspekte:

1- Komentimi i Zejdit në atë se çfarë synohet me Ehli Bejtin në Ajetin e Pastrimit është një mendim i tij përballë teksteve të sakta e autentike të transmetuara nga Profeti në përcaktimin e Ehli Bejtit.

2- Ky hadith bie në kundërshtim me një hadith tjetër të vetë Zejd ibn Erkamit, në të cilin vërtetohet se gratë e Profetit nuk hyjnë tek Ehli Bejti. Është pyetur Zejdi: "Kush është Ehli Bejti i tij? A janë gratë e tij?" Ka thënë: "Jo. Zot më fal! Në të vërtetë, gruaja qëndron me burrin për një periudhë të caktuar kohe e më pas e ndan atë dhe kthehet tek prindërit dhe populli i saj. Ehli Bejti i (familja e) një burri është origjina (prejardhja) e tij."[41]

3- Ky hadith inspiron nxjerrjen e Profetit nga Ehli Bejti. Kjo është në kundërshtim me hadithin e përhapur (*meshhur*) të transmetuar prej tij dhe të asaj që ka ardhur për shkakun e zbritjes së ajetit.

---

[40] *Sahijhu Muslim*, 4: 1873 / 36 dhe *Tefsiri* i Ibn Kethirit, 3: 486, dhe *El-Xhami'u li Ahkami'l-Kur'an*, 14: 183. *Fet'hul Kadijr*, 4: 350. *Ed-Durru'l-Menthur*, 5: 198-199

[41] *Sahijhu Muslim*, 4: 1874 / 37. *Fet'hul-Kadijr*, 4: 350. *Kenzu'l-'Ummal*, 13: 641. *Es-Sauaiku'l-Muhrika*, 226. *Es-Sunenu'l-Kubra* i Bejhakiut, 2: 148. *Musnedu Ahmed ibn Hanbel*, 2: 114 dhe 4: 367. *El-Mustedrek*, 3: 109.

4- Ndalimi i sadakasë nuk kufizohet në emrat e lartpërmendur në hadithin e Zejdit. Sepse edhe fisi Abdul Muttalib, madje edhe i gjithë fisi Hashimij, janë pjesëmarrës në ndalim. E, kjo do të thotë se të gjithë ata janë të përfshirë tek Ehli Bejti, gjë e cila bie në kundërshtim me hadithet e sakta në përcaktimin e tyre, të transmetuara nga ana e Profetit fisnik *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Së treti: Qëllimi me Ehli Bejtin është i veçantë për gratë e Profetit, sepse konteksti i ajetit sqaron gjendjen e tyre. Ky mendim i atribuohet transmetimit të Ikrime El-Berberijut, 'Urue ibn Zubejrit dhe Mukatil ibn Sulejmanit.[42]

Ka edhe një mendim tjetër, ndryshe nga ato që thamë, i cili thotë se Familja (*Ehli Bejti*) janë: Aliu, Fatimeja, dy fëmijët dhe gratë e Profetit.[43]

Mendimi i tretë u ndesh me një popullaritet të madh ndërmjet autorëve e kërkuesve, të cilët argumentuan me transmetimin e Ajetit të Pastrimit në kontekstin që u drejtohet grave të Profetit.

Në vijim janë pikat më të rëndësishme të cilat vërtetojnë pavërtetësinë e kësaj thënieje:

[42] *Xhamiu'l-Bejan*, 22: 7. *Tefsiri* i Ibn Kethirit, 2: 483, *Ed-Durru'l-Menthur*, 5: 198. *Fet'hu'l-Kadijr*, 4: 348-349. *Sijeru A'lami'n-Nubela*, 8: 208. *Esbabu'n-Nuzul*, 204. *Es-Saua'iku'l-Muhrika*, 143. *Nuru'l-Ebsar*, 110.

[43] *Es-Sunenu'l-Kubra*, 2: 150. *Fet'hu'l-Kadijr*, 4: 350. *El-Xhami'u li Ahkami'l-Kur'an*, 14: 183.

1- Në të vërtetë, kjo thënie i atribuohet Ikrimes, Mukatilit dhe 'Urue ibn Zubejrit. Porse ata njihen si gënjeshtarë dhe kontradiktorë në lidhje me Ehli Bejtin.

Përsa i përket Ikrimes, ai është nga khavarixhët sifrinj. Thuhet edhe se ka qenë nga ibadinjtë. Nuk mund pritet nga një *kharixhij*, i cili e quan të pafe dhe e mohon Imam Aliun, që të thotë se Ehli Bejti janë ata për të cilët ka zbritur Ajeti i Pastrimit. E për më tepër, që Ikrimja është i njohur si gënjeshtar, veçanërisht për Ibn Abbasin. Abdullah ibn Harithi ka thënë: "Hyra tek Ali ibn Abdullah ibn Abbasi dhe Ikrimja ishte i lidhur tek dera e banjos. I thashë: "Kështu veproni me shërbyesin tuaj?!" Më tha: "Ky ndyrësirë gënjen për babain tim."

Transmetohet nga Ibn Umeri se i ka thënë shërbëtorit të tij: "Kije frikë Allahun, mos gënje për mua, ashtu siç gënjeu Ikrimja për Ibn Abbasin."

Ibn Sirijni, Jahja ibn Mu'ini dhe Maliku kanë thënë për të: "Gënjeshtar!"

Muhamed ibn Sa'di ka thënë: "Nuk argumentohet me hadithet e tij."

Kjo është arsyeja që Maliku e ndaloi transmetimin prej tij dhe dijetarë të shumtë kanë dëshmuar për gënjeshtrën e tij.

Ndërsa, përsa i përket bindjes ideologjike të tij të shthurur, dihet se ai neglizhonte namazin. Kështu, është përmendur në prani të Ejubit se Ikrimja nuk e bënte mirë namazin dhe për këtë Ejubi ka thënë: "Pse, a është falur ai?!"

Ikrimja është njohur, gjithashtu, edhe për ofendimin e tij ndaj fesë e fetarëve, e kjo për arsye të thënieve të tij të pavërteta. Prej tyre, edhe thënia e tij, kur një ditë po qëndronte tek porta e Xhamisë së Profetit: Nuk ka në të veçse mohues!

Ka qenë një njeri që e ka dashur muzikën dhe e dëgjonte atë. Luante me zare, ishte mendjelehtë. Kjo është arsyeja për të cilën e kanë mënjanuar atë, e kanë lënë xhenazen e tij dhe nuk e ka përcjellë askush, me përjashtim të katër zezakëve që i morën me qera.[44]

Ndërsa Mukatil ibn Sulejmani, çështja e tij, si ajo e Ikrimesë, në lidhje me armiqësinë e tij ndaj Emiri'l Mu'minijn, prijësit të besimtarëve, Imam Aliut *(paqja qoftë mbi të!)* ishte prej gënjeshtarëve dhe prej të lënëve (*metruk*). Ka qenë prej thënësve të "irxhait" dhe "teshbihut" e iluzionist në thëniet e tij.

Kharixhe ibn Mus'abi ka thënë: "Xhehmi dhe Mukatili tek ne (sipas nesh) janë të shthurur e të prishur."

Ka thënë: "Nuk e konsideroj hallall gjakun e një jehudiu dhe as të ndonjë dhimmiu[45], por sikur të kisha

[44] Kthehu tek *Mijzanu'l-I'tidal fi Nakdi'r-Rixhal* i Dhehebiut, 3: 93-96, Daru Ihjai'l-Kutubi'l-Arabije, Kajro, vëll. 1. *Tehdhijbu't-Tehdhijb*, 7: 263-273, *Et-Tabakatu'l-Kubra* i Ibn Sa'dit, 5: 287-289, Dar Sadir, Bejrut. *Shedheratu'dh-Dheheb* i Ebu'l-Felah El-Hanbelij, 1: 130, Mektebetu'l-Kudsij, Kajro. *Ed-Du'afau'l-Kebijr* i El-'Akilij El-Mekkij, 3: 373-374/1413, Daru'l-Kutubi'l-Ilmije, Bejrut, vëll. 1. *Uefejatu'l-A'jan* i Ibn Khal'likanit, 3: 265, Neshrijatu Sherijfi'r-Radijj, Kum, vëll. 2. *El-Mugnij fi'd-Du'afa* i Dhehebiut, 2: 438-439, Daru'l-Me'arif, Siri, bot. 1

[45] Njeriu i fesë tjetër që jeton në shtetin islam sipas kushteve të caktuara në legjislacionin islam.

mundësi ta gjeja Mukatil ibn Sulejmanin në një vend që të mos më shihte njeri, do ta kisha vrarë atë."

El-Xheuzexhanij ka thënë: "Ka qenë gënjeshtar që s'e njihte frikën."

Umer ibn Aliu ka thënë: "Hadithi i tij nuk merret për bazë, gënjeshtar i madh!"

Ibn Hibbani ka thënë: "Gënjente kur bisedonte."

Ebu Hatimi ka thënë: "Hadithi i tij lihet."

Nisaiu ka thënë: "Gënjeshtar!" Më pas, ka thënë: "Gënjeshtarët e njohur, të cilët kanë vendosur hadithe kundër të Dërguarit të Allahut, janë katër. Prej tyre është edhe Mukatili."

Dhehebiu ka thënë: "Kanë rënë dakord unanimisht që ta lënë atë."[46]

Ndërsa 'Urue ibn Zubejri ishte prej atyre që kishte një armiqësi të ashpër ndaj prijësit të besimtarëve, Aliut, saqë kur përmendej Aliu, ai fliste keq për të.

El-Iskafij e ka konsideruar atë prej atyre tabiinëve, të cilët trillonin lajme të këqija për Imam Aliun.[47]

---

[46] Kthehu tek *Mijzanu'l-I'tidal*, 4: 173, *Sijeru A'lami'n-Nubela*, 7: 201. *Shedheratu'dh-Dheheb*, 1: 227. *Tehdhijbu't-Tehdhijb*, 10: 279-285. *Uefejatu'l A'jan*, 5: 255. *Lisanu'l-Mijzan* i Ibn Haxher El-Askalanit, 6: 82, Muessesetu'l-A'lemij, Bejrut botimi 2. *Ed-Du'afa ue'l-Metrukijn* i Darekutniut, 64, Mektebetu'l-Mearif, Rijad, bot. 1. *El-Xherh uet-Ta'dijl* i Ibn Ebi Hatimit, 8: 354, Hajdarabad, Indi, botimi 1. *El-Mugnij fi'd-Du'afa*, 20: 675. *Ed-Du'afau'l-Kebijr*, 4: 238-241/1833.

[47] *Sherh Ibn Ebi'l-Hadijd*, 4: 63, Daru'l-Ihjai'l-Kutubi'l-'Ilmije, botimi 2. *El-Gàràt* i Thekafiut, 2: 576.

2- Ndërsa pretendimi për një kontekst të njëjtë, duke e konsideruar Ajetin e Pastrimit prej ajeteve që u drejtohet grave të Profetit, në këtë rast, ndryshimi i përemrave ndërmjet Ajetit të Pastrimit, ajeteve të mëparshme dhe ajeteve në vijim, tregon ndryshimin se kujt i drejtohet.

Përpara Ajetit të Pastrimit, flitet për gratë e Profetit nëpërmjet përemrit femëror: *(Ja nisae'n-Nebijji lestunne ke ehadin mine'n-nisai)* **"O ju gratë e Profetit, nuk jeni si asnjë nga gratë e tjera…"**[48] Më pas, në Ajetin e Pastrimit, vjen fjala (*jutahhirukum*) me përemër të gjinisë mashkullore. Kështu që, sikur të synoheshin në ajet gratë e Profetit, thënia do të vazhdonte me përemër të gjinisë femërore (*'ankunne* – nga ju) dhe (*jutahhirukunne* – t'ju pastrojë juve).

Ky argumentim është transmetuar edhe nga Zejd ibn Ali ibn Husejn.[49]

Ebu Hajjan El-Andalusiju në komentimin e tij, në kundërpërgjigje të atyre që thonë se ajeti është specifik për gratë e Profetit, ka thënë: "Nuk është mirë, sepse sikur të ishte ashtu, struktura e fjalës do të ishte '*ankunne*' dhe '*jutahhirukunne*'."[50]

Ndryshimi i objektit që i drejtohet fjala nuk e prish kontekstin e ajeteve kur'anore, sepse kapërcimi (*intikal*) në kontekstin e përemrave përmendet në shumë ajete në

[48] Surja "El-Ahzab", ajeti 32.
[49] *Tefsijru'l-Kummij*, 2: 193.
[50] *El-Bahru'l-Muhijt* i Ebi Hajjan El-Andalusijut, 7: 231, Daru'l-Fikr, Bejrut, botimi 2.

Kur'an.[51] Përmendet edhe në gjuhën e pastër arabe, në poezitë e thëniet e tyre se është një nga format retorike të elokuencës së gjuhës arabe që quhet ***iltifat***.

Përgjatë ndjekjes së transmetimeve, të cilët folën për Ajetin e Pastrimit, duket qartazi se ai nuk ka zbritur me ajetet që u drejtohen grave të Profetit. Por ai ka zbritur veçmas, në një situatë të caktuar dhe për një çështje të veçantë, siç inspirojnë transmetimet e Ummu Selemes, në shtëpinë e së cilës ka zbritur ky ajet.[52]

Kjo tregon pasaktësinë e argumentimit me njësinë e kontekstit, të cilën e kanë përhapur disa që u intereson të dyshojnë në çdo virtyt të të afërmve më të ngushtë të Profetit të zgjedhur *(paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të gjithë ata!)*.

3- Shumë transmetime që kanë ardhur nga gratë e Profetit sqarojnë mospërfshirjen e tyre në Ajetin e Pastrimit. Ne përmendëm transmetimin e Tirmidhiut, të transmetuar nga Ummu Selemeja, e cila ka thënë: "*Po unë, a jam me to, o i Dërguari i Allahut?*" Dhe ai i thotë: "*Me të vërtetë, ti je për të mirë.*"

Tahaviu ka transmetuar nga Ummu Seleme, se ajo ka thënë: "Ky ajet (**"…O Familje e Profetit! Në të vërtetë, Allahu do që ta largojë prej jush papastërtinë dhe t'ju pastrojë plotësisht…")** ka zbritur në shtëpinë time dhe në

[51] Kthehu tek surja "Jusuf", ajeti 28-29; surja "El-Uaki'a", ajeti 76 dhe surja "El-Munafikun", ajeti 7.
[52] Kthehu tek *Mushkilu'l-Athar* i Tahaviut, 1: 333 dhe *Mustedreku'l-Hakim*, 3: 146.

shtëpi ishin shtatë: Xhibrili, Mikaili, Aliu, Fatimeja, Hasani, Husejni dhe i Dërguari i Allahut, ndërsa unë isha tek dera. I thashë: "*Po unë, a nuk jam nga Ehli Bejti?"* Profeti tha: "*Me të vërtetë, ti je për të mirë; ti je prej grave të Profetit."*[53]

Në një transmetim tjetër, Ummu Selemeja ka thënë: "Po unë, a nuk jam nga Ehli Bejti?" Profeti i tha: "Me të vërtetë, ti je mirë; ti je prej grave të Profetit." dhe në shtëpi ishin Aliu, Fatimeja, Hasani dhe Husejni."[54]

Në transmetimin e Hakimit thuhet: Ai *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)* e ndaloi Zejneben të hynte me ta duke i thënë asaj: "*Qëndro në vendin tënd, ti je në të mirë, në dashtë Allahu."*[55]

Këto transmetime dhe shumë të tjera si këto, të cilat kanë ardhur me fjalë të përafërta, i përjashtojnë gratë e Profetit *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nga koncepti i Ehli Bejtit.

Prej transmetimeve të tjera, të cilat kanë ardhur jo nga gratë e tij, është ai që transmeton Muslimi në *Sahih*un e tij nga Zejd ibn Erkami. Ai u pyet: "Kush është Ehli Bejti i tij? A janë gratë e tij?" Ka thënë: "Jo. Zot më fal! Në të vërtetë, gruaja qëndron me burrin për një periudhë të

---

[53] *Mushkilu'l-Athar* i Tahaviut, 1: 333, *Ed-Durru'l-Menthur* i Sujutiut, 5: 198.

[54] *Mushkilu'l-Athar*, 1: 334.

[55] *El-Mustedrek ala's-Sahihejn*, 2: 415. Transmetimet me këtë kuptim janë të shumta. Kthehu tek *Esbabu'n-Nuzul* i Uahidiut, f. 203. *Es-Sauaiku'l-Muhrika*, f. 143-144. *Musnedi* i Ahmedit, 6:292 dhe 304. *Es-Sunenu'l-Kubra* i Bejhakiut, 5: 112/8409. *Kifajetu't-Talib* i El-Kenxhi'sh-Shafi'ijut, f. 212, Daru Ihjai Turathi Ehli'l-Bejt, Teheran, botimi 3.

caktuar kohe e më pas e ndan atë dhe kthehet tek prindërit dhe populli i saj. Ehli Bejti i (familja e) një burri është origjina (prejardhja) e tij."[56]

4- I Dërguari ushtroi një veprim praktik duke përfshirë Aliun, Fatimen, Hasanin dhe Hysejnin me rrobën e tij, që të vërtetonte zbritjen e Ajetit të Pastrimit për ata dhe për askënd tjetër nga të afërmit e shtëpisë së tij, grave të tij e myslimanëve të tjerë. Ai *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nuk u mjaftua me këtë masë, por e vërtetoi zbatimin e këtij koncepti disa herë që t'i sigurojë njerëzit se ata janë Ehli Bejti i (Familja e) tij e jo të tjerë si dhe të sqarojë madhështinë e pozitës së tyre.

Është transmetuar nga Ebi'l-Hamra i cili ka thënë: "Kam mësuar Kur'anin përmendsh në Medine tek i Dërguari i Allahut për tetë muaj. Nuk kishte ditë që të dilte e të falte sabahun, veçse Profeti shkonte tek porta e Aliut dhe vendoste duart në dy anët e portës së tij, e më pas thoshte: "Namazi, namazi!" **"...O Familje e Profetit! Në të vërtetë, Allahu do që ta largojë prej jush papastërtinë dhe t'ju pastrojë plotësisht."**[57] dhe kjo, pas zbritjes së ajetit: **"Urdhëro të afërmit e tu me namaz."**[58]

Në një transmetim tjetër nga Ebi'l-Hamra thuhet: "E kemi parë të Dërguarin e Allahut për nëntë muaj që vinte tek porta e Ali ibn Ebi Talibit në kohën e faljes së çdo namazi dhe thoshte: 'Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin

[56] *Sahihu* i Muslimit, 4: 1874 /37, Kitabu Fadaili's-Sahabe.
[57] *Ed-Durru'l-Menthur* i Sujutiut, 5: 199.
[58] Surja "TaHa", ajeti 132.

mbi ju, Ehlu'l-Bejt!' **"…O Familje e Profetit! Në të vërtetë, Allahu do që ta largojë prej jush papastërtinë dhe t'ju pastrojë plotësisht."**[59]

Si ky është transmetuar edhe nga Ibn Abbasi.[60]

Ky veprim nuk ishte në mënyrë spontane nga Profeti udhëzues, i cili nuk flet nga vetja e tij, por thënia e tij është Shpallje që i është shpallur atij. Jo vetëm kaq, porse është një thënie, veprim a miratim që burojnë nga vullneti i Zotit në përcaktimin e çertifikimit të vërtetë të Ehli Bejtit në Ajetin e Pastrimit.

5- Në të vërtetë, Ajeti i Pastrimit obligon heqjen e papastërtive që janë mëkatet, gjynahet e gabimet nga Ehli Bejti. Teksti i këtij ajeti paraprihet me pjesëzat më të forta të kufizimit (*hasr*) [*Innema*] për dëshirën e pastrimit dhe shmangien e papastërtisë.

Zemakhsheriu ka thënë: "Pastrimi nga mëkati është dlirësia prej tij."[61]

---

[59] *Mushkilu'l-Athar* i Tahauijut, 1: 338.

[60] *Ed-Durru'l-Menthur*, 5: 199. Në një transmetim: gjashtë muaj; në një tjetër: shtatë muaj; në të tretën: dhjetë muaj; në të katërtën: shtatëmbëdhjetë muaj; në të pestën: nëntëmbëdhjetë muaj. Thuhet edhe se Profeti vazhdoi me një gjë të tillë deri në fund të jetës së tij të bekuar dhe kjo sipas periudhës që e ka mbajtur mend transmetuesi ose e ka parë atë. Shih edhe burime të tjera të këtyre haditheve: *Xhamiu'l-Bejan*, 22: 5 dhe 6, *Tefsijr Ibn Kethijr*, 3: 483; *Kenzu'l-Ummal*, 16: 257, *Mexhmau'z-Zeuaid* 9: 121 dhe 168. *Musnedu Ahmed*, 3: 259 dhe 285. *El-Xhamiu's-Sahijh*, 5: 352. *El-Mustedrek* 3: 158 i plotësuar. *Musnedu't-Tajalisij*, 8: 274. *Usdu'l-Gabe*, 5: 407 dhe 6: 78-79. *El-Bidaje ue'n-Nihaje*, 5: 321 dhe 8: 205, e shumë të tjerë.

[61] *Esasu'l-Belaga* i Zemakhsheriut, 399, lënda "*tahera*" (pastroi), Daru'l-Fikr, Bejrut.

Raziu ka thënë: **"…që ta largojë prej jush papastërtinë…"**, pra, të largojë prej jush mëkatet."[62]

Tabariu ka thënë: "Me të vërtetë, Allahu dëshiron të largojë prej jush të keqen dhe ndytësitë, o Ehli Bejti i Muhamedit dhe t'ju pastrojë juve nga e ndyta, e cila ndodhet tek mëkatarët."

Tabariu transmeton me zinxhirin e tij deri tek Said ibn Katadeja, i cili ka thënë: **"…O Familje e Profetit! Në të vërtetë, Allahu do që ta largojë prej jush papastërtinë dhe t'ju pastrojë plotësisht."** Ata janë Ehli Bejti. Allahu i pastroi ata nga e keqja dhe i specifikoi ata me mëshirë prej Tij.[63]

Transmetohet nga Ibn 'Atije, i cili ka thënë: "Papastërtia është emër që qëndron mbi mëkat, ndëshkim, gjëra të ndyta dhe mangësi. Të gjitha Allahu i largoi nga Ehli Bejti.[64]

Ajeti, sipas fjalëve të këtyre dijetarëve të mëdhenj, tregon për pagabueshmërinë (*'ismeh*) e Ehli Bejtit dhe se Allahu i Lartësuar i largoi prej tyre mëkatet e gabimet dhe i pastroi ata nga të gjitha ngjyrat e gjynaheve. Dhe kjo e obligon pagabueshmërinë.

Historia reale e disa prej grave të Profetit në jetën e tij fisnike e pas vdekjes së tij, na lajmëron për daljen e tyre nga rrethi i pagabueshmërisë dhe i pastrimit nga mëkatet e gabimet. Për disa prej tyre, i Lartësuari thotë: **"Nëse ju të**

---

[62] *Et-Tefsijru'l-Kebijr*, 25: 29.
[63] *Tefsiru't-Tabarij*, 22: 5.
[64] *El-Muharriru'l-Uexhijz fi Tefsijri'l-Kitabi'l-Azijz* i Ibn Atijje El-Andalusij, 13: 72.

dyja pendoheni tek Allahu…"[65] Kjo tregon ekzistencën e gabimit, sepse pendimi vjen pas gabimit.

Gjithashtu, është thënia e Tij e Lartësuar: **"…sepse vërtet që zemrat tuaja patën devijuar …"**[66], pra, zemra juaj u anua dhe rrëshqiti nga e drejta. Kjo thënie është e qartë me kundërvajtjen e atyre të dyjave.

Rreth thënies së Tij: **"…Nëse ju të dyja bashkoheni kundër tij…"**[67]**,** Buhariu transmeton në *Sahihun* e tij nga Ibn Abbasi, i cili e ka pyetur Umer ibn Khattabin për ato të dyja që janë bashkuar kundër Profetit nga gratë e tij dhe ai i ka thënë se ato të dyja kanë qenë: Hafsaja dhe Aishja."[68]

Zemakhsheriu ka thënë në *Tefsirin* e tij për disa ajete që përmendin dhe aludojnë për gratë e Profetit: "Në kontekstin e këtyre dy shembujve, dy nënat e besimtarëve – domethënë Hafsaja dhe Aishja – e teprojnë në bashkimin kundër të Dërguarit të Allahut, gjë të cilën ai e urrente, ka tërheqje vëmendjeje për ato në mënyrë të rreptë, pasi shembëllimi nganjëherë është kujtesë e mohimit."[69]

---

[65] Surja "Et-Tahrijm", ajeti 4.
[66] Surja "Et-Tahrijm", ajeti 4.
[67] Surja "Et-Tahrijm", ajeti 4.
[68] *Sahihu'l-Buharij*, 6: 277/407 Kitabu't-Tefsir dhe 7: 50/121 Kitabu'n-Nikah. Dhe për të ditur më shumë nga historia e Hafsas e Aishes, për të cilat tregohet përjashtimi i tyre nga Ajeti i Pastrimit shih librin *En-Nassu ue'l-Ixhtihad* i imam Sherefuddijn El-Amulij, f. 413-428. Këtë thënie e transmetojnë librat më në zë të Ehli Sunetit.
[69] *El-Kesh'shaf*, 4: 571.

Ndërsa, pas vdekjes së Profetit, dihet ecuria e historisë dhe qëndrimi i Aishes ndaj Osmanit, nxitja e njerëzve për vrasjen e tij dhe emërtimin e tij *Na'thel*.

Në momentin kur u vra dhe u vu në dijeni që njerëzit ia dhanë besën Imam Aliut, pretendoi se Osmani ishte vrarë padrejtësisht. Për këtë, Ubejde ibn Ebi Seleme, që është Ibn Ummi Kulab ka thënë:

"Prej teje është opinioni e prej teje është xhelozia
Prej teje janë erërat e prej teje shiu
Ti urdhërove vrasjen e Imamit
E na the që ai sapo ka mohuar"[70]

Pastaj dalja e saj kundër kalifit të ligjshëm dhe përgatitja nga ana e saj të një ushtrie për luftë kundër tij. Si rezultat i asaj lufte u vranë tridhjetë mijë myslimanë.

Të tilla vepra si këto, e nxjerrin vepruesin e tyre nga kufiri i pastërtisë dhe pagabueshmërisë prej mëkateve. Sidomos, kur dëshira e pastrimit në ajet nuk mund të komentohet me dëshirën a vullnetin legjislativ (*el-iradetu't-teshri'ijeh*) që obligon largimin e papastërtisë nga të gjithë të përgjegjshmit (*mukel'lefijn*), e jo vetëm nga Ehli Bejti. Përkundrazi, ai është vullneti i mbështetjes dhe i suksesit, të cilat Allahu i Lartësuari ua dhuron disave prej robve të Tij, të cilët i krijon me kujdesin e Tij, i përzgjedh me diturinë e

[70] *Tarikhu't-Tabarij*, 3: 12. *Hauadithu Seneti Sittin ue Thelathijn* (36), Daru'l-Kutubi'l-'Ilmijje, Bejrut, botimi 2. *El-Kamil fi't-Tarijkh* i Ibn Ethirit, 2: 313, Daru Ihjai't-Turathi'l-Arabij, Bejrut, botimi 1.

Tij, duke i parë ata si të denjë për bartjen e pishtarit të fesë me udhëzimin e Tij, duke i mbështetur ata me mbështetjen dhe butësinë e Tij, me mjete që mund t'i dimë dhe mund të mos i dimë.

I Lartësuari ka thënë: **"Allahu e di më së miri se ku e kryen misionin e Tij."**[71]

Mund të thuhet se vullneti në Ajetin e Pastrimit është një vullnet krijimor (*irade tekuinije*), me të cilën Allahu veçoi Ehli Bejtin dhe askënd tjetër nga njerëzit e tjerë duke e kufizuar një gjë të tillë me pjesëzat më të forta të kufizimit. Vullneti krijimor ka lidhje me çështje reale të veprave të të ngarkuarve me detyra dhe se është e pamundur që të kundërshtohet vullneti i Tij. I Lartësuar është Ai, për atë që Ai do."[72]

Përmes këtyre argumenteve vërtetohet se Ajeti i Pastrimit nuk i përfshin gratë e Profetit. Gjithashtu, asnjë nga gratë e Profetit nuk pretendon se ajeti ka zbritur për to me gjithë fisnikërinë e pozitën e tyre madhështore që kanë.

Si rrjedhojë, ajeti është i veçantë e specifik për pesë banorët e Mbulesës: Profetin, Aliun, Zahranë dhe dy fëmijët, Hasanin e Husejnin. Është ajo që është transmetuar në lajmet e sakta e që ka argumente të qëndrueshme për të. Mbarësia është tek Allahu.

---

[71] Shih: *Ruhu't-Teshejju'* i Abdullah Ni'meh, f. 424, Daru'l-Fikri'l-Lubnanij, Bejrut.

[72] Shih librin *Et-Teshejju'* i El-Gurejfij, f. 208, Daru's-Sabbag, Damask, botimi 6.

KAPITULLI I DYTË

Dashuria për Ehli Bejtin *(paqja qoftë mbi ta!)* në Libër (Kur'an) dhe në Sunnet

Vërtet, dashuria për Ehli Bejtin, besnikëria ndaj tyre dhe pasimi i tyre është një element nga elementet bazë të bindjes ideologjike; është prej përbërësve të besimit dhe prej bazave të mesazhit brilant të Muhamedit *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)*. Ka tekste nga Kur'ani dhe hadithe të qarta në lidhje me këtë parim.

Në këtë kapitull do të paraqesim disa shembuj të teksteve kur'anore, të cilat përmbajnë transmetime për zbritjen e tyre për Ehli Bejtin, për të vërtetuar dashurinë ndaj tyre dhe për obligimin e dashurisë për ta. Gjithashtu, do të parashtrojmë disa hadithe e lajme të cilat kanë ardhur për thellimin e këtij parimi ideologjik e konstitucional, e këtë do ta bëjmë në dy pjesë kërkimore:

KËRKIMI I PARË

Dashuria për Ehli Bejtin në Kur'an

Në vijim, ju paraqesim tekstet më të rëndësishme kur'anore të zbritura në lidhje me dashurinë për Ehli Bejtin; ose ajetet që janë komentuar për dashurinë ndaj Ehli Bejtit, duke përmendur transmetimet dhe lajmet sqaruese në lidhje me këtë çështje të marra nga burime të konsiderueshme.

1- "Thuaj: 'Nuk ju kërkoj për këtë kurrfarë shpërblimi, përveç se dashurisë ndaj të afërmve."[73]

Ky është Ajeti i Dashurisë, të cilin e vërtetojnë shumica e librave të komentimeve e shumë nga burimet e haditheve dhe historisë, se ka zbritur për të afërmit e Profetit *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: Aliun, Zahranë, Hasanin, Hysejnin dhe pasardhësit e tyre të pastër.

Sujutiu (por edhe të tjerë përveç tij), e ka transmetuar në librin e tij të komentimit këtë ajet me zinxhir deri tek Ibn Abbasi, i cili ka thënë: "Në momentin që ka zbritur ky ajet: **"Thuaj: 'Unë nuk kërkoj prej jush ndonjë shpërblim për thirrjen Time, vetëm se dashurinë për të afërmit"**, thanë: "*O i Dërguari i Allahut, nga të afërmit e tu, cilët janë ata që jemi*

[73] Surja "Esh-Shura", ajeti 23.

të obliguar t'i duam?" Ai tha: *"Aliu, Fatimeja dhe dy djemtë e tyre."*[74]

Ky ajet tregon obligimin e dashurisë për Ehli Bejtin, për të cilët flitet në tekstet e hadithit për kufizimin e përcaktimin e tyre. Një gjë të tillë, Fahruddin Raziu e argumenton me tre mënyra. Pasi transmeton hadithin nga Zemakhsheriu, thotë: "Atëherë, është konstatuar se ata të katër janë të afërmit e Profetit. Me këtë konstatim, është e domosdoshme që të jenë të veçantë dhe të madhështohen e të nderohen. Kjo argumentohet me:

Së pari: Thënia e Tij e Lartësuar: **"...vetëm se dashurinë për të afërmit."**

Së dyti: Nuk ka dyshim, se Profeti e donte Fatimenë, sepse ai ka thënë: *"Fatimeja është pjesë e imja; më dëmton mua ajo që e dëmton atë."* Është vërtetuar me transmetim autentik se Profeti e ka dashur Aliun, Hasanin e Hysejnin. Atëherë, bazuar në këtë konstatim është detyrim për të gjithë ymetin që ta duan Aliun, Hasanin dhe Husejnin, për arsye të thënies së Tij të Lartësuar: **"Ndiqeni atë, në mënyrë që ju të udhëzoheni."**[75]

---

[74] *Ed-Durru'l-Menthur* i Sujutiut, 6: 7. Hadithi është transmetuar, gjithashtu, në librin *Fadailu's-Sahabe* i Ahmed ibn Hanbelit, 2: 669/1141. *El-Mustedrek 'ala's-Sahijhejn*, 3: 172. *Sheuahidu't-Tenzijl* i El-Haskanij, 2: 130 në mënyra të shumta. *Es-Saua'iku'l-Muhrika* i Ibn Haxherit: 170. *Tefsiru'r-Razij*, 27: 166. *Mexhmau'z-Zeua'id* i Hejthemiut, 9: 168. *El-Kesh'shaf* i Zemakhsheriut, 4: 219. *Dhekhairu'l-'Ukba* i El-Muhib Et-Tabarij: 25. *Is'afu'r-Ragibijn* i Sabbanit: 113 si dhe libra të tjerë kërkimorë e komentues. Shih librin *Et-Teshejju'* të Sejjid El-Gurejfij, 215-216.

[75] Surja "El-A'raf", ajeti 158.

Dhe: "**Atëherë, të jenë të kujdesshëm ata të cilët janë kontradiktorë të urdhrit të tij."**[76]

Së treti: "Në të vërtetë, lutja për familjen është një pozitë madhështore. Kjo është arsyeja që kjo lutje u bë mbyllje e dy dëshmive në përfundim të namazit që është thënia e Tij: *"O Allah i Plotpushtetshëm, bekoje Muhamedin dhe Familjen e Muhamedit!"* Ky madhështim nuk gjendet, veçse për familjen e tij, kështu që e gjitha kjo dëshmon se dashuria për Muhamedin dhe për familjen e Muhamedit është detyrë.

Shafi'iu ka thënë:

"O udhëtar qëndro me gurishtet në Mina
dhe thirr të dëgjojë pushues' i strukur e këmbësor
Herët në agim kur vërshojnë haxhinjtë në Mina
Vërshim si derdhja e Eufratit vërshues
Nëse dashuria ndaj familjes së Muhamedit është refuzim,
le të dëshmojnë njerëz e xhindë se unë jam refuzues."[77]

Shafiiu vazhdon të na tregojë në lidhje me zbritjen e Ajetit të Dashurisë për Ehli Bejtin ku thotë:

"O Ehli Bejti i të Dërguarit të Allahut, dashuria për ju
është detyrë nga Allahu, në Kur'an e zbriti atë."[78]

---

[76] Surja "En-Nur", ajeti 68.

[77] *Tefsijru'r-Razij*, 27: 166.

[78] *Es-Saua'iku'l-Muhrika* i Ibn Haxherit, 148-175. *Sherhu'l-Meuahib* i Zerkanit, 7: 7. *El-It'haf bi Hubbi'l-Eshraf* i Shibravijut: 83, El-Matbaatu'l-Edebije, Egjipt. *Is'afu'r-Ragibijn* i Sabbanit: 119.

Çfarë është transmetuar për Imamët e Ehli Bejtit në këtë ajet?

Imamët e udhëzuar e të pagabueshëm argumentojnë me këtë ajet detyrën e dashurisë ndaj tyre dhe të drejtën e tyre te çdo mysliman. Ka transmetuar Zadhani nga prijësi i besimtarëve, Imam Aliu *(paqja qoftë mbi të!)*, i cili ka thënë: *"Tek ne, tek familja Ha Mim ka një ajet. Nuk e ruan dashurinë ndaj nesh veçse çdo besimtar."* E më pas lexoi: **"Thuaj: 'Nuk ju kërkoj për këtë kurrfarë shpërblimi, përveç se dashurisë ndaj të afërmve."**[79]
Këtë e shpreh El-Kumejtu'l-Esedij me thënien e tij:

"Kemi gjetur për ju, rreth familjes së Ha-Mimit, një ajet…
E komentoi atë prej nesh një i devotshëm e elokuent…"[80]

Është transmetuar nga Imam Zejnu'l-Abidijni, i cili ka thënë: "Kur u vra Aliu *(paqja qoftë mbi të!)*, Hasan ibn Aliu mbajti një ligjëratë për njerëzit. Pasi e falënderoi Allahun dhe e lavdëroi Atë, tha: *"...Edhe unë jam nga Ehli Bejti, për të cilët Allahu e detyroi dashurinë ndaj tyre mbi çdo mysliman." I Lartësuari ka thënë:* **"Thuaj: 'Thuaj: 'Nuk ju kërkoj për këtë kurrfarë shpërblimi, përveç se dashurisë ndaj të afërmve."** *Ai, i cili ndërmerr një vepër të mirë, Ne ia shtojmë atij të mirat.*

---

[79] *Mexhmau'z-Zevaid*, 9: 146. *Tarikhu Isbahan*, 2: 165. *Kenzu'l-'Ummal*, 2: 290/4030 e transmeton nga Ibn Merdevejhi dhe Ibn Asakiri. *Es-Saua'iku'l-Muhrika*, 170. *Shevahidu't-Tenzijl*, 2: 205/838. *Mexhmau'l-Bejan*, 9: 43.
[80] Nga kasideja e Kumejtit *El-Baijetu'l-Hashimije*.

Kështu, ndërmarrja e një vepre të mirë është dashuria ndaj nesh (Ehli Bejtit)."[81]

Ibn Xheriri transmeton nga Ebi'd-Dejlemi, i cili ka thënë: "Kur e sollën rob Ali ibn Hysejnin dhe e vendosën në shkallët e Damaskut, një burrë nga banorët e Shamit u ngrit e tha: *"Falënderimi i përket Allahut, që ju vrau, ju zbuloi juve dhe ndërpreu dy grupe kryengritësish."*

Në këtë moment, Ali ibn Hysejni i thotë: *"A e ke lexuar Kur'anin?"* I tha: *"Po."* E pyeti: *"A ke lexuar për familjen e Ha-Mimit?"* Burri nga Shami i tha: *"E kam lexuar Kur'anin dhe nuk kam lexuar për familjen e Ha-Mimit."* Imami i tha: "Nuk e ke lexuar: **"Thuaj: 'Thuaj: 'Nuk ju kërkoj për këtë kurrfarë shpërblimi, përveç se dashurisë ndaj të afërmve**." Tha: *"A ju, jeni ata?"* Imami i tha: *"Po."*[82]

Ismail ibn Abdu'l-Khalik ka transmetuar nga Ebi Abdil'lahi, Sadiku *(paqja qoftë mbi të!)* në një hadith: E kam dëgjuar t'i thotë Ebi Xha'fer El-Ahvelit: *"Çfarë thonë banorët e Basras për këtë ajet:* **"Thuaj: 'Thuaj: 'Nuk ju kërkoj për këtë kurrfarë shpërblimi, përveç se dashurisë ndaj të afërmve**."? Ebu Xha'feri i tha: *"U bëfsha kurban për ty! Ata thonë se ai ajet është për të afërmit e të Dërguartit të Allahut."* Imami i tha: *"Gënjejnë! Ai ka zbritur vetëm për ne, për Ehli*

---

[81] *El-Mustedrek 'ala's-Sahihejn*, 3: 172. *Mexhma'u'z-Zevaid*, 9: 146. *Es-Saua'iku'l-Muhrika*, 170. *El-Fusulu'l-Muhimme* i Ibn Sabbag El-Malikiut: 166. *Dhekhairu'l-'Ukba*, 138. *Sherh Ibn Ebi'l-Hadijd*, 16:30.

[82] *Tefsiru't-Tabarij*, 25:16. *El-Bahru'l-Muhijt* i Ebu Hajjanit 7:516. *Es-Saua'iku'l-Muhrika*, 170. *Sherhu'l-Mevahib*, 7:20. *Ruhu'l-Me'anij* i Alusiut 25:31, Daru Ihjai't-Turathi'l-Arabij, Bejrut.

Bejtin: për Aliun, Fatimen, Hasanin dhe Hysejnin - njerëzit e mbulesës."[83]

Shpjegime (*te'uilat*) të tjera për ajetin

Nga ato që përmendëm më parë, është e qartë se Ajeti i Dashurisë është i qartë e i sqaruar për detyrën e dashurisë ndaj Ehli Bejtit dhe ai është kuptimi që të shkon ndërmend nga ajeti, siç e kanë përmendur edhe dijetarët si El-Kermanij[84], El-'Ajnij[85], e të tjerë si këta të dy, duke shtuar, për më tepër, hadithet komentuese e shpjeguese të ajetit të transmetuara nga Ehli Bejti dhe nga një grup sahabësh, tabiinësh e imamësh të haditheve.[86]

Pavarësisht se ajeti është i qartë në argumentim si drita e diellit në mes të ditës, disa janë përpjekur ta shmangin të vërtetën nga vendi i saj duke e komentuar fjalën e Allahut siç ua ka ënda e duke sajuar disa thënie që nuk kanë argument shkencor ose që bazohen mbi një argument në tym, i cili nuk vlen si argument e që nuk është

---

[83] *El-Kafij*, 8: 79/66. *Kurbu'l-Isnad* i Ebu'l-Abbas El-Himjeri: 128/450 Muessesetu Ali'l-Bejti li Ihjai't-Turath, Kum, bot. 2.

[84] *El-Keuakibu'd-Derarij fi Sherhi Sahihi'l-Bukharij* i El-Kirmanijut, 18:80, Daru'l-Fikr, Bejrut, bot. 1.

[85] '*Umdetu'l-Karij fi Sherhi Sahihi'l-Bukharij* i Ajniut 19:157, Daru'l Fikr, Bejrut.

[86] Është transmetuar hadithi i zbritjes së ajetit për dashurinë ndaj Ehli Bejtit nga gjashtë imamët e pagabueshëm, nga më shumë se dhjetë nga sahabët (bashkëkohësit) dhe tabiinët (pasuesit e tyre). Hadithi është transmetuar në rreth pesëdhjetë e shtatë libra nga librat e imamëve të hadithit. Shih: *Teshjidu'l-Muraxhe'at ue Tefnijdu'l-Mukaberat* i Sejjid El-Mijlanij, 1: 266-239 dhe *El-Gadijr* i Al'lame Eminit, 3:172.

fakt i mjaftueshëm për sqarimin e qëllimit të ajetit të ndritur.

Siç vijon, ju parashtrojmë thëniet më të rëndësishme:
Thënia e parë: Thuhet se thënia u drejtohet kurejshëve dhe shpërblimi i kërkuar në këtë rast është dashuria e tyre ndaj Profetit për shkak të afrimitetit të tij me ta. Kjo për arsyen se e gënjenin atë dhe e urrenin ngaqë i kundërshtonte zotat e tyre, siç thuhet në disa njoftime.

Kështu, Profeti *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u urdhërua t'u kërkojë se në rastin e mosbesimit të tyre ndaj dashurisë për të, por për hir të afrimitetit as ta dëmtonin dhe as ta urrenin atë.

Zinxhiri i kësaj thënieje është një transmetim nga Tavusi, i cili ka thënë: "E pyeti një burrë Ibn Abbasin për thënien e Allahut të Madhëruar: **"Thuaj: 'Thuaj: 'Nuk ju kërkoj për këtë kurrfarë shpërblimi, përveç se dashurisë ndaj të afërmve**." Said ibn Xhubejri i tha: "*Janë të afërmit e Muhamedit.*" Ibn Abbasi tha: "*U nxitove. Në të vërtetë, i Dërguari i Allahut nuk ka qenë bark nga barqet e kurejshëve, veçse për të Dërguarin e Allahut tek ata ka patur afrimitet, e kështu që zbriti*: **"Thuaj: 'Thuaj: 'Nuk ju kërkoj për këtë kurrfarë shpërblimi, përveç se dashurisë ndaj të afërmve**." *veçse të kujdeseni për afrimitetin ndërmjet meje e ndërmjet jush.*"[87]

Në këtë thënie del se:

[87] *Musnedu Ahmed*, 1:229, 286. *Sahijhu'l-Bukharij*, 6: 231/314, Kitabu't-tefsijr. *El-Metalibu'l-'Alije* i Ibn Haxherit, 3: 368.

1- Vështrimi i parë rreth zinxhirit të këtij transmetimi e bën atë të pavlefshëm. Sepse në zinxhirin e transmetimit është Shu'be ibn Haxh'xhaxhi, i cili njihet si falsifikues e gënjeshtar. Në të, gjithashtu, është edhe Jahja ibn Abbad Ed-Dab'ij, i cili është nga të dobëtit, siç ka deklaruar për këtë Ibn Haxheri nga Es-Saxhij.[88]

Dhehebiu nuk e ndjek fjalën nga Saxhiu në lidhje me dobësinë e tij.[89] Aty është edhe Muhamed ibn Xha'feri[90], të cilin e ka përmendur Ibn Haxheri dhe ata të cilët kanë folur në lidhje me të. Përmendet edhe thënia e Ibn Ebi Hatimit "…Nuk argumentohet me të."[91]

Në të është edhe Muhamed ibn Besh'shari. Ai është nga ata, për të cilin dijetarët e *Xherh*it dhe *Ta'dil*it kanë thënë se është i dobët.[92]

Nga ajo që u përmend më lart, qartësohet se zinxhiri i transmetimit vërteton se transmetimi nuk merret në konsideratë dhe nuk është objekt argumentimi.

2- Ky transmetim është kontradiktor me atë që është transmetuar nga hadithet e sakta dhe autentike nga Profeti *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, e të cilët i përmendëm disa prej tyre më parë. Gjithashtu, është kontradiktor me një hadith tjetër të saktë të transmetuar nga

---

[88] *Mukaddimetu Fet'hil-Barij* i Ibn Haxher El-Askalanit, 452, Daru Ihjai't-Turathi'l-Arabij, Bejrut bot. 2.
[89] *Mijzanu'l-I'tidal*, 4: 387.
[90] Muhamed ibn Xha'fer në transmetimin e Buhariut.
[91] *El-Xherh ue't-Ta'dijl*, 7: 222. Shih edhe *Mukaddimetu'l-Fet'hi-l-Barij*, 437.
[92] *Mukaddimetu'l-Fet'hi'l-Barij*, 437 dhe *Mijzanu'l-I'tidal*, 3:490.

Ibn Abbasi[93] dhe me një tjetër hadith të Said ibn Xhubejrit, ku saktësojnë se qëllimi me të afërmit (*kurba*) në ajet janë: Imam Aliu, Zahraja, Hasani dhe Hysejni.[94]

3- Ajeti ka zbritur në Medine e jo në Meke, siç ka ardhur në shkakun e zbritjes së tij, dhe fjala u drejtohet të gjithë myslimanëve dhe jo në mënyrë të veçantë kurejshëve.

Thënia e dytë: Kuptimi i fjalës "Kurba" (të afërmit, akraballëku) tek Ajeti i Dashurisë është me kuptimin e afrimit tek Allahu, ku dashuria për të afërmit është dashuri ndaj Tij me bindje e afrimitet. Kështu që, kuptimi është: 'Nuk kërkoj prej jush shpërblim, veçse ta doni e ta dashuroni Atë, të Lartësuarin duke iu afruar Atij.'

Zinxhiri i kësaj thënieje është një transmetim që i atribuohet Ibn Abbasit, i cili ka transmetuar nga Profeti, se ka thënë: "*Thuaj: 'Nuk kërkoj prej jush ndonjë shpërblim për atë që ju solla juve nga argumentet e qarta e udhëzimi, vetëm se të afroheni tek Allahu me bindje ndaj Tij.'*"[95]

Për këtë thënie ka disa çështje. Prej tyre:

1- Transmetimi mbi të cilin bazohet kjo thënie është i dobët, siç e ka sqaruar Ibn Haxheri një gjë të tillë.[96]
2- Nuk përmendet në gjuhën arabe përdorimi i termit "*kurba*" (të afërm) me kuptimin e "*tekarrub*" (afrimitet).

---

[93] *El-Bahru'l-Muhijt*, 7:516. *Dhakhairu'l-'Ukba*, 35. *El-Menakib* i Ibnu'l-Megazilit, 192/263, Daru'l-Edua, Bejrtut.
[94] *Jenabi'u'l-Meueddeh*, 1: 215-216/1, 2, 3.
[95] *Et-Tesiru'l-Kebijr* i Raziut, 27:165. *Fet'hu'l-Barij* i Ibn Haxher El-Askalanit, 8: 458, Daru Ihjai't-Turathi'l-Arabij, Bejrut, bot. 2.
[96] *Fet'hu'l-Barij bi Sherhi Sahijhi'l-Bukharij*, 8: 458.

3- Në të vërtetë, afrimiteti tek Allahu i Lartësuar është vetë përmbajtja e Mesazhit. Kështu, si mund të kërkojë Profeti *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* afrimitetin tek Allahu i Lartësuar për hir të afrimitetit tek Allahu i Lartësuar?! Kjo është një çështje që nuk logjikohet e nuk e kapërdin dot mendja e shëndoshë, sepse del që shpërblimi dhe i shpërblyeri t'i jenë një.

Gjithësesi, për këtë ajet ka dy thënie të tjera që kalojnë përtej atyre që thamë deri më tani, që nuk kanë dobi. Si përmbledhje të asaj që u tha, sqarohet se qëllimi me dashurinë ndaj të afërmve është dashuria ndaj të afërmve të Profetit që janë pasardhësit nga Ehli Bejti i tij.

Transmetimet janë të shumta si nga Ehli Sunneti, ashtu edhe nga shiitët në lidhje me komentimin e ajetit me këtë kuptim, siç e sqaruam këtë në fillim të kapitullit. Këtë komentim e përforcojnë edhe transmetimet autentike nga të dyja grupet në lidhje me domosdoshmërinë e ndjekjes së Ehli Bejtit dhe dashurinë ndaj tyre.

Zemahsheriu, pasi ka zgjedhur këtë kuptim, ka thënë: {Nëse nuk është thënë: 'Veçse dashurinë **ndaj** të afërmve, ose vetëm dashurinë **për** të afërmit…', çfarë do të thotë thënia e Tij: '…veçse dashuri **tek** të afërmit'? Do të thoja: 'Janë bërë vend për dashurinë dhe epiqendër për të, ashtu siç mund të thuash: 'Unë e dua familjen e filanit, kam një simpati e dashuri të madhe për ta. Ata janë më të dashurit dhe zënë një pozitë e vend në dashurinë time.'

Ka thënë: "Parashtesa *fi* nuk luan rol si ai i *lam*-it para fjalës "meueddeh" (dashuri) si me thënë "li'l-kurba" në vend të "fi'l-kurba". Ajo ka lidhje me një rrethanor të papërmendur si në thënien: "Malli është në qese." Kështu që, aludimi i të papërmendurës është: Veçse dashurinë e konstatueshme e të paluhatshme tek të afërmit.}[97]

Meditimi në këtë vërtetësi rreth konstatimit të dashurisë ndaj të afërmve, duke qenë se ata janë caktuar pozitë për dashurinë dhe epiqendër për të, si dhe duke medituar në transmetimet autentike të Profetit të përcjella nga të dyja grupet, të cilat u thonë njerëzve që ta kuptojnë Librin e Allahut, i cili përmban bazat e njohurive të fesë e degëve të saj, sqarimin e të vërtetave të tij për Ehli Bejtin, siç është *Hadithi Thekalejn*, *Hadithi i Anijes* e të tjerë si këto, nuk lënë dyshim për detyrën e dashurisë ndaj tyre për çdo mysliman dhe kjo dashuri për ata është si shpërblim ndaj Mesazhit të Zotit.

Ky është shkak për kthimin e njerëzve tek ata për shkak të pozitës së lartë të tyre në dije dhe të rolit të tyre në jetën e njerëzve.

Dyshime dhe sqarime

Pasi u vërtetua se ajeti është i posaçëm për Ehli Bejtin e pagabueshëm, të përfaqësuar nga Imam Aliu, nga Fatimeja dhe pasardhësit e tyre prej imamëve të pamëkatë, u përhapën dyshime nga ana e kundërshtarëve dhe

[97] *El-Kesh'shaf*, 4: 219.

urryesve të Ehli Bejtit, në mënyrë që ta devijonin nga kuptimi i tij i drejtë e i vërtetë. Në vijim, do të përmendim këto dyshime dhe sqarimet rreth tyre:

E para: *Surja "Esh-Shura" është mekase*.

Përmbajtja e këtij dyshimi është mohimi i qenies së këtij ajeti për Ehli Bejtin e Profetit dhe transmetimet janë vërtetuese dhe përkrahëse të saj. E kjo, përmes pretendimit se surja është mekase dhe se Imam Aliu *(paqja qoftë mbi të!)* nuk ka qenë martuar me Zahranë *(paqja qoftë mbi të!)*, e si rrjedhojë, nuk ka patur Hasan e Hysejn, në mënyrë që ajeti të ketë zbritur për të drejtën e tyre.

Përgjigjja:

Së pari: Në të vërtetë, lajmet dhe hadithet e transmetuara nga Profeti dhe imamët e pastër, deklaratat e qarta të sahabëve dhe tabiinëve, që tregojnë se ajeti ka zbritur për Ehli Bejtin janë të mjaftueshme si sqarim i dyshimit dhe i përgënjeshtrimit të tij.

Së dyti: Fenomeni i ekzistencës së ajeteve medinase në suret mekase apo ekzistenca e ajeteve mekase në suret medinase janë të shumta në Kur'an dhe nuk mundet askush që ta mohojë apo të dyshojë për një gjë të tillë. Shembull i tyre janë:

1- Surja "Er-Ra'd" është mekase me përjashtim të thënies së tij të Lartësuar: **"Nuk reshtin ata të cilët kanë mohuar…"**[98]
2- Surja "El-Isra" është mekase, me përjashtim të thënies së Tij të Lartësuar: **"Ata gati të shqetësuan (**në Mekë**) … nga ana Jote më dhuro mua fuqi ndihmuese."**[99]
3- Surja "El-Muddethir" është mekase, me përjashtim të një ajeti në fund të saj.[100]
4- Surja "El-Mutaffifijn" është mekase, me përjashtim të ajetit të parë.[101]

Kjo përsa i përket ekzistencës së ajeteve medinase në suret mekase.

Ndërsa për ajetet mekase që kanë ardhur në suret medinase, si vijon:

1- Surja "El-Muxhadele" është medinase, me përjashtim të dhjetë ajeteve të para.[102]
2- Surja "El-Beled" është medinase, me përjashtim të ajetit të parë deri tek ajeti i katërt.[103]

E shumë të tjera.

---

[98] *Tefsiru'l-Kurtubij*, 9: 287. *Et-Tesiru'l-Kebijr* i Raziut, 18:230, Mektebetu Abdirrahman Muhamed, Egjipt, bot. 1. *Es-Siraxhu'l-Munijr* i Sherbijnit, 2: 137.

[99] *Tefsiru'l-Kurtubij*, 10:203. *Et-Tesiru'l-Kebijr* i Razit, 20:145. *Es-Siraxhu'l-Munijr*, 2:261.

[100] *Tefsiru'l-Khazin*, 4: 343, Daru'l-Me'arif, Bejrut.

[101] *Tefsiru't-Tabarij*, 30: 58.

[102] *Tefsijru Ebi's-Su'ud*, 8: 215 në fusnotë, Daru Ihjai't-Turathi'l-Arabij, Bejrut. *Es-Siraxhu'l-Munijr*, 4: 210.

[103] *El-Itkan*, 1:17.

Së treti: Shumë nga dijetarët dhe komentuesit kanë deklaruar se Ajeti i Dashurisë dhe tre ajetet pas tij kanë zbritur në Medinen e Ndritur.

Për këtë, Sheukanij ka thënë: Transmetohet nga Ibn Abbasi dhe Katadeja, të cilët kanë thënë se surja "Esh-Shura" është mekase, me përjashtim të katër ajeteve që kanë zbritur në Medine: **"Thuaj: Nuk ju kërkoj juve…".**[104]

El-Alusiju në paraqitjen e përgjigjes ka thënë: Është mekase, me përjashtim të katër ajeteve - nga thënia e Tij e Lartësuar: **"Thuaj: Nuk ju kërkoj juve…"** deri në katër ajete." Edhe Mukatili ka thënë: "Në të ka ajete medinase."[105]

Kurtubiu është përgjigjur me thënien e tij: "Ka thënë Ibn Abbasi dhe Katadeja: "Me përjashtim të katër ajeteve prej saj që kanë zbritur në Medine: **"Thuaj: Nuk ju kërkoj juve …."** deri në fund të saj."[106]

Gjithashtu, e kanë përmendur Nijsaburiu dhe El-Khazini në komentimet e tyre.[107]

E dyta: *Ajeti nuk përshtatet me pozitën profetike dhe mohon disa ajete*

Përmbajtja e këtij dyshimi: Në të vërtetë, kërkimi i shpërblimit për misionin dhe udhëzimin nga ana e Profetit nuk përshtatet me pozitën e lartë profetike, sepse Profeti *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i

[104] *Fet'hu'l-Kadijr*, 4:671-672.
[105] *Ruhu'l-Me'anij* i Alusiut, 25: 10.
[106] *Tefsiru'l-Kurtubij*, 16: 1.
[107] *Tefsiru'l-Khazin*, 4:49

ishte përkushtuar Allahut të Lartësuar dhe gjithçka që ka përjetuar ai nga ndëshkimet, vuajtjet, emigrimi, keqtrajtimi, embargoja e lufta, deri edhe ndaj të afërmve e popullit të tij, i mbarti me durim, besim të vazhdueshëm e të paparë.

E gjithë kjo ishte nën kujdesjen e Allahut e në rrugën e Tij e nuk kërkonte prej Tij gjë tjetër, veçse kënaqësinë e Allahut të Lartësuar. I Lavdishëm është Ai! Ai nuk kërkonte asgjë për këtë, e për më tepër, nuk i përshtatet atij që të kërkojë një shpërblim në këmbim të misionit të tij me dashurinë ndaj të afërmve të tij.

Kanë thënë se ajeti bie në kundërshtim me disa ajete të Kur'anit, të cilat mohojnë kërkesën e shpërblimit, si p.sh.: thënia e Allahut të Lartësuar: **"Thuaj** (o Muhamed)**: Unë nuk kërkoj prej jush ndonjë shpërblim dhe Unë nuk jam prej atyre që bëjnë trillime."**[108]

Dhe: **"Thuaj** (o Muhamed)**: Unë nuk kërkoj prej jush ndonjë shpërblim, e nëse kam kërkuar, ai le t'u mbetet juve. Shpërblimi im është vetëm prej Allahut, e Ai është dëshmitar për çdo gjë!"**[109]

Dhe: **"Thuaj** (o Muhamed)**: Unë për këtë nuk kërkoj shpërblim prej jush, por vetëm kush të dojë të marrë rrugën që e afron tek Zoti i vet."**[110]

Dhe: **"Thuaj** (o Muhamed)**: Unë nuk kërkoj për këtë komunikimin e Kur'anit si shpërblim prej jush. Ky nuk është tjetër, veçse një këshillë për mbarë njerëzinë."**[111]

[108] Surja "Sad", ajeti 86.
[109] Surja "Es-Sebe", ajeti 47.
[110] Surja "El-Furkan", ajeti 57.

Përgjigjja:

Në realitet, ndjekësi i historisë së Profetit, veçanërisht në fillim të thirrjes islame, do të gjejë se Profeti fisnik ka qëndruar shumë solidar e me besim të ngulitur në luftën kundër fanatizmit fisnor dhe epidemisë së injorancës që ishte e përhapur në atë kohë në shoqërinë xhahile.

Islami vendosi përballë kësaj një kriter tjetër për të qenë më i mirë. Ai kriter është devotshmëria dhe vepra e mirë. I Lartësuari thotë: **"Në të vërtetë, më i miri ndër ju tek Allahu është më i devotshmi."**[112]

E mbi këtë bazë, i Dërguari i Allahut luftoi këdo që luftonte Islamin e qëndronte si pengesë përballë përhapjes së tij, edhe po të ishte njeriu më i afërm i tij për nga afrimiteti si p.sh. xhaxhai i tij e farefisi i tij. Kështu, Profeti e mallkoi xhaxhain e tij, Ebu Lehebin, e iu shmang atij: **"Qoftë i shkatërruar Ebi Lehebi, e ai më është shkatërruar. Atij nuk i bëri dobi pasuria e vet, as ajo çfarë fitoi…"**[113]

Nga ana tjetër, atij iu afrua kush besoi në të e i qëndroi besnik profetësisë së tij, edhe pse nuk kishte lidhje me të apo afrimitet farefisnor, madje, edhe sikur të ishte një skllav nga Abisinia apo nga paria, siç ka thënë për Selman Farisiun: "*Selmani është prej nesh, Ehli Bejtit.*"[114]

---

[111] Surja "El-En'am", ajeti 90.
[112] Surja "El-Huxhurat", ajeti 13.
[113] Surja "El-Mesed", ajetet 1-2.
[114] *Usdu'l-Gabe*, 2:421. *Musned Ebi Ja'la*, 6: 177/6739, Daru'l-Me'mun li't-Turath, Damask, bot. 1.

Profeti, kur kërkoi dashuri ndaj të afërmve të tij, duke e bërë atë si shpërblim të mesazhit të tij, me këtë, nuk nënkuptonte të gjithë të afërmit e tij, sepse kjo bie në kundërshtim me deklaratat e qarta të Kur'anit.

Si mund të kërkojë i Dërguari i Allahut dashuri ndaj atij të cilit e mallkon Allahu në Librin e Tij, siç është Ebu Lehebi?! Ai kërkon dashuri për një grup të veçantë dhe individë të caktuar nga të afërmit e tij, me anë të të cilëve, plotësohet mbrojtja dhe ruajtja e mesazhit islam. Prej tyre merret feja e saktë, prej tyre është shpëtimi nga kontradiktat e devijimi dhe ata janë imamët e pagabueshëm nga Ehli Bejti.

Profeti kërkon shpërblimin, i cili, në të vërtetë, kthehet tek myslimanët e jo tek Profeti dhe as tek Ehli Bejti i tij, sepse ata nuk kanë nevojë për një dashuri si kjo, veçse me një masë që u vlen të gjithë njerëzve në ruajtjen dhe mbrojtjen e parimeve të fesë, në Librin e qartë të Allahut dhe historinë e zotërisë së të Dërguarve.

Që këtu, bëhet e qartë se nuk ka vend për kontradikta ndërmjet ajetit dhe ajeteve të cilët mohojnë kërkimin e shpërblimit, sepse shpërblimi në ajete është shpërblim real e kjo nuk është ajo që kërkoi i Dërguari i Allahut, pasi vepra e tij është e sinqertë ndaj Allahut të Lartësuar. Shpërblimi tek ajeti është terminologjik, sepse ai kthehet me gjithë bekimin e të mirat e tij tek myslimanët; ai është deklarativ e i qartë tek thënia e Tij e Lartësuar**: "Thuaj: "Çfarëdo shpërblimi, që mund t'ju kem kërkuar, ai qoftë për ju..."** (Es-Sebe, 47)

Nga ajo që thamë më parë, vërtetohet se Ajeti i Dashurisë dhe tekstet komentuese të tij janë të mjaftueshme për të vërtetuar detyrën e dashurisë ndaj Ehli Bejtit për çdo mysliman. Për rrënjosjen e këtij parimi dhe thellimin e argumentimeve të tij, po përcjellim disa ajete të tjerë të cilët e shpjegojnë këtë kuptim.

1- Thënia e Allahut të Lartësuar: **"Me të vërtetë, ata të cilët kanë besuar dhe kanë bërë vepra të mira, Mëshiruesi do të krijojë për ta dashuri."**[115]

Eshtë transmetuar nga Xhabir ibn Abdil'lah, i cili ka thënë: I Dërguari i Allahut i ka thënë Ali ibn Ebi Talibit: *"O Ali, thuaj: O Zoti im! Hidh për mua dashuri në zemrat e besimtarëve! Zoti im, më bëj mua besnik tek Ti! Zoti im, më bëj mua të dashur tek Ti!"* Dhe Allahu i Lartësuar zbriti thënien e Tij: **"Me të vërtetë, ata të cilët kanë besuar dhe kanë bërë vepra të mira, Mëshiruesi do të krijojë për ta dashuri."** e nuk do të takosh besimtar e besimtare, veçse në zemrën e tyre do të gjesh dashuri për Ehli Bejtin."[116]

Hadithi është transmetuar nga Said ibn Xhubejri, nga Ibn Abbasi,[117] nga Ebi Said El-Khudrij[118], nga Bera ibn Hazibi[119] dhe nga Muhamed ibnu'l-Hanefije.[120]

---

[115] Surja "Merjem", ajeti 96

[116] *Shevahidu't-Tenzijl*, 1: 464/489. *Gajetu'l-Meram*, 373, kapitulli 73.

[117] *Mexhmau'z-Zeua'id*, 9: 125. *Khasaisu'l-Uahji'l-Mubijn*, 108, kapitulli 7. *Ed-Durru'l-Menthur*, 4:287.

[118] *Shevahidu't-Tenzijl*, 1: 474/504.

[119] *Feraidu's-Simtajn*, 1: 8 kapitulli 14. *El-Menakib* i Ibn Megazilijt, 327/374. *Keshfu'l-Gummeh*, 1:314. *Tefsiru'l-Keshf ue'l-Bejan* i Thealebijut në komentimin e ajetit. *Khasaisu'l-Uahji'l-Mubijn*, 71, kapitulli 7.

2- Dhe: **"Ai, i cili vjen me një të mirë, për atë ka një më të mirë se ajo…"**[121]

Transmetohet nga Imam Ebu Xha'fer El-Bakir *(paqja qoftë mbi të!)* të ketë thënë: Hyri Ebu Abdil'lah El-Xhedelij tek prijësi i besimtarëve e ai i tha: "O Ebu Abdil'lah, a të flas për thënien e Tij të Lartësuar: **"Ai, i cili vjen me një të mirë, ai ka një më të mirë se ajo…"**? Tha: "Po, t'u bëfsha kurban!" Imami i tha: *"E mira është dashuria për ne, Ehli Bejtin dhe e keqja, urrejtja jonë."* Pastaj lexoi ajetin."[122]

I njëjti hadith është transmetuar me gjuhën e Ebi Abdil'lah El-Xhedelijut.[123]

3- "Ata që besuan dhe me të përmendur Allahun, zemrat e tyre qetësohen; ta dini, se me të përmendur Allahun, zemrat qetësohen."[124]

Është transmetuar nga prijësi i besimtarëve, Imam Aliu *(paqja qoftë mbi të!)* se i Dërguari i Allahut, kur ka zbritur ky ajet, ka thënë: "*Ky është për ata të cilët e duan Allahun, të Dërguarin e Tij dhe e duan Ehli Bejtin me sinqeritet e jo me gënjeshtra. Për ata që i duan besimtarët në praninë e tyre e në*

---

120 *Er-Rijadu'n-Nadire* i El-Muhibb Et-Tabarij, 2: 125, Daru'l-Kutub, Bejrut. *Es-Saua'iku'l-Muhrikah*, 172. *Nuru'l-Ebsar*, 124.

121 Surja "El-Kasas", ajeti 84

122 *Keshfu'l-Gummeh*, 1:321, 324. *Tefsiru'l-Burhan* i El-Hysejnij El-Bahranij, 3: 212, Muessesetul Bi'the, Kum, botimi 1. *Mexhmau'l-Bejan* në komentimin e ajetit. *Jenabi'u'l-Meuedde*, 1: 292/5. *Feraidu's-Simtejn*, 2: 297-299. *Erxhahu'l-Metalib*, 84. *El-Menakib* i Ibnu'l-Megazilit, 138.

123 *Feraidu's-Simtajn*, 2:297. *Tefsiru'l-Keshf ue'l-Bejan* i Thealebijut në komentimin e ajetit.

124 Surja "Er-Ra'd", ajeti 28.

mungesë të tyre dhe me përmendjen e Allahut duhen me njëritjetrin."[125]

Janë transmetuar shumë ajete që komentojnë e vërtetojnë këtë kuptim me metoda të sakta nga Ehli Bejti, të cilat nuk po i përmendim për të mos u zgjatur.

[125] *Kenzu'l -'Ummal*, 1: 250. *Ed-Durru'l-Menthur*, 4: 58.

KËRKIMI I DYTË

Dashuria për Ehli Bejtin në traditën e pastër profetike

Siç u tha edhe më parë në kërkimin e parë, tekstet kur'anore vërtetuan parimin e dashurisë për Ehli Bejtin në formë të prerë që nuk pranon komentim.

Në këtë kërkim do të hedhim dritë mbi thëniet që janë transmetuar në Synetin e begatë e që vërtetojnë domosdoshmërinë e dashurisë ndaj Ehli Bejtit dhe prijëtarisë së tyre, si dhe sqarojnë mirësinë e dashurisë ndaj tyre, si dhe specifikat dhe shenjat e kësaj dashurie.

Syneti i begatë vërteton se dashuria ndaj Ehli Bejtit është bazë e Islamit, shenjë e besimit, adhurimi më i mirë dhe dashuria ndaj tyre është dashuri ndaj Allahut dhe ndaj të Dërguarit të Tij. Vërtetimi i këtyre përmbajtjeve tregon se dashuria për Ehli Bejtin mishërohet në udhëheqje, prirje e dashuri për mesazhin e Zotit. Madje, dashuria ndaj tyre është shtylla bazë për thellimin e përfaqësimit të Islamit, rrënja e lidhjes me besimin dhe forca ndërvepruese me të.

Leximi meditues i teksteve të haditheve, të cilat do t'i përmendim në këtë kërkim, na bëjnë shumë të qartë esencën e lidhjes ndërmjet parimit të dashurisë ndaj tyre e marrëdhënies me Mesazhin e Zotit.

Në vartësi të masës që rrënjoset ky parim në ndjenjat e ummetit e në ndërgjegjen e tij, ngrihet niveli i prijësisë

ndaj Mesazhit e besimit dhe përcaktohet identiteti fetar i ummetit (bashkësisë).

Në vijim do të përmendim përmbajtjet më të rëndësishme të dashurisë për Ehli Bejtin të transmetuara në Synetin e pastër, duke kujtuar se tekstet e haditheve që përshkruajnë këto përmbajtje kanë ardhur në dy rrugë. E para prej tyre: nga imamët e pagabueshëm; dhe e dyta: nga burimet e tyre duke treguar edhe emrat e tyre.

Nxitja për dashurinë ndaj tyre

1- I Dërguari i Allahut *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: *"Edukojini fëmijët tuaj me tri cilësi: Dashurinë ndaj Profetit tuaj, dashurinë ndaj Ehli Bejtit të tij dhe leximin e Kur'anit."*[126]

2- Dhe: *"Përmendeni Allahun për Ehli Bejtin tim! Përmendeni Allahun për Ehli Bejtin tim! Përmendeni Allahun për Ehli Bejtin tim!"*[127]

3- Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu *(paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: *"E mira më e madhe është dashuria për ne dhe e keqja më e madhe është urrejtja ndaj nesh."*[128]

---

[126] *Kenzu'l-'Ummal*, 16: 456/45409. *Es-Saua'iku'l-Muhrika*, 172. *Fajdu'l-Kadijr*, 1: 225/311.
[127] *Sahijhu Muslim*, 4: 1873/2408. *Musnedu Ahmed*, 4: 367. *Es-Sunenu'l-Kubra* i Bejhakiut, 2: 148 dhe 7: 30.
[128] *Guraru'l-Hikem*, 1: 211/3363.

Dashuria ndaj tyre është dashuri ndaj Allahut dhe ndaj të Dërguarit të Tij

1. I Dërguari i Allahut *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: *"Duajeni Allahun për atë që ju ushqen nga begatitë e Tij, më doni mua për dashurinë që keni ndaj Allahut dhe duajeni Ehli Bejtin për dashurinë që keni ndaj meje."*[129]

2. Zejd ibn Erkami ka thënë: "Isha tek i Dërguari i Allahut dhe kaloi Fatimeja. Ajo kishte dalë nga shtëpia e saj për tek dhoma e Profetit. Bashkë me të ishin dy fëmijët e saj, Hasani dhe Hysejni, ndërsa Aliu ishte pas tyre. Ndërkohë, Profeti i pa ata e tha: *"Ai që i do ata, më ka dashur mua dhe ai që i urren ata, më ka urryer mua."*[130]

3. Prijësi i besimtarëve *(paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: "Kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut duke thënë: *"Unë jam zotëria i bijve të Ademit, ndërsa ti, o Ali, dhe imamët pas teje, janë zotërinjtë e ummetit tim. Kush do të na dojë neve, do Allahun dhe kush na urren neve, urren Allahun. Ata që na pasojnë neve, kanë ndjekur Allahun dhe kush tregon armiqësi ndaj nesh, ka treguar armiqësi ndaj Allahut. Kush na bindet neve, i është bindur Allahut e kush na kundërshton, ka kundërshtuar Allahun."*[131]

---

[129] *Sunenu't-Tirmidhij*, 5: 664/3789. *Hiljetu'l-Eulija ue Tabakatu'l-Esfija* i Ebu Naim El-Isfahanit, 3: 211, Daru'l-Kitabi'l-Arabij, Bejrut, botimi 4. *Tarijkhu Bagdad*, 4: 159. *Usdu'l-Gabeh*, 2: 13. *El-Mustedrek 'ala's-Sahihejn*, 3: 150. Ka thënë për të është hadith me zinxhir të saktë dhe është dakort me të edhe Dhehebiu.

[130] Biografia e Imam Hysejnit nga *Tarijkh Medineti Dimashk*, 91/126.

[131] *Emali's-Saduk*, 384/16, Menshurat Muessesetu'l-A'lemij, Bejrut, bot. 5.

4. Imam Sadiku *(paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: "Ai që e njeh të drejtën tonë dhe na do neve, ka dashur Allahun e Lartësuar."[132]

Dashuria ndaj tyre është bazë e Islamit

1- I Dërguari i Allahut *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: "*Baza e Islamit është dashuria për mua dhe dashuria për Ehli Bejtit tim.*"[133]

2- Dhe: "*Çdo gjë e ka një bazë dhe baza e Islamit është dashuria për Ehli Bejtin.*"[134]

3- Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu *(paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: Më ka thënë mua i Dërguari i Allahut: "*O Ali, në të vërtetë, Islami është i zhveshur, kështu që rroba e tij është devotshmëria, pendët e tij janë udhëzimi, stolia i tij është turpi, shtylla e tij është besimi, etaloni i tij është vepra e mirë dhe baza e Islamit është dashuria ndaj meje e Ehli Bejtit tim.*"[135]

Dashuria ndaj tyre është adhurim

1- I Dërguari i Allahut *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: "*Dashuria ndaj familjes së*

---

[132] *El-Kafij*, 8: 112/98. *Mexhmuatu Uerram,* 2: 137, Daru Sa'b, Daru't-Te'aruf, Bejrut.

[133] *Kenzu'l-'Ummal*, 12: 105/34206. *Ed-Durru'l-Menthur*, 6 :7.

[134] *El-Mehasin* i El-Berkijut, 1: 247/461, El-Mexhmaul-'Alemij li Ehli'l-Bejt, Kum, botimi 1.

[135] *Kenzu'l-'Ummal, 13: 645/37631.*

Muhamedit një ditë është më e mirë se adhurimi për një vit. Ai i cili vdes me dashuri ndaj tyre, futet në Xhennet."[136]

2- Dhe: "*Dije se gjëja e parë në adhurimin e Allahut është njohja e Tij… Pastaj besimi tek unë dhe dëshmia se Allahu më ka dërguar mua tek të gjithë njerëzit si përgëzues, qortues e thirrës për te Allahu, me lejen e Tij dhe pishtar ndriçues. E më pas, dashuria për Ehli Bejtin tim, prej të cilëve Allahu largoi papastërtitë, duke i pastruar ata në mënyrë absolute."*[137]

3- Imam Sadiku *(paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: "*Mbi çdo adhurim ka një adhurim dhe dashuria ndaj nesh, Ehli Bejtit, është adhurimi më i mirë."*[138]

Dashuria ndaj tyre është shenjë e besimit

1. I Dërguari i Allahut ka thënë: "*Nuk beson dikush, deri sa të jem më i dashur sesa vetja e tij, familja ime të jetë më e dashur për të sesa familja e tij, pasardhësit e mi më të dashur për të sesa pasardhësit e tij dhe vetja ime ime më e dashur për të sesa vetja e tij."*[139]

---

[136] *El-Firdeus bi Me'thuri'l-Khitab* i Ed-Dejlemijut, 2: 142/2721, Daru'l Kutubi'l-Ilmije, Bejrut, botimi 1. *Nuru'l-Ebsar*, 127. El-Kafij, 2: 46/3.

[137] *Emali't-Tusij*, 526/1162, Muessesetu'l-Bi'the, Kum, bot. I. *Mekarimu'l-Akhlak* i Tabrasijut, 2: 363/2661, Muessesetu'n-Neshri'l-Islamij, Kum. *Mexhmuatu Uerram*, 2: 51-52.

[138] *El-Mehasin*, 1: 247/462.

[139] *El-Mu'xhemu'l-Eusat* i Taberanijut, 6: 116/5790. *El-Mu'xhemu'l-Kebijr* i Taberanijut, 7: 86/6416. *El-Firdeus*, 5: 154/7796 dhe *Emali's-Saduk*, 274/9. *'Ilelu'sh-Sherai'* i Sadukut, 140/3, Menshuratu'l-Mektebeti'l-Hajdarije, En-Nexhefu'l-Eshref.

2. Dhe: "*Nuk na do ne, Ehli Bejtin, veçse besimtari i devotshëm dhe nuk na urren ne, veçse hipokriti fatkeq.*"[140]

3. Imam Bakiri *(paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: "*Dashuria ndaj nesh është besim dhe urrejtja është mosbesim.*"[141]

4. Dhe: "*Me të vërtetë, dashuria jonë për Ehli Bejtin është diçka që e shkruan Allahu në zemrën e robit të Tij. Atij të cilit ia shkruan Allahu në zemrën e tij, nuk mundet askush që ta fshijë. A nuk e ke dëgjuar Allahun të thotë:* **"… janë ata, për të cilët ka shkruar besimin në zemrat e tyre, duke i mbështetur e përkrahur me shpirt prej Tij…"**? *Kështu, dashuria për ne, Ehli Bejtin, është nga origjina e besimit.*"[142]

Dashuria për ta është shenjë e lindjes së pastër (*tijbu'l-uiladeh*)

1. I Dërguari i Allahut *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, duke treguar për prijësin e besimtarëve, ka thënë: "*O ju njerëz, mësojuni fëmijëve tuaj dashurinë ndaj tij. Me të vërtetë, Aliu nuk fton në rrugë të humbur dhe nuk largon nga udhëzimi. Kush e do atë, ai është prej jush dhe kush e urren atë, nuk është prej jush.*"[143]

2. Është transmetuar nga Ebu Bekri të ketë thënë: "Pashë të Dërguarin e Allahut që ngriti një tendë dhe ishte i mbështetur mbi një hark arab. Në çadër ishte Aliu, Fatimeja, Hasani dhe Hysejni. Në këtë moment tha: "*O myslimanë, unë*

[140] *Dhekhairu'l-'Ukba*, 218. *Es-Sava'iku'l-Muhrika*, 230.
[141] *El-Kafij*, 1: 188/12. *El-Mehasin*, 1: 247/463.
[142] *Shevahidu't-Tenzijl*, 2: 330/971.
[143] Biografia e Imam Aliut nga *Tarijkh Medineti Dimashk*, 2: 225/730.

jam në paqe me ata të cilët janë në paqe me banorët e tendës, në luftë me ata që i luftojnë ata, kujdestar i atyre që i ndjekin ata, mbrojtës i atyre që i mbrojnë ata; nuk i do ata, veçse një gjysh i lumtur e një i lindur i mirë dhe nuk i urren ata, veçse një gjysh fatkeq e një i lindur i rëndomtë."[144]

3. Nga prijësi i besimtarëve *(paqja qoftë mbi të!)* përcillet një këshillë e Profetit për Ebi Dherin, që i ka thënë: *"O Eba Dher, ai, i cili na do ne, Ehli Bejtin, të falënderojë Allahun për begatinë më parësore.' Ebu Dherri i tha: 'O i Dërguari i Allahut, cila është begatia më parësore?' Profeti iu përgjigj: "Lindja e pastër, sepse nuk na do ne, veçse ai që lind me lindje të pastër."*[145]

4. I Dërguari i Allahut *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: *"O Ali, ai që më do mua, që të do ty dhe i do imamët nga fëmijët e tu, le të falënderojë Allahun për mirësinë e të lindurit të tij të pastër, sepse nuk na do ne veçse ai që lind me lindje të pastër dhe nuk na urren ne veçse ai që lind me lindje të papastër."*[146]

5. Imam Sadiku *(paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: *"Betohem në Allahun, nuk na do neve njeri nga arabët apo joarabët me përjashtim të shtëpive fisnike e bujare dhe nuk na urren neve nga ato e këto, veçse banorët e përlyer me ndytësi."*[147]

---

[144] *Er-Rijadu'n-Nadirah*, 2: 189. *Menakibu'l-'Ashera*, 189. *Erxhahu'l-Metalib*, 309.

[145] *Emali't-Tusij*, 455/1018. *Me'ani'l-Akhbar* i Sadukut, 161/1, Daru'l-Ma'rife, Bejrut. *Emali's-Saduk*, 383/12. *'Ilelu'sh-Sherai'*, 141/1. *El-Mehasin*, 1: 232/411.

[146] *Emali's-Saduk*, 384 /14. *Me'ani'l-Akhbar*, 161/3.

[147] *El-Kafij*, 8: 162/497.

6. 'Ubade ibn Samiti ka thënë: "I testonim fëmijët tanë me dashurinë ndaj Ali ibn Ebi Talibit. Nëse vërenim dikë që nuk e donte Ali ibn Ebi Talibin, e dinim se ai nuk ishte më nga tanët dhe se ai nuk ishte në rrugë të drejtë."[148]

Dashuria ndaj tyre është nga ato gjëra, për të cilat, do të pyetet Ditën e Ringjalljes

1. I Dërguari i Allahut *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: *"Gjëja e parë për të cilën do të pyetet robi, është dashuria për ne, Ehli Bejtin."*[149]

2. Dhe: *"Nuk lëvizin këmbët e robit në Ditën e Ringjalljes, derisa të pyetet për katër gjëra: për moshën e tij se ku e ka kaluar, për trupin e tij ku e ka shfrytëzuar, për pasurinë e tij ku e ka shpenzuar dhe ku e ka fituar dhe për dashurinë ndaj nesh, Ehli Bejtin."*[150]

3. Njësoj si ky hadithi me shtesë në fundin e tij: *"O i Dërguari i Allahut, cila është shenja e dashurisë ndaj jush?" Ai rrahu me dorën e tij shpatullat e Aliut."*[151]

---

[148] Biografia e Imam Aliut nga *Tarijkh Medineti Dimashk*, 2: 224/727.

[149] *'Ujun Akhbari'r-Rida* i Sadukut, 2: 62/258, El-Matbaatu'l-Hajdarije, En-Nexhefu'l-Eshref.

[150] *El-Mu'xhemu'l-Kebijr* i Taberanijut, 11: 102/11177. E*l-Mu'xhemu'l-Eusat* i Taberanijut, 9: 264-265/9406. *El-Menakib* i Ibnu'l Megazilit, 120/157. *El-Khisal* i Sadukut, 253/125, një grup profesorësh, Kum. *Kenzu'l-'Ummal*, 7: 212. *Mexhmuatu'l-Uerram*, 2: 75.

[151] *El-Mu'xhemu'l-Eusat* i Taberanijut, 2: 348/2191. El-*Menakib* i Khauarizmit, 77/59.

Dashuria për Imam Aliun

Përmbajtjet që treguam pak më parë, të cilat përfaqësojnë një përmbledhje të teksteve islame dhe që përshkruajnë mirësinë e dashurisë ndaj Ehli Bejtit, specifikat dhe shenjat e tyre, mishërohen, gjithashtu, edhe te individët e Ehli Bejtit.

Kjo pasqyrohet më së qarti gjatë leximit të haditheve të transmetuara për dashurinë ndaj prijësit të besimtarëve, Imam Aliut *(paqja qoftë mbi të!)* duke e konsideruar atë si shenjë të dashurisë së Ehli Bejtit.

Është transmetuar nga i Dërguari i Allahut *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* që ka thënë: *"Nuk beson askush, derisa të dojë Ehli Bejtin, për hir të dashurisë time."* Ndërkohë, Umer ibn El-Khattabi i thotë: "Cila është shenja e dashurisë së Ehli Bejtit tënd?" Ai tha: *"Ky!"* dhe goditi me dorën e tij Aliun."[152]

Që këtu, përforcimi për dashurinë ndaj prijësit të besimtarëve, Aliut, është një përforcim për dashurinë ndaj të gjithë Ehli Bejtit, është kapja pas tyre dhe rrugëtimi në gjurmët e tyre.

Mirësia e dashurisë ndaj tij

1. I Dërguari i Allahut *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: *"Titulli i Sahifes (librit të të mirave) së besimtarit është dashuria ndaj Aliut."*[153]

---

[152] *Es-Saua'iku'l-Muhrika*, 228. *Nadhm Durari's-Simtejn*, 233.

[153] *Tarijkhu Bagdad*, 4: 410. *El-Xhamiu's-Sagijr* i Sujutijut, 2: 182/5633, Daru'l-Fikr, Bejrut, bot. 1. *El-Menakib* i Ibnu'l-Megazilit, 243.

2. Dhe: *"Shpëtim nga Zjarri është dashuria për Aliun."*[154]

3. Dhe: *"O Ali! I lumtur është ai që të do ty e tregohet i sinqertë rreth teje dhe mjerë për atë që të urren ty e gënjen rreth teje."*[155]

Përse ta duam Aliun?

Dashuria jonë për prijësin e besimtarëve *(paqja qoftë mbi të!)* nuk është në mënyrë spontane. Ajo është nga bërthama e ideologjisë islame dhe nga aksiomat e saj.

Për më tepër, janë transmetuar tekste të haditheve që mbartin argumentet e këtij parimi, parametrat dhe shkaqet e tij. Nëse thellohemi tek këto tekste, do të bëhet i qartë për ne sinqeriteti i kësaj dashurie e thellësia e bazës së saj dhe kjo për shkaqet e mëposhtme:

Së pari: Dashuria ndaj tij është një urdhër i Zotit

Allahu i Lartësuar e urdhëroi të Dërguarin e Tij më fisnik për dashuri ndaj prijësit të besimtarëve. Për këtë është detyrë për ne që të veprojmë atë që Allahu e ka urdhëruar të Dërguarin e Tij.

Burejdeja transmeton nga babai i tij, i cili ka thënë: Ka thënë i Dërguari i Allahut *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin*

---

[154] *El-Mustedrek 'ala's-Sahijhejn*, 2: 241.

[155] *El-Mustedrek 'ala's-Sahijhejn*, 3: 135. Dhe ka thënë: Ky hadith është me zinxhir transmetimi të saktë dhe nuk e përjashtojnë atë. *Tarijkhu Bagdad*, 9: 71. *El-Bidaje ue'n-Nihaje*, 7: 355. *Mexhmau'z-Zeua'id*, 9: 132. *Dhekhairu'l-'Ukba*, 91.

mbi tëdhe mbi familjen e tij!): *"Në të vërtetë, Allahu më ka urdhëruar mua që të dua katër dhe më lajmëroi se Ai i do ata."* I thanë: *"E cilat janë ata, o i Dërguari i Allahut?"* Profeti tha: *"Aliu është prej tyre, Aliu është prej tyre."* duke e përsëritur tri herë. *"Edhe Ebu Dherrin, Mikdadin dhe Selmanin: më urdhëroi t'i dua ata."*[156]

Përsëritja tri herë e emrit të prijësit të besimtarëve nga Profeti *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi tëdhe mbi familjen e tij!)* përshkruan rëndësinë shumë të madhe që i ka dhënë ai kësaj çështjeje.

Po ashtu, na sqaron se çështja e dashurisë ndaj Ebu Dherrit, Mikdadit dhe Selmanit është degë e dashurisë ndaj prijësit të besimtarëve dhe kjo për arsye se ata sahabë, bashkëkohës, kanë qenë çertifikuesit e vërtetë të ithtarëve (*shi'a*) të prijësit të besimtarëve, kanë qenë të dashurit e tij dhe kanë rrugëtuar në udhën e tij. Për më tepër, historia e tyre tregon thellësinë e devotshmërisë së tyre në ndjekjen e tij (Imam Aliut).

Së dyti: Në të vërtetë, Allahu i Lartësuar dhe i Dërguari i Tij e duan prijësin e besimtarëve

Tekstet që vërtetojnë një gjë të tillë janë të shumta, por ne po mjaftohemi me dy hadithe:

---

156 *Sunenu't-Tirmidhij*, 5: 636/3718. *Sunen Ibn Maxheh*, 1: 53/149. *El-Mustedrek 'ala's-Sahijhejn*, 3: 130. *Musned Ahmed*, 5: 351. *Usdu'l-Gabe*, 5: 253. Biografi nga *Tarijkh Ibn Asakir*, 2: 172/666. *El-Isabeh*, 6: 134. *Es-Saua'iku'l-Muhrika*, 122, kapitulli 9. *Tarijkhu'l-Khulefa* i Sujutijut, 187. *Sijeru A'lami'n-Nubela*, 2: 61. *Er-Rijadu'n-Nadire*, 3: 188. *Menakibu'l Khavarizmij*, 34.

1. Hadithi i shpendit *(Hadijthu't-Tair)*

Ky hadith vërteton se prijësi i besimtarëve *(paqja qoftë mbi të!)* është krijesa më e dashur tek Allahu. Është transmetuar me sened nga Enes ibn Malik, i cili ka thënë: "Profeti kishte një shpend që ia kishin dhuruar." Ai tha: "*O Allah i Plotpushtetshëm, më sill mua krijesën Tënde më të dashur që të hajë me mua këtë shpend."* Ndërkohë, vjen Aliu dhe unë e ktheva. Vjen përsëri dhe e ktheva. Ndërkohë erdhi për të tretën dhe të katërtën herë. Profeti i tha atij: "*Çfarë gjëje të pengoi ty për tek mua?"* Imam Aliu i tha: "*Betohem në Atë që të ka dërguar ty me të drejtë profet, unë i rashë portës tri herë dhe Enesi më kthente mua mbrapsht."* Ndërkohë, i Dërguari i Allahut i tha (Enesit): "*Po përse e ktheve ti atë?"* I thashë: "*Do të dëshiroja të ishte një burrë nga ensarët."* Profeti më buzëqeshi."[157]

---

[157] *Sunenu't-Tirmidhij*, 5: 636/3721. *El-Khasais* i Nisaijut, 5. *Fadailu's-Sahabe* i Ahmed ibn Hanbelit, 2: 560/945. *El-Mustedrek 'ala's-Sahijhejn*, 3: 130-132, e saktësoi atë dhe tha: E kanë transmetuar atë nga Enesi më shumë se tridhjetë veta. *Mesabijhu's-Sunneh*, 4: 173/4770. *Usdu'l-Gabe*, 4: 110-111. *Tarijkhu'l-Islam*, 3:633. *El-Bidaje ue'n-Nihaje*, 7: 350-353. *Xhamiu'l-Usul*, 8: 653/6494 e ka nxjerrë atë Ibn Asakiri nga biografia e prijësit të besimtarëve, 27: 106-134 nga dyzet e katër mënyra. *Er-Rijadu'n-Nadire*, 3: 114-115. *Dhekhairu'l-'Ukba*, 61. *Kifajetu't-Talib*, 144-156 dhe ka bërë llogarinë që 86 njerëz që të gjithë e kanë transmetuar nga Enesi. Dhe në *Maktelu'l-Hysejn* i El-Khavarizmit, 2: 46, ka thënë: Ibn Merdeuejhi e ka përcjellë këtë hadith me një zinxhir prej njëqind e njëzet vetash.

2. Hadithi i flamurit *(Hadijthu'r-Rajeh)*

Edhe ky është një tjetër argument i yni për dashurinë e Allahut të Lartësuar dhe të Dërguarit të Tij ndaj prijësit të besimtarëve. Kjo dashuri e Allahut dhe e Profetit ndaj prijësit të besimtarëve Imam Aliut na obligon ne që ta duam, ta ndjekim dhe të ecim në rrugën e tij.

Flamuri që përmendet është ai i Khajberit, me të cilin, i Dërguari i Allahut e dërgoi Ebu Bekrin dhe ai u kthye e nuk bëri asgjë. Pas tij dërgoi Umerin edhe ai u kthye e nuk çliroi gjë."[158]

Në transmetimin e Tabariut thuhet: "U kthye duke frikësuar shokët e tij e ata e frikësonin atë."[159] U ngrit i Dërguari i Allahut mes tyre e tha: *"Do t'ia jap flamurin nesër një burri që e do Allahun dhe të Dërguarin e Tij dhe atë e do Allahu dhe i Dërguari i Tij, i palëkundur dhe jo ikacak."* Në një transmetim thuhet: *"… atë nuk e poshtëron kurrë Allahu e që kthehet çlirimtar."*[160]

---

[158] *El-Kamil fi't-Tarijkh*, 2: 219. *Usdu'l-Gabe*, 4: 104 dhe 108. *El-Khasais* i Nisaijut, 5. *El-Bidaje ue'n-Nihaje*, 7: 336. *Hiljetu'l-Eulija*, 1: 62. *Delailu'n-Nubuve* i Bejhakijut, 4: 209, Daru'l-Kutubi'l-'Ilmije, Bejrut, botimi 1.

[159] *Tarijkhu't-Tabarij*, 3: 93, e saktësoi atë Hakimi në *El-Mustedrek*, 3: 37 dhe e ka pranuar Dhehebiu.

[160] *Sahijhu'l-Bukharij*, 5: 87/197-198 dhe 279/231 kapitulli Fadailu's-Sahabe. *Sahijhu Muslim*, 4: 1871/32-34. *Sunenu't-Tirmijdhij*, 5: 638/3724. *Sunen Ibn Maxheh*, 1: 43/117. *Musnedu Ahmed*, 1: 185 dhe 5: 358. *El-Mustedrek 'ala's-Sahijhejn*, 3: 37 dhe 109. *Mesabijhu's-Sunneh*, 4: 93/4601. *El-Khasais* i Nisaijut, 4-8. *Delailu'n-Nubuve* i Bejhakijut, 4: 205-206. *El-Istij'ab*, 3: 36. *Fadailu's-Sahabe* i Ahmed ibn Hanbelit, 2: 584/987 dhe 988 etj. *Tarijkhu't-Tabarij*, 3: 93. *El-Kamil fi't-Tarijkh*, 2: 219. *Usdu'l-Gabe*, 4: 104

Së treti: Dashuria ndaj tij është dashuri për Allahun dhe për të Dërguarin e Tij

1. I Dërguari i Allahut *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: *"Ai, i cili e do Aliun, më do mua dhe ai, i cili e urren Aliun, më urryen mua."*[161]

2. *"Ai, i cili më do mua, le ta dojë Aliun. Ai, i cili e urren Aliun, më ka urryer mua. Ai, i cili më urren mua, ka urryer Allahun e Lartësuar e të Lavdishëm dhe ai, i cili e urren Allahun, Allahu e fut atë në Zjarr."*[162]

3. *"Ai, i cili e do Aliun, më do mua. Ai që më do mua, do Allahun. Ai që urren Aliun, më urren mua dhe ai, i cili më urren mua, ka urryer Allahun e Lartësuar e të Lavdishëm."*[163]

Nga ajo që u tha më sipër, bëhet e qartë se dashuria ndaj prijësit të besimtarëve shpie në dashuri ndaj Profetit dhe ndaj Allahut të Lartësuar dhe ky është qëllimi që synojnë besimtarët e Allahut dhe është shpresa e atyre që shpresojnë.

---

dhe 108. *El-Bidaje ue'n-Nihaje*, 7: 224 dhe 336. *Hiljetu'l-Eulija*, 1: 62. *Xhamiu'l-Usul*, 8: 650/6491, 6495 dhe 6497 e shumë të tjerë.

[161] *El-Mustedrek 'ala's-Sahijhejn*, 3: 130. *Menakibu'l-Khavarizmij*, 41. *El-Xhamiu's-Sagijr*, 2: 554/8319. *Usdu'l-Gabe*, 4: 383. *El-Isabe*, 3: 497. *Dhekhairu'l-'Ukba*, 65. *Er-Rijadu'n-Nadira*, 1: 165. *Mexhmau'z-Zeua'id*, 9: 108 dhe 129. *Kenzu'l-'Ummal*, 6: 154

[162] *Tarijkhu Bagdad*, 13: 32.

[163] *Er-Rijadu'n-Nadira*, 3: 122. *Es-Saua'iku'l-Muhrika*, 123. *El-Istij'ab*, 3: 1100.

Së katërti: Dashuria e tij është besim dhe urrejtja e tij është hipokrizi

1. Është transmetuar me zinxhir nga Ummu Selemeja, e cila ka thënë: I Dërguari i Allahut *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* thoshte: *"Aliun nuk e do vetëm se një hipokrit dhe nuk e urren atë vetëm se një besimtar."*[164]

2. Prijësi i besimtarëve *(paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: *"Betohem në Atë që krijoi farën dhe shëron sëmundjen, me të vërtetë, është besëlidhja e Profetit të pashkolluar ndaj meje, se nuk më do mua veçse një besimtar dhe nuk më urren mua veçse një hipokrit."*[165]

3. Po ashtu, ka thënë: "Sikur të godisja hundën e besimtarit me shpatën time që të më urrejë mua, ai nuk do më urrente. Edhe sikur t'i jepja hipokritit të gjithë botën me çfarë ka në të që të më dojë mua, nuk do më donte dhe kjo për arsyen se është thënë një gjë e tillë me gjuhën e Profetit më fisnik: *"O Ali, nuk të urren ty asnjë besimtar dhe nuk të do ty asnjë hipokrit."*[166]

---

[164] *Sunenu't-Tirmidhij*, 5: 635/3717. *Xhamiu'l-Usul*, 8: 656/6499. *Mexhma'u'z-Zeuaid*, 9: 133.

[165] *Sahijhu Muslim*, 1: 86/131. *Sunenu't-Tirmidhij*, 5: 643/3736. *Sunenu'n-Nisaij*, 8: 116 dhe 117. *Sunen Ibn Maxheh*, 1: 42/114. *Mesabijhu's-Sunneh*, 4: 171/4763. Biografia e prijësit të besimtarëve nga *Tarijkhu Medineti Dimashk*, 2: 190/682-685. *El-Bidaje ue'n-Nihaje*, 7: 54. *El-Isabe*, 4: 271. *Musnedu Ahmed*, 1: 84, 95 dhe 128. *Tarijkhu'l-Khulefa*, 187.

[166] *Nehxhu'l-Belaga*, Urtësia 45. *Mexhmau'l-Bejan*, 3: 532. *El-Kafij*, 8: 224/396. *Raudatu'l-Ua'idhijn* i Nijsaburijut, 323, Menshuratu'r-Rida, Kum.

4. Ebu Said El-Khudrij ka thënë: "*Ne (ensarët) i njihnim hipokritët nëpërmjet urrejtjes që kishin ndaj Ali ibn Ebi Talibit.*"[167]

5. Ebu Dherri ka thënë: "*Nuk i kemi njohur hipokritët, veçse me gënjeshtrat e tyre ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij, zmbrapsjen nga namazi dhe urrejtjen ndaj Aliut.*"[168]

Si rrjedhojë, dashuria për prijësin e besimtarëve, Aliun, është nga shenjat e besimit.

Nuk ka njeri që beson tek Allahu i Lartësuar dhe i Dërguari i Tij, veçse ai dëshiron të mbesë me cilësitë e besimit, ku nga kriteret më të rëndësishme të saj, janë dashuria ndaj urdhrit të Allahut të Lartësuar, dashuria ndaj Tij e dashuria ndaj atij që do Allahu i Lartësuar dhe i Dërguari i Tij.

Urrejtja e Imam Aliut është nga shenjat e hipokrizisë. Nuk e urren atë veçse një hipokrit, siç bëhet e qartë në hadithet e mëparshme. Dhe në këtë kontekst, Ahmed ibn Hanbeli ka thënë: "Gjithësesi, hadithi, për të cilin nuk ka fare dyshim, është thënia e Profetit: "*Nuk të do ty, veçse një besimtar dhe nuk të urren ty, veçse një hipokrit.*" Allahu i Lartësuar e i Lavdishëm ka thënë: **"Me të vërtetë,**

---

[167] *Sunenu't-Tirmidhij*, 5: 635/3717. *Is'afu'r-Ragibijn*, 113. *Nuru'l-Ebsar*, 88. *Mexhmau'z-Zeuaid*, 9:132. *Er-Rijadu'n-Nadire*, 3:242. *Es-Sauaiku'l-Muhrika*, 122. E ka transmetuar Taberaniu në *El-Mu'xhemu'l-Eusat*, 2: 391/2146 nga Xhabiri.

[168] *El-Mustedrek 'ala's-Sahijhejn*, 3: 129. Ka thënë: Është i saktë sipas Dy Shejkhëve. *Esma'l Menakibi fi Tehdhijbi Esna-l-Metalib* i El-Xhezerij Esh-Shafi'ij, 57, Muessesetu'l-Mahmudij, Bejrut. *Kenzu'l-'Ummal*, 13: 106.

hipokritët janë në shkallën më të fundit të Zjarrit.[169] Kështu, ai që e urren Aliun, do të jetë në shkallën më të fundit të Zjarrit."[170]

Dashuria për Fatime Zahranë

Fatime Zahraja *(paqja qoftë mbi të!)* është nga Ehli Bejti, për të cilët, është detyrim i yni që t'i duam ata. Dashuria për Zahranë buron nga dashuria e të Dërguarit të Allahut për të, kështu që ajo është sinëna e babait të saj[171], pjesë e tij dhe shpirti i tij, i cili është ndërmjet dy krahëve të tij.

E ka dashur aq shumë, saqë nuk ka të ngjashëm me dashurinë e baballarëve për vajzat e tyre, një dashuri e cila buronte nga emocioni atëror dhe jo vetëm kaq, por dashuria e tij për të ishte e mbushur me respekt e nderim.

Zahraja karakterizohej nga mirësitë individuale, dhuntitë dhe veçoritë dalluese unike. Ajo ishte bija e parë e Islamit, e cila u rrit në krahët e Profetësisë, u rinua nën kujdesin e prijësisë, e pastër dhe e mbrojtur nga çdo gjë e ndyrë dhe e turpshme. Është gruaja shembull në Islam dhe e denjë për t'u ndjekur nga gratë në çdo kohë e në çdo vend.

Në çdo tubim, i Dërguari i Allahut përmendte madhështinë e Zahrasë, nxirrte në pah virtytet e larta të saj

---

169 Surja "En-Nisa", ajeti 145.

170 *Mukhtesaru Tarijkhi Medineti Dimashk* i Ibn Mendhurit, 17: 375, Daru'l Fikr, Damask, botimi 1.

171 Bëhet fjalë për pseudonimin e saj "*Ummu Ebijha*" (Sinëna e të atit), për arsye të përkujdesjes që tregonte për të atin, Profetin (*paqja dhe bekimet e Allahut qofshin për të dhe familjen e tij!*). (Shënim i përkthyesit)

dhe sqaronte e pozitës së saj tek Allahu i Lartësuar dhe tek i Dërguari i Tij. Kjo, për arsyen që t'i nxiste myslimanët për dashuri ndaj saj e konsideratë për të pas tij sepse ajo ishte pasardhësja e fundit për të, nëna e prijësve të pagabueshëm, e udhëheqësve të pagabueshëm të myslimanëve, e rojtarëve mbrojtës të mesazhit islam e traditës së gjyshit të tyre të zgjedhur.

Tani do të përmendim diçka që ka ardhur nga i Dërguari më fisnik *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e çfarë thuhet në historinë e tij në lidhje me dashurinë ndaj Zahrasë *(paqja qoftë mbi të!)*:

1. I Dërguari i Allahut *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: *"Fatimeja është një pjesë e imja. Ai që e zemëron atë, më ka zemëruar mua."*[172]

2. Dhe: *"Fatimeja është pjesë e imja. Më paqëton mua çfarë e paqëton atë dhe më lëndon mua çfarë e lëndon atë."*[173]

3. Dhe: *"O Fatime, me të vërtetë, Allahu zemërohet për zemërimin tënd dhe kënaqet për kënaqësinë tënde."*[174]

---

[172] *Sahijhu'l-Bukharij*, 5: 92/209 dhe 150/255. *Sahijhu Muslim*, 4: 1902/93-2449. *Sunenu't-Tirmidhij*, 5: 698/3867. *Mesabijhu's-Sunneh*, 4: 185/4799. *El-Mustedrek* i Hakimit, 3: 158. *Mexhmau'z-Zeuaid*, 9: 203. *El-Xhamiu's-Sagijr*, 2: 208/5833.

[173] *Sahijhu'l-Bukharij*, 7: 65-66/159 Kitabu'n-Nikah, dhe rreth tij në *Musned*in e Ahmedit, 4: 5, 223 328 dhe 332. *Sunenu't-Tirmidhij*, 5: 698/3869. *Mustedreku'l-Hakim*, 3: 154, 158 dhe 159. *Khasaisu'n-Nisaij*, 36. *Hiljetu'l-Eulija*, 2: 240. *Kenzu'l-'Ummal*, 6: 219 dhe 8: 315. *Es-Saua'iku'l-Muhrika,* 190. *El-Imametu ue's-Sijaseh*, 1: 14.

[174] *El-Mustedrek* i Hakimit, 3: 513. *Usdu'l-Gabe*, 7: 224. *El-Isabe*, 8: 159. *Es-Saua'iku'l-Muhrika*, 175, pjesa e 11, kapitulli 1, qëllimi i tretë. *El-*

4. Transmetohet nga Aishja, e cila ka thënë: *"Nuk kam parë ndonjë më të ngjashëm në fjalë e bisedë me të Dërguarin e Allahut sesa Fatimen. Kur hynte tek ai, Profeti ngrihej në këmbë, e puthte atë dhe e ulte pranë tij dhe kur hynte ai, Fatimeja ngrihej në këmbë për të, e puthte dhe e ulte pranë vetes."*[175]

5. Transmetohet se Aishja është pyetur: *"Cili nga njerëzit ka qenë më i dashur tek i Dërguari i Allahut?"* Ka thënë: *"Fatimeja."* I kanë thënë: *"Po nga burrat?"* Është përgjigjur: *"Bashkëshorti i saj."*[176]

6. Burejdeja ka thënë: *"Nga gratë që ka dashur më shumë i Dërguari i Allahut ka qenë Fatimeja dhe nga burrat, Aliu."*[177]

Pavarësisht vërtetimit të dashurisë ndaj Zahrasë me Kur'an e Synet, siç u tha më lart, pas vdekjes së babait të saj, Profetit Muhamed *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!),* ajo u përball me mënyrën e llojin më çnjerëzor të padrejtësisë.

Asaj i uzurpuan trashëgiminë e të atit, e zemëruan atë, e dëmtuan atë, saqë u detyrua të diskutojë dhe të përballet duke u përmendur thëniet e babait të saj të zgjedhur të cilat theksonin obligueshmërinë e myslimanëve për dashurinë ndaj saj.

Khasaisu'l-Kubra, 2: 265. *Tehdhijbu't-Tehdhijb*, 12: 441. *Kenzu'-'Ummal*, 6: 219 dhe 7: 111. *Dhekhairu'l-'Ukba*, 39.

[175] *Sunenu't-Tirmidhij*, 5: 700/3872. *Fadailu's-Sahabe* i Nisaijut, 68.

[176] *Sunenu't-Tirmidhij*, 5: 701/3874. *El-Mustedrek* i Hakimit, 3: 157 dhe e saktësoi atë. *Usdu'l-Gabe*, 7: 223. *El-Bidaje ue'n-Nihaje*, 7: 254.

[177] *Sunenu't-Tirmidhij*, 5: 698/3868. *El-Mustedrek* i Hakimit, dhe e saktësoi atë.

Ajo i ka thënë Ebu Bekrit dhe Umerit: *"Ju betohem në Allahun! A nuk e keni dëgjuar të Dërguarin e Allahut të thotë: "Kënaqësia e Fatimes është kënaqësi e imja; urrejtja ndaj Fatimes është urrejtje ndaj meje, kështu që, ai që e do Fatimen, bijën time, më ka dashur mua?"* Ata të dy thanë: *"Po…"*[178]

Sikur populli nuk kishte dëgjuar për një gjë të tillë, madje sikur nuk kishin dëgjuar as që Allahu zemërohej kur dikush e zemëronte atë dhe kënaqej kur kënaqej ajo! Allahu i Lartësuar thotë: **"Me të vërtetë, ata të cilët e dëmtojnë Allahun dhe të Dërguarin e Tij janë të mallkuar në këtë botë dhe në tjetrën dhe ka përgatitur për ta një ndëshkim të dhimbshëm."**[179]

Me këtë ndërmorën një rrezik të madh, ndërkohë që Zahraja i dha lamtumirën jetës së kësaj bote, e zemëruar dhe e pakënaqur ndaj tyre.

Dashuria ndaj dy nipave, Hasanit dhe Hysejnit

Hasani dhe Hysejni janë dy nipat e të Dërguarit të Allahut, dy borzilokët, dy zotërinjtë e rinisë prej banorëve të Xhennetit. Janë prej pjestarëve të Mbulesës, të cilëve Allahu ua largoi të gjitha papastërtitë dhe i pastroi ata plotësisht.

Dashuria ndaj tyre është vërtetuar me tekst nga Kur'ani Famëlartë në ajetin e lartpërmendur të dashurisë, në fillim të këtij kapitulli.

---

[178] *El-Imametu ues-Sijaseh* i Ibn Kutejbes, 1: 13-14, Muessesetu'l-Uefa, Bejrut.
[179] Surja "El-Ahzab", ajeti 57.

Këtu po shtojmë një pjesë prej hadithe të sakta të transmetuar në lidhje me dashurinë e të Dërguarit të Allahut për këta të dy, në lidhje me këmbënguljen e sigurtë të tij për dashurinë ndaj tyre dhe ndjekjen e tyre.

Kjo, për arsyen se ata të dy përfaqësojnë linjën e saktë të Mesazhit të Zotit, i cili fton në kapjen pas parimeve thelbësore të Islamit, metodikën e Librit të ndritur dhe Synetin Muhamedij, me thënie e me vepra.

Në vijim po paraqesim disa nga transmetimet që lidhen me dashurinë ndaj Hasanit dhe Hysejnit nga hadithet e sakta dhe lajmet konsekuente (*muteuatire*):

1. I Dërguari i Allahut *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: "*Hasani dhe Hysejni janë dy bijtë e mi. Ai që i do ata, më do mua; ai që më do mua, atë e do Allahu; atë që e do Allahu, e fut në Xhenet. Ai që i urren ata të dy, më urren mua; ai që më urren mua, atë e urren Allahu dhe atë që e urren Allahu, e fut në Zjarr.*"[180]

2. Dhe: "*Këta të dy janë bijtë e mi, Hasani dhe Hysejni. O Allah i Plotpushtetshëm, me të vërtetë, unë i dua këta të dy. O Allah i Plotpushtetshëm, duaji këta të dy dhe duaje atë që i do këta të dy.*"[181]

---

[180] *El-Mustedrek 'ala's-Sahijhejn* i Hakimit, 3: 166, dhe ka thënë: I saktë sipas kushteve të Dy Shejkhëve (Buhariut dhe Muslimit). *Musnedu Ahmed*, 2: 288. *Sunenu't-Tirmidhij*, 5: 656-660. *Kenzu'l-'Ummal*, 13: 105. *Mexhmau'z-Zeuaid*, 9: 179 dhe 181. *Es-Sauaiku'l-Muhrika*, 191-192 pjesa 11. *Dhekhairu'l-'Ukba*, 123.

[181] *Sahijhu'l-Bukharij*, 5: 100-101/235. *Sunenu't-Tirmidhij*, 5: 656, 3769 dhe 3772. *Musnedu Ahmed*, 2: 446 dhe 5: 369. *Musnedu't-Tajalisij*, 10: 332,

3. Në një hadith, Ebu Hurejra ka thënë: "Kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut të thotë për Hasanin dhe Hysejnin: "*Ai që më do mua, atëherë le të dojë këta të dy.*"[182]

4. Dhe: "*Mos u bëni keq këtyre të dyve, pafsha babain tim e nënën time. Ai që më do mua, atëherë le të dojë këta të dy.*"[183]

5. I Dërguari i Allahut *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e përqafoi Hasanin dhe tha: "*O Allah, unë e dua këtë. Duaje Hasanin dhe duaje atë që e do atë.*"[184]

6. "Hysejni është prej meje dhe unë jam prej Hysejnit. E do Allahu atë që do Hysejnin, Hysejni është nip prej nipave."[185]

7. Dhe: "*Hasani dhe Hysejni janë dy borzilokët e mi.*"[186]

8. Ebu Ejjub El-Ensarij ka thënë: "Hyra tek i Dërguari i Allahut dhe Hasani e Hysejni po luanin në prani të tij. Unë i thashë: - O i Dërguari i Allahut, a i do këta të dy?" Më tha:

Daru'l-Ma'rife, Bejrut. *Et-Tarijkhu'l-Kebijr* i Buhariut, 2: 286. *Mexhmau'z-Zeuaid*, 9: 180. *Kenzu'l-'Ummal*, 6: 220. *Usdu'l-Gabe*, 2: 12.

[182] *Musnedu't-Tajalisij*, 10: 327. *Tarijkhu'l-Islam* i Dhehebijut, 5: 100.

[183] *Hiljetu'l-Eulija*, 8: 305. *El-Mu'xhemu'l-Kebijr*, 3: 40/2644. *Dhekhairu'l-'Ukba*, 123. *Kenzu'l-'Ummal*, 13: 107. *El-Xhamiu's-Sagijr*, 2: 328. *El-Isabeh*, 1: 329. *Mexhmau'z-Zeuaid*, 9: 179.

[184] *Sunenu't-Tirmidhij*, 5: 661/3783.

[185] *Et-Tarijkhu-l-Kebijr* i Buhariut, 8: 415/3536. *Sunenu't-Tirmidhij*, 5: 658/3775. *Sunen Ibn Maxheh*, 1: 151/144. Musned Ahmed, 4: 172. *El-Mustedrek* i Hakimit, 3: 177. *Mesabijhu's-Sunneh*, 4: 195/4833. *Usdu'l-Gabe*, 2: 19. *El-Xhamiu's-Sagijr*, 1: 575/3727. *Xhamiu'l-Usul*, 10: 21 e shumë të tjerë.

[186] *Sahijhu'l-Bukharij*, 5: 102/142 dhe 8: 11/23 pjesa e edukatës. *Sunenu't-Tirmijdhij*, 5: 657/3770. *Musned Ahmed*, 2: 85, 93, 114 dhe 153. *Musnedu't-Tajalisij*, 8: 260-261. *Hiljetu'l-Eulija*, 5: 70. *Fet'hu'l-Barij*, 8: 100. *Usdu'l-Gabe*, 2: 20

"Si të mos i dua ata të dy, ndërkohë që ata janë dy borzilokët e mi të kësaj bote, që u marr erë."[187]

Nga ajo që u tha më lart, bëhet e qartë se dashuria për Hasanin dhe Hysejnin është detyrim për çdo mysliman e myslimane, për arsye të thënies së Allahut të Lartësuar: **"Ju e kishit shembullin më të lartë në të Dërguarin e Allahut."**[188] Kjo dashuri është një pjesë e pandashme nga dashuria për Profetin, për prijësin e besimtarëve dhe Zahranë *(paqja qoftë mbi ta!)*, e cila çon në fitimin e kënaqësinë dhe ngritjen në shkallët më të larta.

Është transmetuar nga i Dërguari i Allahut *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* se ai i ka kapur për dore Hasanin dhe Hysejnin dhe ka thënë: *"Ai i cili më do mua, këta të dy, babain e tyre dhe nënën e tyre, do të jetë me mua në gradën time në Ditën e Kijametit."*[189]

Qëllimi i obligueshmërisë së dashurisë për Ehli Bejtin nuk është thjesht vetëm dashuria për ta, por qëllimi është të vepruarit e të gjitha atyre që kanë kryer ata, të udhëzuarit me udhëzimin e tyre, marrja e tyre për kujdestarë dhe shmangia nga armiqtë e tyre.

I Dërguari i Allahut *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: *"Kush gëzohet që të jetojë jetën time e të vdesë vdekjen time, të banojë në Xhenetin 'Adn që e*

---

[187] *Kenzu'l-'Ummal*, 6: 222 dhe 7: 110. *Mexhmau'z-Zeuaid*, 9: 181. *Sunenu't-Tirmidhij*, 5: 657/3770 dhe 3772.
[188] Sure "El-Ahzab", ajeti 21.
[189] *Sunenu't-Tirmidhij*, 5: 641-642/3733. *Musnedu Ahmed*, 1: 77. *Xhamiu'l-Usul*, 9: 157/6706.

ka mbjellë Zoti im, le të marrë për udhëheqës Aliun pas meje. Të dojë atë që e do atë, të ndjekë Ehli Bejtin tim pas meje, sepse ata janë pasardhësit e mi, janë krijuar nga balta ime, trashëguan të kuptuarit dhe diturinë time. Mjerë për ata prej ymetit tim që përgënjeshtrojnë virtytet e tyre, që (duke ndërprerë lidhjen) me ta ndërpresin lidhjen me mua. Mos ua dhëntë Allahu atyre ndërmjetësimin tim!"[190]

[190] *Sherh Ibn Ebi'l-Hadijd*, 9: 170/12. *Hiljetu'l-Eulija*, 1: 86. *Kenzu'l-'Ummal*, 12: 103/24198. *Kifajetu't-Talib*, 214. *Mexhmau'z-Zeuaid*, 9: 108. Biografia e prijësit të besimtarëve nga *Tarijkh Medineti Dimashk*, 2: 95.

KAPITULLI I TRETË

Virtytet e Ehli Bejtit në Kur'an dhe në Synet

Ndjekësi i teksteve islame në Kur'an dhe Synet do të shohë me qartësi se nuk gjen në Kur'anin fisnik e as në Traditën Profetike transmetime aq të shumta, sa janë transmetuar për Ehli Bejtin, si: numërimi i virtyteve të tyre specifike, tipareve dalluese me të cilat u veçuan nga individët e tjerë të shoqërisë, si dhe kufizimi për ta pa të tjerët.

Ajo që s'ka dyshim, është se arritja e kësaj sasie të madhe e transmetimeve për përparësinë e Ehli Bejtit dhe sqarimin e pozitës së tyre, pavarësisht përpjekjeve të fshirjeve, devijimeve e ndryshimeve me të cilat u përballën këto transmetime, tregojnë me qartësi pozicionin e tyre si prijës në udhëheqjen dhe ecurinë e ummetit dhe se ata mbartin aftësi dhe mundësi për këtë udhëheqje.

Kështu, ne gjendemi përpara një sasie të shumtë të teksteve që flasin për cilësitë dhe virtytet specifike të Ehli Bejtit, ku nuk është e mundur vetëm se të paraqesim disa prej tyre, që të jenë tregues të qartë për veçoritë që e karakterizojnë Ehli Bejtin pa të tjerët. Këtë do ta bëjmë përmes dy kërkimeve:

KËRKIMI I PARË

Virtytet e Ehli Bejtit në Kur'anin e shenjtë

Kur'ani i shenjtë na paraqet aspekte të rëndësishme të virtyteve të Ehli Bejtit, të pozitës së tyre të veçantë në jetën shoqërore të ummetit. Gjithashtu, ai vërteton gjendjen e krahasueshme ndërmjet Profetit fisnik dhe Ehli Bejtit të tij të pagabueshëm.

Nga dëshmitë unanime të saj është ajeti i lutjes për mallkim (*ajetu'l-mubaheleh*) dhe ajeti i pastrimit (*ajetu't-tat'hijr*). Kur'ani vërteton dhe përforcon rëndësinë e dashurisë ndaj Ehli Bejtit dhe të pasimit të tyre. Ai e ka bërë detyrë për myslimanët dashurinë ndaj tyre, siç ka ardhur në ajetin e dashurisë (*ajetu'l-meuddeh*).

Ka shumë ajete të zbritura, disa prej të cilave do t'i përmendim në këtë kërkim, në të cilat duken cilësitë dhe virtytet me të cilat Ehli Bejti u specifikuan. Ndër ato ajete janë:

1- Thënia e Allahut të Lartësuar: **"E kush të kundërshton ty në çështjen e tij, Isait, pasi të është bërë e ditur e vërteta, t'i thuaj: 'Ejani, t'i thërrasim bijtë tanë dhe bijtë tuaj, gratë tona dhe gratë tuaja, vetë ne dhe vetë ju, mandej, sinqerisht të lutemi për mallkim dhe mallkimin nga ana e Allahut ta hedhim kundër gënjeshtarëve."**[191]

[191] Surja "Ali Imran", ajeti 61.

{فَمن حَاجَّكَ فِيهِ مِن بَعدِ ما جَاءَكَ مِنَ العِلمِ فَقُلْ تَعَالوا نَدعُ أبناءَنَا وأبناءَكُم ونِساءَنا ونِسَاءَكُم وأنفُسَنَا وأنفُسَكُم ثُم نَبتَهِلْ فَنَجعَلْ لَّعنةَ اللّه عَلى الكَاذِبينَ}

Ky kumt hyjnor erdhi si rezultat i debatit ndërmjet të Dërguarit më fisnik dhe një delegacioni të krishterësh nga Nexhrani, të cilët pretendonin të vërtetën në anën e tyre dhe të fesë së tyre.

I Dërguari i Allahut i ftoi ata në lutje për mallkim (*mubahele*), siç thotë edhe ky ajet i bekuar. Rezultati i saj ishte se ai e hodhi poshtë pretendimin e tyre duke ua mbyllur gojën me argumente dhe duke i mundur me fakte.

Ata zgjodhën nënshtrimin dhe pagimin e *xhizje*s (taksës) në vend që të luteshin për mallkim me të Dërguarin më fisnik dhe Ehli Bejtin e tij, pasi që u bindën për ndëshkimin e dhimbshëm dhe mallkimin e përhershëm.

Historia është më e njohur, sesa të përmenden hollësitë dhe detajet e saj sepse janë librat e historisë, të hadithit, të jetëshkrimit profetik dhe të komentimeve të Kur'anit, ato që kanë marrë përsipër sqarimin e saj në mënyrë të detajuar.

Ajo që është e rëndësishme për ne këtu, është sqarimi i vërtetësisë së këtij ajeti të begatë, me anë të të cilit, i zgjodhi ata Allahu i Lartësuar për këto pozita madhështore, si dhe sqarimin e treguesve të kësaj zgjedhjeje të qëllimshme të Allahut.

Librat e komentimit, të haditheve dhe të jetëshkrimit të Profetit janë në unanimitet se ata të cilët i ka zgjedhur i

Dërguari i Allahut, bazuar tek urdhri i Zotit, si vërtetues për ajetin e ndritur, janë: Aliu, Fatimeja, Hasani dhe Hysejni dhe askush përveç tyre.[192]

Sa'd ibn Ebi Uekasi ka thënë: "Në çastin që zbriti ky ajet: **"Thuaj: Ejani t'i thërrasim bijtë tanë dhe bijtë tuaj…"**, i Dërguari i Allahut ftoi Aliun, Fatimen, Hasanin dhe Hysejnin dhe tha: "*O Allah, këta janë Ehli Bejti im."*[193]

Xhabir ibn Abdullahi ka thënë: **"…vetë ne dhe vetë ju…"**, i Dërguari i Allahut dhe Aliu dhe **"…bijtë tanë…"**, Hasani dhe Hysejni dhe **"…gratë tona…" –** Fatimeja."[194]

Është transmetuar po për këtë kuptim nga Sha'biu[195]. Madje këtë hadith e kanë transmetuar rreth 24 sahabë dhe tabi'inë dhe më shumë se 52 persona prej transmetuesve të hadithit dhe dijetarëve të komentimit të Kur'anit[196]

---

[192] Shih: *Sahijhu Muslim*, 4: 1871. *Sunenu't-Tirmidhij*, 5: 225/2999. *Mesabijhu's-Sunneh*, 4: 183/4795. *El-Kamilu fi't-Tarijkh*, 2: 293. *Esbabu'n-Nuzul* i Uahidijut: 60. *Tefsijru'r-Razij*, 8: 81. *Tefsijru'z-Zemakhsherij*, 1: 368. *Tefsijru'l-Kurtubij*, 4: 104. *Tefsijru'l-Alusij*, 3: 188-189. *Tefsijru'n-Nesefij*, 1: 221. *Fet'hu'l-Kadijr* i Sheukanit, 1: 347. *Me'alimu't-Tenzijl* i Begavijut, 1:480. *Xhamiu'l-Usul*, 9: 470/6479, e shumë të tjerë. [Shih edhe *Ajka e Kuptimeve të Kurani Qerimit* i Hafiz Ibrahim Dalliut, komentimi i ajetit në fjalë, f. 333-334, ribotim i Fondacionit të Kur'anit, Tiranë. Po ashtu, shih edhe *Kur'ani, Përkthim me komentim në gjuhën shqipe* i Sherif Ahmetit, f. 89. (shënim i përkthyesit)].

[193] *Musnedu Ahmed*, 1: 185. *El-Mustedrek 'ala's-Sahijhejn*, 3: 150, dhe ka thënë: Është i saktë sipas Dy Shejkhëve (Buhariut e Muslimit) dhe e saktësoi atë Dhehebiju gjithashtu. *Fet'hu'l-Barij*, 7: 60. *Usdu'l-Gabe*, 4: 10. *El-Istij'ab* i Ibn Abdil-Berrit, 3: 37.

[194] *Ed-Durru'l-Menthur*, 2: 38-39.

[195] *Esbabu'n-Nuzul* i Uahidijut, 59.

[196] Shih: *Teshjijdu'l-Muraxhe'at*, 1: 344-348.

Zemakhsheriu tërheq vëmendjen se shkaku i paraprirjes së bijve dhe grave ndaj vetvetes në ajetin e ndritur është për të tërhequr vëmendjen për pozicionin e tyre të madh dhe pozitën e tyre të afërt, ngaqë ata kanë më përparësi se vetvetja. Nuk ka argument më të fortë për të e fakt më të qartë për vërtetësinë e profetësisë së Profetit sesa zgjedhja e pjestarëve të Mbulesës.[197]
Ndërsa dëshmitë që mbart ky tekst kur'anor janë:

Dëshmia e parë:

Përcaktimi i personaliteteve për *mubahele* (lutje për mallkim) nuk është rast spontan i improvizuar, por është zgjedhje nga Allahu dhe e qëllimshme.

I Dërguari, kur u pyet për këtë zgjedhje, është përgjigjur: "*Sikur ta dinte Allahu se në Tokë ka njerëz më fisnikë se Aliu, Fatimeja, Hasani dhe Hysejni, do të më urdhëronte mua që të bëja lutje për mallkim me ta, por më urdhëroi mua që të lutem për mallkim me këta dhe me këta triumfova mbi të krishterët.*"

Dëshmia e dytë:

Fenomeni i lidhjes së përhershme ndërmjet të Dërguarit dhe Ehli Bejtit të tij nënkupton domethënien e madhe të Mesazhit të Zotit, i cili mbart dëshmi ideologjike, shpirtërore dhe politike të rëndësishme.

[197] *Tefsijru'l-Kesh'shaf*, 1: 369-370.

Çështja nuk është një përkushtim i konceptit fisnor, i cili u rrënjos në trurin e arabëve, por është një përgatitje e qëllimshme nga Allahu për formulimin e ekzistencës së vazhdueshme në lëvizjen e Mesazhit të Zotit.

Dëshmia e tretë:

Nëse përpiqemi të konceptojmë përmbajtjen e fjalëve kur'anore që përmenden në këtë tekst e që është thënia e Tij e Lartësuar **"…vetë ne…"** do të mund të përceptojmë vlerën e këtij teksti në argumente të besueshme për vërtetimin e udhëheqësisë (imamatit).

Ky shprehje kur'anore e konsideron Aliun si një gjendje mishërimi të plotë me personalitetin e të Dërguarit, duke përjashtuar profetësinë, e cila i dhuron të Dërguarit të Allahut një specifikë që s'mund të jetë askush tjetër pjesëmarrës në të, sido e sado që të jetë pozita e tij. Kështu, Aliu, me atë që ka nga besueshmëria e plotë është i merituari i vetëm në përfaqësimin e të Dërguarit në jetën e tij dhe pas vdekjes së tij.[198]

2- Thënia e Allahut të Madhëruar: **"Po Allahu i ruajti ata prej të keqes së asaj dite dhe u dhuroi shkëlqim në fytyra e gëzim të madh. Dhe për shkak se ata duruan, i shpërbleu me Xhenet dhe me petka mëndafshi."[199]**

{ فَوَقَاهُمُ اللَّهُ شَرَّ ذَٰلِكَ الْيَوْمِ وَلَقَّاهُمْ نَضْرَةً وَسُرُورًا } { وَجَزَاهُم بِمَا صَبَرُوا جَنَّةً وَحَرِيرًا}

[198] *Et-Teshejju'* i Abdullah El-Gurejfit, 224.
[199] Surja "El-Insan", ajetet 11-12.

Komentuesit dhe muhadithët kanë rënë dakort se këto ajete kanë zbritur për Ehli Bejtin, veçanërisht në historinë kur Aliu, Fatimeja, Hasani dhe Hysejni, dhanë sadaka për të vobektin, jetimin dhe robin e luftës. Nga thënia kur'anore duket se Allahu i përgëzoi ata me Xhenetin dhe me kënaqësinë.[200]

3- Thënia e Allahut të Madhëruar: **"Është e vërtetë se Allahu dhe melekët e Tij e mëshirojnë me madhërim Profetin. O ju që keni besuar, madhërojeni pra atë - duke rënë salavat – dhe përshëndeteni me selam."[201]**

{إِنَّ اللَّهَ وَمَلائِكَتَهُ يُصَلُّونَ عَلَى النَّبِيِّ يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا صَلُّوا عَلَيْهِ وَسَلِّمُوا تَسْلِيمًا}

Në këtë ajet, Allahu i Lartësuar e ka bërë detyrë të bëjmë salavat mbi Familjen, ashtu siç e ka bërë atë detyrë të bëjmë salavat mbi Profetin. E kjo paraqet gjendjen e lidhjes ndërmjet Profetit dhe Familjes së tij, siç e dëshmuam në Ajetin e Pastrimit dhe atë të Dashurisë.

Në një hadith të saktë, për të cilin kanë rënë dakort, thuhet se i është thënë të Dërguarit të Allahut: *"O i Dërguari i Allahut, përsa i përket selamit mbi ty, atë e dimë, po si është salati mbi ty?"* Profeti tha: *"Thoni: "O Allah! Dërgo salavat mbi Muhamedin dhe familjen e Muhamedit, ashtu siç dërgove salavat*

---

200 Shih: *Tefsijru'r-Razij*, 30: 243. *Ruhu'l-Me'anij*, 29: 157-158. *Tefsijru'l-Kesh'shaf*, 4: 670. *Fet'hu'l-Kadijr* i Sheukanit, 5: 349. *Me'alimu't-Tenzijl* i Bagauijut, 5: 498. *Tefsijru Ebi's-Su'ud*, 9: 73. *Tefsijru'l-Bejdauij*, 2: 525-526. *Tefsijru'n-Nesefij*, 3: 628. *Esbabu'n-Nuzul* i Uahidijut, 251. *Nuru'l-Ebsar*, 102. *Er-Rijadu'n-Nadire*, 2: 227. *Ruhu'l-Bejan* i Ismail Hakkit, 10: 268.

201 Surja "El-Ahzab", ajeti 56.

mbi Ibrahimin dhe familjen e Ibrahimit dhe bekoje Muhamedin dhe familjen e Muhamedit, ashtu siç e bekove Ibrahimin dhe familjen e Ibrahimit! Me të vërtetë, Ti je Falënderues dhe i Lavdishëm."[202]

Shafiiu e përshkruan detyrimin e salavatit mbi Familjen me thënien e tij:

"O Ehli Bejti i të Dërguarit të Allahut, dashuria për ju është detyrim nga Allahu, në Kur'an e zbriti atë Ju mjafton ju çështja madhështore, ku për ju, ai që s'bie salavat, nuk i vlen namazi."[203]

4- Thënia e Allahut të Madhëruar: **"Dhe kapuni për litarin e Allahut të gjithë së bashku."**[204]

{وَاعْتَصِمُواْ بِحَبْلِ اللَّهِ جَمِيعًا وَلاَ تَفَرَّقُواْ...}

Transmetohet nga Imam Rizai *(paqja qoftë mbi të!)*, nga babai i tij, nga baballarët e tij, nga Imam Aliu, i cili ka thënë: I Dërguari i Allahut ka thënë: *"Ai që dëshiron të hipë në anijen e shpëtimit, kërkon të kapet me lidhjen e fortë dhe dëshiron të kapet për litarin e fortë të Allahut, atëherë le të ndjekë Aliun dhe të ndjekë prijësit e udhëzuar prej bijve të tij."*[205]

---

[202] *Sahijhu'l-Bukharij*, 6: 217/291. *Sahijhu Muslim*, 1: 305/405 dhe 406. *Sunenu't-Tirmidhij*, 5: 359/3220. *Sunen Ibn Maxheh*, 1: 293/904. *Musnedu Ahmed*, 5: 353. *Tefsijru'r-Razij*, 25: 227. *El-Mu'xhemu's-Sagijr* i Taberanijut, 1: 180. *El-Mu'xhemu'l-Eusat* i Taberanijut, 3: 88/2389, e shumë të tjerë.
[203] *Es-Saua'iku'l-Muhrika*, 148.
[204] Surja "Ali Imran", ajeti 103.
[205] *Shevahidu't-Tenzijl*, 1: 168/177.

Gjithashtu, është transmetuar nga Imam Xha'fer ibn Muhamed Es-Sadik *(paqja qoftë mbi të!)* për thënien e Tij të Lartësuar: **"Dhe kapuni për litarin e Allahut të gjithë së bashku dhe mos u përçani..."** ka thënë: *"Ne jemi litari i Allahut."*[206]

5- Thënia e Allahut të Madhëruar: **"O ju që besuat! Frikësojuni Allahut dhe jini me të drejtët."**[207]

{يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُواْ اتَّقُواْ اللَّهَ وَكُونُواْ مَعَ الصَّادِقِينَ}

Ka ardhur nga Imam Bakiri *(paqja qoftë mbi të!)* thënia e tij për këtë ajet që ka thënë: *"Me familjen e Muhamedit."*[208]
Është transmetuar nga Abdullah ibn Umeri thënia e tij për ajetin "Frikësojuni Allahut!": "Allahu i urdhëroi të gjithë as'habët (bashkëkohësit) e Muhamedit, ta kenë frikë Allahun, e më pas, u tha atyre: **"...dhe jini me ata të drejtët"**, do të thotë me Muhamedin dhe me Ehli Bejtin e tij."[209]

6- Thënia e Allahut të Madhëruar: **"Ju pyetini, pra dijetarët, nëse ju nuk dini."**[210]

{...فَاسْأَلُواْ أَهْلَ الذِّكْرِ إِن كُنتُمْ لاَ تَعْلَمُونَ} {...فَاسْأَلُواْ أَهْلَ الذِّكْرِ إِن كُنتُمْ لاَ تَعْلَمُونَ}

---

[206] *Khasaisu'l-Uahji'l-Mubijn*, 183, kapitulli 15. *Emali't-Tusij*, 1: 278/51.
[207] Surja "Et-Teube", ajeti 119.
[208] Biografia e imam Aliut nga *Tarijkhu Medijneti Dimashk*, 2: 421/930.
[209] *Menakibu Ali ibn Ebi Talib* i Ibn ShehrAshubit, 3: 111, Daru'l-Edu, Bejrut, botimi 2. Tefsijru'l-Burhan, 2: 865/9.
[210] Surja "En-Nahl", ajeti 43 dhe surja "El-Enbija" ajeti 7.

Imam Bakiri *(paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: "Në momentin që zbriti ky ajet, Imam Aliu *(paqja qoftë mbi të!)* tha: 'Ne jemi *Ehlu'dh-dhikri*, (përmendësit e Allahut)', që përmend Allahu i Lartësuar dhe i Lavdishëm në Librin e Tij."[211]

7- Thënia e Allahut të Madhëruar: **"Ti je vetëm qortues. Çdo popull pati udhëzues."[212]**

{إِنَّما أَنتَ مُنذِرٌ وَلِكُلِّ قَوْمٍ هَادٍ}

Ka ardhur nga Imam Ebi Xha'feri *(paqja qoftë mbi të!)* thënia e tij për ajetin: "I Dërguari i Allahut është qortuesi dhe për çdo periudhë kohe, prej nesh ka një udhëzues që i udhëzon ata (njerëzit) me atë që solli i Dërguari i Allahut, pastaj të udhëzuarit pas tij, Aliu, e më pas të porositurit njëri pas tjetrit."[213]

8- Thënia e Allahut të Madhëruar: **"Dhe nuk e di komentimin e tij, përveç Allahut dhe ata që janë thelluar në dituri..."[214]**

{...وَمَا يَعْلَمُ تَأْوِيلَهُ إِلاَّ اللَّهُ وَالرَّاسِخُونَ فِي الْعِلْمِ...}

Imam Sadiku *(paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: "Ata që janë thelluar në dijeni/dituri janë: prijësi i besimtarëve dhe imamët pas tij."[215]

---

[211] *Tefsijru't-Tabarij*, 14: 108. *Khasaisu'l-Uahji'l-Mubijn*, 229, kapitulli 22
[212] Surja "Er-Ra'd", ajeti 7.
[213] *Usulu'l-Kafij*, 1: 191-192/2, Kreu: Imamët janë të udhëzuarit.
[214] Surja "Ali Imran, ajeti 7.

Aliu në Kur'an

Ajeteve të komentuara për Ehli Bejtin u shtohen shumë ajete të cilat sqarojnë përparësinë, pozitën, tiparet dalluese, moralin e bukur të prijësit të besimtarëve, Imam Aliut *(paqja qoftë mbi të!)*, si dhe domosdoshmërinë e bindjes ndaj tij. Ato janë të shumta dhe prelati i ummetit, Ibn Abbasi, i përshkruan ato me thënien e tij*: "Nuk ka zbritur për njeri në Librin e Allahut të Lartësuar, çfarë ka zbritur për Aliun."*[216]

Gjithashtu ka thënë: "*Në çdo ajet në Librin e Allahut që thotë:* **"O ju, të cilët keni besuar!"**, *Aliu është i pari, prijësi dhe fisniku i tij. Edhe pse i ka qortuar Allahu as'habët (bashkëkohësit) e Muhamedit, Ai nuk e ka përmendur Aliun, veçse për mirë."* Këtë e ka transmetuar Taberanij dhe Ibn Ebi Hatemi nga Ibn Abbasi.[217]

Duke parë ajetet e shumta që kanë zbritur për të, muhadithët dhe komentuesit e shkuar i kanë dhënë rëndësi individualizmit të tematikës për ato që kanë zbritur në Kur'an për Aliun me përshkrime e botime, si p.sh.: Xheludiju, Taberaniju, Ebu Naimi, Muhamed ibn Mu'mini Shiraziju, Hasekaniju, Ebu'l Ferexh El-Isfahaniju, Hibriju, Merzebaniju, Ebu Is'hak Eth-Thekafiju, Ebu Xha'fer El-

---

[215] *Usulu'l-Kafij*, 1: 213/3, Kreu: Imamët janë të thelluarit në dituri.

[216] *Tarijkhu'l-Khulefa* i Sujutijut, 189, Daru't-Te'àun, Mekke Mukerremeh. *Nuru'l-Ebsar*, 90.

[217] *Nuru'l-Ebsar*, 87 dhe 90. *Kifajetu't-Talib*, 139. *Er-Rijadu'n-Nadire*, 2: 274. *Dhekhairu'l-'Ukba*, 389. *Mexhmau'z-Zeuaid*, 1: 317 dhe 9: 112. Biografia e Imam Aliut nga *Tarijkhu Medijneti Dimashk*, 2: 428-430/935-939. *Shevahidu't-Tenzijl*, 1: 48-54/ 67-85. *Menakibu'l-Khavarizmij*, 188.

Kummiju, El-Muxhashiiju, Ebu Abdil'lah El-Khurasaniju e të tjerë.[218]

Siç vijon, po përmendim një përzgjedhje të ajeteve të Kur'anit që kanë zbritur, veçanërisht, në lidhje me udhëheqësinë e prijësit të besimtarëve, Ali ibn Ebi Talibit:

1- Allahu i Madhëruar thotë: **"...Sot përsosa për ju fenë tuaj, plotësova ndaj jush dhuntinë Time dhe zgjodha për ju Islamin si fe..."[219]**

{...الْيَوْمَ أَكْمَلْتُ لَكُمْ دِينَكُمْ وَأَتْمَمْتُ عَلَيْكُمْ نِعْمَتِي وَرَضِيتُ لَكُمُ الإِسْلامَ دِينًا...}

Ky ajet ka zbritur për udhëheqësinë e prijësit të besimtarëve. Transmetimet me zinxhir të saktë, të cilat bëjnë të qartë zbritjen e këtij ajeti të Dërguarit të Allahut pas kthimit nga Haxhi i Lamtumirës dhe gjatë ligjëratës në Gadijrin Khum, mbështesin njëra-tjetrën.

Kjo është vërtetuar nga metoda të shumta të transmetuesve të besueshëm, që kanë transmetuar nga një numër i madh sahabësh (shokësh). Prej tyre: Ali ibn Ebi Talibi, Abdullah ibn Abbasi, Ebu Said El-Khudriju, El-Bera ibn 'Azibi, Zejd ibn Erkami, Selman Farisiju, Ebu Dherr El-Gifarij, Ammar ibn Jasiri, Mikdad ibnu'l-Esuedi dhe Ebu Hurejreja.[220]

---

[218] *Ehlu'l-Bejt fi'l-Mektebeti'l-Arabije* i Abdul Azijz Et-Tabatabaij, 444-445, Muessesetu Ali'l-Bejt li Ihjai't-Turath, Kum botimi 1. *Edh-Dherij'ah ila Tesanijfi'sh-Shi'a* i Aga Buzurg Et-Tahranij, 19: 28-29, Menshurat Ismaijlijan, Kum. *En-Nuru'l-Mushte'al min Kitab Ma Nezele mine'l-Kur'an fi'-Imami Alij* i Ebu Naim El-Asbehanit, 14-19, Ministria e Udhëzimit Islam, Kum, botimi 1.

[219] Surja "El-Maide", ajeti 3.

[220] Shih *Menhexh fi'l-Intimai'l-Medhhebij* i Prof. Saib Abdu'l-Hamijd, 148, Merkezu'l-Gadijr, Kum, botimi 5.

Në atë ligjëratë thuhet se Profeti, ditën që i ftoi njerëzit në Gadijr Khum ka qenë ditë e enjte, më pas i ftoi njerëzit për tek Ali ibn Ebi Talibi.

Ndërkohë, mori dorën e tij dhe ngriti atë deri sa njerëzit panë të bardhën e pëllëmbës dhe tha: *"Për atë që kam qenë udhëheqës i tij edhe Aliu është udhëheqësi i tij. O Allah i Plotpushtetshëm, duaje atë që që e do Aliun dhe bëhu armik i atij që armiqëson Aliun. Përkrahe atë që përkrah Aliun dhe poshtërje atë që e poshtëron Aliun."* Pastaj ata të dy nuk u ndanë derisa zbriti ky ajet: **"Sot përsosa për ju fenë tuaj..."** I Dërguari i Allahut tha: *"Allahu është më i Madhi ndaj përsosjes së fesë, plotësimit të begative dhe kënaqësisë së Tij me mesazhin tim dhe udhëheqjen e Aliut."*[221]

Poeti i të Dërguarit të Allahut, Hasan ibn Thabit El-Ensarij e ka regjistruar këtë ngjarje historike me fjalë të ndritura. Pasi i mori leje të Dërguarit të Allahut e ky i fundit i dha leje atij, Hasani tha:

"Profeti i tyre i thërret ata në Khum atë Ditë Gadijri,
dhe sa duhej dëgjuar i Dërguari kur thirri!
Tha: 'Cili është i pari juaj dhe i juaj kujdestar?'
Ata u përgjigjën – pa pipëtirë ndonjë kundërshtar - :
Ti je udhëheqësi ynë dhe i yni kujdestar
dhe nuk do të gjesh ti sot tek ne asnjë kundërshtar.'

[221] Shih *Menakibu'l-Khavarizmij*, 80. *Maktelu'l-Imami'l-Hysejn* po i tiji, 47. *Terxhemetu'l-Imami Alij* i Ibn Asakirit, 2: 75/577-580. *Tarijkhu Bagdad*, 8: 290. *Tarijkhu'l-Ja'kubij*, 2: 43. *Shevahidu't-Tenzijl*, 157/210-215. *El-Menakib* i Ibnu'l-Megazilit, 19. *Tedhkiretu'l-Khauass* i Ibnu'l-Xheuzijit, 29. *Feraidu's-Simtejn*, 1: 315. *Ed-Durru'l-Menthur* i Sujutijut, 2: 259. *El-Itkan* po i Sujutijut, 1: 75.

I tha atij: 'Çohu, o Ali, sepse unë
të kam pëlqyer ty pas meje udhëzues e prijëtar.
Për atë që kam qenë udhëheqës, ky është i tiji udhëheqës
Jini për të përkrahës besnikë dhe ndjekës.'
E atëherë, u lut: 'O Allahu im, duaje të tijin ashik
dhe bëhu armik i atij që i bëhet Aliut armik."[222]

Në fillim të një kasideje të prijësit të besimtarëve *(paqja qoftë mbi të!)* shkruhet:

"Muhamedi, Profeti, vëllai dhe binjaku im
e Hamzai, zotëria i dëshmorëve, xhaxhai im…"

e deri te thënia e tij *(paqja qoftë mbi të!)*:

"E obligoi udhëheqësinë time për ju
i Dërguari i Allahut Ditën e Gadijrit Khum
Mjerë për atë, pastaj mjerë për atë, pastaj mjerë për atë
që e takon Zotin nesër me padrejtësi ndaj meje!"[223]

---

[222] *El-Irshad* i Shejh Mufidit, 177, Muessesetu Ali'l-Bejt, Kum botimi 1. *El-Fusulu'l-Mukhtare* i Shejkh Mufijdit, 209 dhe 235, Mektebetu'd-Dauerij, Kum, botimi 4. *El-Emalij* i Sadukut, 460/3. Mexhlisi 84. *El-Menakib* i El-Khavarizmijut, 80. *Maktelu'l-Imami'l-Hysejn* gjithashtu i Khavarizmijut, 2: 47. *Tedhkiretu'l-Khauass* i Ibnu'l-Xheuzijut, 33. *El-Menakib* i Ibn Shehr Ashubit, 3: 27. *Kenzu'l-Feuaid* i El-Keraxhikijut, 1: 268, Daru'l-Edua, Bejrut. *Keshfu'l-Gummeh* i El-Irbilijut, 1: 319. *A'lamu'l-Uera* i Tabrasij, 1: 262. *Et-Taraif* i Ibn Tausit, 146. *Kifajetu't-Talib*, 64. *Feraidu's-Simtejn*, 1: 73-74. Dhe e ka transmetuar Al'lame Eminij në *El-Gadijr*, 2: 34 në 38 rrugë.

[223] *Kenzu'l-Feuaid* i El-Keraxhikij, 1: 266. *Tedhkiretu'l-Khauass* i Ibnu'l-Xhevzijit, 102. *El-Ihtixhaxh* i Tabrasijit, 180. *El-Fusulu'l-Muhimmeh* i Ibn Sabbagut, 32. *Raudatu'l-Ua'idhijn*, 87. *Kenzu'l-'Ummal*, 13: 112. *Mukhtesaru Tarijkhi Dimashk* i Ibn Mendhurit, 18: 77. Dhe e ka transmetuar Al'lame Emijnij në *El-Gadijr*, 2: 25 në 37 rrugë.

2- Allahu i Madhëruar thotë: **"O ti, i Dërguar! Komunikoje atë që t'u zbrit prej Zotit tënd, e nëse nuk e bën, atëherë nuk e kryer misionin e Tij. Allahu të garanton mbrojtjen prej njerëzve..."**[224]

{يَا أَيُّهَا الرَّسُولُ بَلِّغْ مَا أُنزِلَ إِلَيْكَ مِن رَّبِّكَ وَإِن لَّمْ تَفْعَلْ فَمَا بَلَّغْتَ رِسَالَتَهُ وَاللَّهُ يَعْصِمُكَ مِنَ النَّاسِ...}

Ky ajet ka zbritur për udhëheqësinë e Prijësit të besimtarëve dhe me të njëjtin rast që zbriti edhe ajeti i parë. Ka transmetuar El-Uahidiju me zinxhir nga Ebi Sa'id El-Khudrij, i cili ka thënë: *"Ky ajet ka zbritur në ditën e Gadijr Khumit (fill pas Haxhit të Lamtumirës) për Ali ibn Ebi Talibin."*[225]

Transmeton Sujutiju dhe Sheukaniju nga Ibn Mes'udi, i cili ka thënë: *"Lexonim në kohën e të Dërguarit të Allahut:* **"O ti, i Dërguar! Komunikoje atë që t'u zbrit prej Zotit tënd"** që Aliu është udhëheqësi i besimtarëve: **"E nëse nuk e bën, atëherë nuk e kryer misionin e Tij."**[226]

3- Allahu i Madhëruar thotë**: "Udhëheqësi (**kujdestari**) juaj është Allahu, i Dërguari i Tij dhe besimtarët që falin namazin dhe japin zeqatin, duke qenë të përulur (**në adhurim - ruku'**)."**[227]

{إِنَّمَا وَلِيُّكُمُ اللَّهُ وَرَسُولُهُ وَالَّذِينَ آمَنُواْ الَّذِينَ يُقِيمُونَ الصَّلاَةَ وَيُؤْتُونَ الزَّكَاةَ وَهُمْ رَاكِعُونَ}

Ky ajet, gjithashtu, ka zbritur për udhëheqjen e prijësit të besimtarëve.

---

[224] Surja "El-Maide", ajeti 67.
[225] *Esbabu'n-Nuzul*, 115.
[226] *Ed-Durru'l-Menthur*, 2: 298. *Fet'hu'l-Kadijr* i Sheukanijit, 2: 60.
[227] Surja "El-Maide", ajeti 55.

Shumica e librave të komentimit (*tefsijr*) të Kur'anit vërtetojnë zbritjen e këtij ajeti për Ali ibn Ebi Talibin *(paqja qoftë mbi të!)* në momentin që dha unazën e tij për sadaka duke qenë në ruku' të namazit.[228]

Kuptimi i udhëheqësit në këtë ajet nuk del nga kuptimi që të shkon në mendje, që është posedues i urdhrit, i çështjes dhe më parësor në udhëheqje. Pra, kuptimi është për atë që ka kompetencën e udhëheqjes për çështjet e njerëzve dhe që ka më shumë përparësi mbi to, është imami, prijësi; është një tekst deklarativ e i qartë për prijësinë e prijësit të besimtarëve, pas të Dërguarit të Allahut *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Hasan ibn Thabiti, në lidhje me këtë kuptim, kompozoi:

"O Ebu'l-Hasan flijoj për ty veten dhe jetën time
e çdo i ngadaltë në udhëzim e i shpejtë
A mund të shkojë dëm lavdërimi im dhe i të dashuruarve
Lavdërimi në krahët e Zotit nuk humbet
Ti je ai që dhe duke qenë në ruku (i përulur në namaz)
U flijofshin për ty shpirtrat e popullit, o i përuluri më i mirë
Për ty Allahu zbriti prijësinë më të mirë
dhe e sqaroi atë në ligjet e patundshme."[229]

---

[228] *Esbabu'n-Nuzul* i El-Uahidijit, 3: 114. *Lubabu'n-Nukul fi Esbabi'n-Nuzul* i Sujutiut, 81. *Tefsijru Ebi's-Su'ud*, 3:52. *Tefsijru'l-Kesh'shaf* i Zemakhsherijut, 1: 649. *Me'alimu't-Tenzijl* i Begavijut, 2: 272. *Xhamiu'l-Usul* i Xhezerijut, 8: 664/6515 dhe botime të tjera rreth virtyteve e komentimeve.

[229] *El-Gadijr* i 'Al'lame Eminit, 2:52 siç është përmendur tek vargjet e *Feraidu's-Simtejn*, 1: 189-190. *El-Menakib* i Khauarizmiut, 186. *Tedhkiretu'l-Khauass* i Ibn Xheuziut, 15. *Kifajetu't-Talib*, 228 me shprehje të tjera.

4- Allahu i Madhëruar thotë: **"Dhe tërhiqju vërejtjen farefisit tënd më të afërt."**[230]

{وَأَنذِرْ عَشِيرَتَكَ الأَقْرَبِينَ}

Në librat e komentimit të Kur'anit dhe historisë së Profetit, në lidhje me shkakun e zbritjes së këtij ajeti, thuhet se i Dërguari i Allahut *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* thërriti fisin Abdu'l-Muttalib, u dha për të ngrënë e më pas iu drejtua duke u thënë: *"O bijtë e Abdu'l-Muttalibit! Betohem në Allahun se nuk njoh ndonjë të ri mes arabëve që i ka sjellë popullit të tij diçka më të mirë se ç'ju kam sjellë unë juve. Unë ju kam sjellë më të mirën e kësaj bote dhe botës tjetër. Më urdhëroi Allahu i Lartësuar që t'ju ftoj juve për tek Ai. Cili nga ju më përkrah mua në këtë çështje që të jetë vëllai im, këshilltari im dhe zëvendësi im tek ju?"* Të gjithë të pranishmit heshtën dhe nuk thanë asgjë. Aliu *(paqja qoftë mbi të!)* tha: *"Unë, o i Dërguari i Allahut, do të jem përkrahësi yt për të."* Pastaj Profeti e kapi për qafe e tha: *"Me të vërtetë, ky është vëllai im, këshilltari im dhe zëvendësi im tek ju, kështu që dëgjojeni atë dhe bindjuni atij."*[231]

Ajetet që kanë zbritur për prijësin e besimtarëve, Aliun, janë të shumta e që nuk mund t'i përmendim të gjitha në këtë kërkim të shkurtër. Ai që dëshiron më shumë, le të kthehet tek librat e botuar për këtë temë.[232]

---

[230] Surja "Esh-Shu'ara", ajeti 214.

[231] *Tarijkhu't-Tabarij*, 2: 217. *Es-Sijretu'l-Halebije* i Ali ibn Ibrahim El-Halebiji'sh-Shafi'ij, 1: 286, Daru Ihjai't-Turathi'l-Arabij, El-Mektebetul Islamije, Bejrut. *Me'alimu't-Tenzijl* i Bagavijut, 4: 278. *Sherh Ibn Ebi'l-Hadijd*, 13: 210. *Kenzu'l-'Ummal*, 13: 131/36496.

[232] Shih: *Shevahidu't-Tenzijl* i Hakim El-Hasekanit, *Tefsijru'l-Hibrij* dhe *Khasaisu'l-Uahji'l-Mubijn* i Ibn Batrijkut.

KËRKIMI I DYTË

Virtytet (përparësitë) e Ehli Bejtit në Synetin e pastër

Nuk është transmetuar në Sunnetin e begatë për përparësinë dhe vitytet e dikujt, ashtu siç është transmetuar për Ehli Bejtin. Të shumta janë hadithet e sakta (*sahijha*) e konsekuente (*muteuatire*), të cilat deklarojnë hapur virtytet e veçanta dhe përparësitë e Ehli Bejtit në të cilat nuk u afrohet askush.

Ata janë anija e shpëtimit, frerët e së drejtës, gjuhët e së vërtetës, siguria e ummetit, lidhja më e fortë, shtyllat e fesë dhe portat e diturisë… e të tjera cilësi të deklaruara në hadithet profetike.

Përforcimi i këtyre veçorive e cilësive nga i Dërguari më fisnik *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nuk bazohet në motive e faktorë vetjakë dhe emocionalë.

Përkundrazi, ai perifrazon esencialitetin e parimit të udhëheqësisë në ummet pas tij.

Kjo bëhet e qartë nga shumësia e dukurive të nxjerra nga tekstet e haditheve, siç është përforcimi dhe vërtetimi i gjendjes së lidhjes mes të Dërguarit më madhështor dhe Ehli Bejtit; mes Librit të ndritur (Kur'anit) dhe Ehli Bejtit; domosdoshmëria e kapjes pas tyre dhe e ndjekjes së rrugës së tyre; përforcimi i dashurisë për ta; sqarimi i pozitës së veçantë për ta, pa të tjerët, ashtu siç bëhet e qartë në

Hadithin Thekalejn, hadith me peshë të madhe për nga rëndësia, Hadithin e Anijes, Hadithin e Mbulesës, Hadithin e Pozitës e të tjerë…

Në vijim, po ju përmendim një grup hadithesh, për të cilat, janë në të njëjtin mendim të dy grupet (Sunni - Shi'a):

1- Profeti Muhamed *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: *"Unë po ju lë juve dy gjëra me peshë të madhe për nga rëndësia. Nëse ju do të kapeni për këto të dyja, nuk do të humbisni kurrën e kurrës, pas meje. Njëra prej tyre është më madhështore se tjetra: Libri i Allahut, një litar që zgjatet nga qielli në Tokë dhe pasardhësit e mi, Ehli Bejti im. Ata nuk ndahen deri sa të ktheheni te Hauzi (burimi Keuther). Prandaj, hapini sytë se si do të më kundërshtoni mua me këto të dyja."*[233]

2- Dhe: *"Shembulli i Ehli Bejtit tim tek ju është si shembulli i anijes së Nuhut: ai që hipën në të shpëton dhe ai që zmbrapset prej saj mbytet."*[234]

---

[233] Ky hadith është transmetuar me këtë term dhe me terma të tjerë në mënyrë konsekuente (*muteuatir*) sipas kuptimit në: *Sahijhu Muslim*, 4: 1873/2408 dhe 5: 663/3786 dhe 3788. *El-Mustedrek* i Hakimit, 3: 148. *Musnedu Ahmed*, 3: 14, 17, 26, 59 dhe 4: 371, 5: 182 dhe 189. *Fadailu's-Sahabe* i Ahmed ibn Hanbelit, 2: 603/ 1035. *El-Khasais* i Nisaijut, 21. *Mesabijhu's-Sunneh*, 4: 185/4800 dhe 190/4816. *Mexhmau'z-Zeuaid*, 9: 163-164. *El-Xhamiu's-Sagijr* i Sujutijut, 1: 244/1608. *Es-Sauaiku'l-Muhrika* i Ibn Haxherit, 75 dhe 89. *El-Khasaisu'l-Kubra* i Sujutijut, 2: 266. Tefsiri *Ed-Durru'l-Menthur* i Sujutijut, 2: 60. *Tefsijru'r-Razij*, 8: 163. *Hiljetu'l-Eulija*, 1: 355. *Sunenu'l-Bejhakij*, 2: 148 dhe 7: 30. *Usdu'l-Gabeh*, 2: 13. *Tarijkhu Bagdad*, 8: 442. *El-Mu'xhemu'l-Kebijr* i Taberanijut, 3: 201/3052 e shumë të tjerë.

[234] *El-Mustedrek* i Hakimit, 2: 343 dhe e cilësoi atë të saktë sipas kushtit të Muslimit dhe 3: 151. *El-Khasaisu'l-Kubra* i Sujutijut, 2: 266. *El-Xhamiu's-Sagijr* i Sujutijut, 2: 533/8162. *Ruhu'l-Me'anij* i Alusijut, 25: 32. *Tefsijr Ibn Kethijr*, 4: 123. *Tarijkhu Bagdad*, 12: 19. *Hiljetu'l-Eulija*, 4: 306. *Es-Sauaiku'l-*

3- Dhe: *"Yjet janë siguri për banorët e Tokës nga mbytja dhe Ehli Bejti im është siguri për ummetin tim nga mosmarrëveshja. Nëse e kundërshton atë një prej fiseve arabe, do të përçahen dhe do bëhen parti e Iblisit."*[235]

4- Ai *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i ka thënë Aliut, Fatimes, Hasanit dhe Hysejnit: *"Unë jam luftues i atij që ju lufton juve, dhe paqësor me atë që bën paqe me ju."*[236]

Në një thënie tjetër ka thënë: *"Unë jam luftë për atë që ju lufton ju dhe paqe për atë që bën paqe me ju."*[237]

5- Profeti *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u ul me Aliun, Fatimen, Hasanin dhe Hysejnin: *"O Allah i Plotpushtetshëm! Këta janë Ehli Bejti im. Bëhu armik i atij që i armiqëson ata dhe dauje atë që i do ata."*[238]

Muhrika, 184 dhe 234. *Mexhmau'z-Zeuaid*, 9: 168. *Dhekhairu'l-'Ukba*, 120. *Kifajetu't-Talib*, 378. *Nuru'l-Ebsar*, 104 e të tjerë

[235] *El-Mustedrek* i Hakimit, 3: 149 dhe e cilësoi atë të saktë. *El-Khasaisu'l-Kubra* i Sujutijut, 2: 266. *Fadailu's-Sahabe* i Ahmed ibn Hanbelit, 3: 671/1145. *Es-Sauaiku'l-Muhrika*, 111 dhe 140. *Dhekhairu'l-'Ukba*, 17. *Kenzu'l-'Ummal*, 12: 96/34155 dhe 101/34188 dhe 102/34189. *El-Xhamiu's-Sagijr* i Sujutijut, 2: 680/9313. *Mexhmau'z-Zeuaid*, 9: 174. *Fajdu'l-Kadijr*, 6: 297 e të tjerë.

[236] *Sunenu't-Tirmidhij*, 5: 699/3870. *El-Mustedrek* i Hakimit, 3: 149. *Sunen Ibn Maxheh*, 1: 52/145. *Musnedu Ahmed*, 2: 442. *Usdu'l-Gabeh*, 7: 225. *Mexhmau'z-Zevaid*, 9: 169. *Mesabijhu's-Sunneh*, 4: 190. *Es-Sauaiku'l-Muhrika*, 137. *Er-Rijadu'n-Nadirah*, 3: 154. *Shevahidu't-Tenzijl*, 2: 27. *Menakibu'l-Khauarizmij*, 91. *El-Mu'xhemu'l-Kebijr* i Taberanijut, 3: 30/619. *Kenzu'l-'Ummal*, 6: 216. *Sahijh Ibn Hibban*, 7: 102, etj.

[237] *Musnedu Ahmed*, 2: 442. *El-Mustedrek* i Hakimit, 3: 161. *Tarijkh Bagdad*, 7: 137. *El-Mu'xhemu'l-Kebijr* i Taberanijut, 3: 31/2621. *El-Bidaje ue'n-Nihaje*, 8: 36. *Sijer A'lamu'n-Nubela*, 2: 122 dhe 125. *Tarijkhu'l-Islam*, 3: 45, etj.

[238] *Et-Tarijkhu'l-Kebijr* i Buhariut, 2: 69-70. *Musned Ebi Ja'la*, 12: 383/6951. *Mexhmau'z-Zeuaid*, 9: 166-167 dhe ka thënë: Zinxhiri i transmetimit të tij është i mirë.

6- Dhe: *"Me të vërtetë, shembulli i Ehli Bejtit tim për ju është si shembulli i portës Hittah tek Beni Israilët. Ai që hyn në të, i falen gjynahet."*[239]

7- Dhe: *"Ne jemi Ehli Bejti dhe nuk matet askush me ne."*[240]

8- Dhe: *"Ju kujtoj Allahun për Ehli Bejtin tim."*[241]

9- Dhe: *"Ai që më mbron mua në Ehli Bejtin tim, ka marrë tek Allahu besëlidhjen."*[242]

10- Dhe: *"Ai që dëshiron të begatohet në jetën e tij dhe ta kënaqë Allahu me atë që ka, atëherë le të më pasojë mua në Ehlin tim me një ndjekje shembullore."*[243]

11- Dhe: *"Më ndiqni mua përmes Ehli Bejtit tim."*[244]

12- Dhe: *"Ju këshilloj për Ehli Bejtin tim me më të mirën, se përndryshe unë do t'ju luftoj juve për ta nesër. Për atë që jam kundërshtar do ta kundërshtoj nesër dhe atë që e kundërshtoj unë hyn në Zjarr."*[245]

---

239 *El-Mu'xhemu'l-Eusat* i Taberanijut, 6: 147/5870. Gjithashtu, *El-Mu'xhemu's-Sagijr*, 2: 22. *Es-Saua'iku'l-Muhrika* i Ibn Haxherit, 152. *Kifajetu't-Talib*, 378. *Mexhmau'z-Zeuaid*, 9: 168, etj.

240 *El-Firdeus* i Dejlemijut, 4: 283/6838. *Dhekhairu'l-'Ukba*, 17. *Kenzu'l-'Ummal*, 6: 218. *Kunuzu'l-Hakaik* i Abdu'r-Rauf El-Munauij, 153, Daru'l-Kutubi'l-Ilmijje, Bejrut. *Feraidu's-Simtejn*, 1: 45.

241 *El-Mu'xhemu'l-Kebijr*, 5: 183/5027. *Kenzu'l-'Ummal*, 13: 640/37619. *Ihkaku'l-Hakk* i Nurullah El-Husejnij Et-Tusturij, 9: 434.

242 *Dhekhairu'l-'Ukba*, 18. *Jenabij'u'l-Meuedde*, 2: 114/323. *Ihkaku'l-Hakk*, 9: 418.

243 *Kenzu'l-'Ummal*, 12: 99/34171.

244 *Es-Sauaiku'l-Muhrika*, 150. *El-Xhamiu's-Sagijr*, 1: 50/302. *Mexhmau'z-Zevaid*, 9: 163. *Jenabij'u'l-Meuedde*, 1: 126 62.

245 *Es-Sauaiku'l-Muhrika*, 150. *Dhekhairu'l-'Ukba*, 180.

Virtytet e prijësit të besimtarëve *(paqja qoftë mbi të!)*

Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu, specifikohet me virtyte që nuk përafrohen e me pozita që nuk krahasohen. Ai është vëllai i të Dërguarit të Allahut, i pari që besoi në të dhe i besoi atij, njeriu më i dashur tek Allahu dhe i Dërguari i Tij, mbrojtësi i të Dërguarit të Allahut, trashëgimtari i tij, i përzgjedhuri i tij, ministri i tij, porta e qytetit të dijes dhe prijësi i çdo besimtari pas tij.

Virtytet e tij të qarta për pozitën e tij të lartë tek Allahu i Lartësuar janë të shumta dhe i kalojnë limitet e statistikave që i kanë veçuar shumë dijetarë e muhadithë në përshkrime e libra.[246]

Transmeton Hakimi me zinxhirin e tij nga Ahmed ibn Hanbeli ku ka thënë: "*Nuk kanë ardhur për ndonjërin prej bashkëkohësve të të Dërguarit të Allahut më shumë virtyte e cilësi, sesa për Ali ibn Ebi Talibin.*"[247] E transmeton atë Ibn Asakiri[248] dhe Ibn Haxheri dhe ky i fundit ka thënë: "Po kështu ka thënë edhe Nisaiju e shumë të tjerë.[249]

Ibn Ebi Hadidi ka thënë: "*Dije se Prijësi i Besimtarëve* (paqja qoftë mbi të!), *sikur të mburrej me veten e tij, të arrinte të numëronte cilësitë e virtytet e tij me elokuencën që ia ka dhuruar Allahu i Lartësuar vetëm atij, duke e veçuar me të, edhe nëse do ta*

[246] Si për shembull Es-Sejjidu'r-Radijj në *El-Khasais*, Ibnu'l-Megazilij në *El-Menakib* dhe El-Khauarizmij në *El-Menakib*, etj.
[247] *El-Mustedrek 'ala's-Sahijhejn*, 3: 107.
[248] Biografia e Imam Aliut nga *Tarijkhu Medineti Dimashk*, 3: 83/117. *Tabakatu'l-Hanabile* i Ebu Ja'las, 1: 319, Daru'l-Me'arife, Bejrut. *El-Istij'ab*, 3: 51.
[249] *Tehdhijbu't-Tehdhijb*, 7: 339.

ndihmonin atë të gjithë oratorët elokuentë arabë, nuk do të arrinin as një të dhjetën e atyre që ka shqiptuar mbi çështjen e tij i Dërguari i vërtetë (bekimet e Allahut qofshin mbi të!)"[250]

Në vijim po paraqesim disa prej virtyteve, me të cilat u specifikua prijësi i besimtarëve *(paqja qoftë mbi të!)* nga individët e ummetit:

1- Vërtet, ai është krijesa më e dashur tek Allahu i Lartësuar. Kjo është në hadithin e njohur dhe konsekuent (*muteuatir*) të shpendit (zogut), të cilin e kemi transmetuar në kërkimin e dytë të kapitullit të dytë, faqe 76, me konkluzionet e tij. (Kthehu tek ajo faqe.)

2- Profeti *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë duke iu drejtuar prijësit të besimtarëve, Aliut: *"Ti për mua je në pozitën e Harunit tek Musai, veçse nuk ka profet pas meje."*[251]

Është e dukshme në Kur'an se Haruni ka qenë ministër i Musait dhe zëvendësi i tij tek kombi i tij[252], gjithashtu, edhe prijësi i besimtarëve. Ky është tekst i hapur deklarativ dhe i qartë për udhëheqësinë e tij.

3- Ndoshta Hadithi i Flamurit, Ditën e Khajberit dhe kthimi i tij me çlirim e fitore është ndër virtytet më të larta

---

[250] *Sherh Ibn Ebi'l-Hadijd*, 9: 166.

[251] *Sahijhu'l-Bukharij*, 5: 89/202. *Sahijhu Muslim*, 4: 1870/2404. *Sunenu't-Tirmidhij*, 5: 640/3730. *El-Mustedrek* i Hakimit, 2: 337. *Musnedu Ahmed*, 1: 173, 175, 182 dhe 184. *Mesabijhu's-Sunneh*, 4: 170/4762. *Xhamiu'l-Usul*, 8: 649/6489, 6490 dhe 6491 dhe nuk ka burim nga burimet e haditheve që të mos jetë.

[252] Shih: Suren "TaHa", ajetet 29-32. Suren "El-Furkan", ajeti 35. Suren "El-A'raf", ajeti 142.

të tij. Tekstin e këtij hadithi e përmendëm në kërkimin e dytë të kapitullit të dytë, faqe 77, me konkluzionet e tij. (Kthehu tek ajo faqe.)

4- Në përçimin e sures "El-Berae" (Et-Teube), i Dërguari i Allahut dërgoi Ebu Bekrin tek banorët e Mekës, kështu që shkoi tek ata tri herë. Më pas, i tha Aliut: "Ndiqe atë dhe përçoje ti." Kështu që veproi siç i tha ai, e mori atë prej tij dhe shkoi drejt Mekës. Ebu Bekri u kthye tek Profeti duke i thënë: "O i Dërguari i Allahut, a ka ndodhur gjë me mua?" Ai tha: "*Jo, por jam urdhëruar që të mos e përçojë atë, veçse unë ose një burrë prej meje.*"[253]

5- I Dërguari i Allahut e thirri Aliun Ditën e Taifit dhe bisedoi vetëm me të. Ndërkohë njerëzit thanë: "Si shumë zgjati biseda e tij me djalin e xhaxhait të vet…" I Dërguari i Allahut tha: "*Nuk e zgjata unë bisedën me të, por Allahu.*"[254]

6- Dhe në hadithin e mbylljes së portave të kalimit tek Xhamia e Profetit, tha: "*Mbyllini portat, përveç portës së Aliut!*" Ndërkohë, njerëzit folën për këtë, kështu që Profeti tha: "*Për të vazhduar më tej, unë jam urdhëruar me mbylljen e këtyre portave, me përjashtim të portës së Aliut. Dikush nga ju ka*

---

[253] *Musnedu Ahmed*, 1: 3 dhe 331, 3: 212 dhe 283, 4: 164 dhe 165. *Sunenu't-Tirmidhij*, 5: 636/3719. *Xhamiu'l-Usul*, 8: 660/6508. *Mexhmau'z-Zeuaid*, 9: 119. *Es-Sauaiku'l-Muhrika*, 122. *El-Xhamiu's-Sagijr*, 2: 177/5595. *El-Bidaje ue'n-Nihaje*, 7: 370. *Tefsijru't-Tabarij*, 10: 64, etj.

[254] *Sunenu't-Tirmidhij*, 5: 639/3726. *Mesabijhu's-Sunneh*, 4: 175/4773. *Xhamiu'l-Usul*, 9: 6493. *Er-Rijadu Nadirah*, 3: 170. *El-Bidaje ue'n-Nihaje*, 7: 369, etj.

folur diçka. Pafsha Allahun, as nuk e kam mbyllur dhe as nuk e kam hapur, por u urdhërova dhe e zbatova."[255]

7- "*Unë jam qyteti i diturisë, Aliu është porta e tij, kështu që ai, i cili dëshiron qytetin, le të vijë tek porta."*[256] Në një thënie tjetër ka thënë: "*Unë jam shtëpia e mençurisë dhe Aliu është porta e saj."*[257]

8- "*Me të vërtetë, Aliu është prej meje dhe unë jam prej tij dhe ai është udhëheqësi i çdo besimtari pas meje."*[258]

9. "*Për çdo profet ka një zëvendës dhe trashëgimtar dhe Aliu është zëvedësi im dhe trashëgimtari im."*[259]

10- "*Kush lëndon Aliun, më ka lënduar mua."*[260]

---

[255] *Sunenu't-Tirmidhij*, 5: 636/2732. *Musnedu Ahmed*, 1: 331. *Fet'hu'l-Barij*, 7: 13. *El-Mustedrek*, 3: 125. *Mexhmau'z-Zeuaid*, 9: 114. *Er-Rijadu'n-Nadirah*, 3: 158. *Xhamiu'l-Usul*, 8: 659/6506. *El-Bidaje ue'n-Nihaje*, 7: 355. Dhe të gjithë librat e biografive (*El-Menakib*).

[256] *El-Mustedrek* i Hakimit, 3: 126 dhe 127 dhe e cilësoi të saktë atë. *Xhamiu'l-Usul*, 8: 657/6501. *El-Bidaje ue'n-Nihaje*, 7: 372. *Tarijkh Bagdad*, 11: 49-50 dhe është vërtetuar saktësia e tij. *Es-Sauaiku'l-Muhrika*, 122, etj.

[257] *Sunenu't-Tirmidhij*, 5: 637/3723. *Mesabijhu's-Sunneh*, 4: 174/4772. *El-Xhamiu's-Sagijr*, 1: 415/2704. *El-Bidaje ue'n-Nihaje*, 7: 372. *Hiljetu'l-Eulija*, 1: 64, etj.

[258] *Musned Ahmed*, 4: 439. *Sunenu't-Tirmidhij*, 5: 632/3712. *Khasaisu'n-Nisaij*, 63: dhe 75. *El-Musennef* i Ibn Ebi Shejbes, 7: 504/58, Daru'l-Fikr, Bejrut, botimi 1. *El-Mu'xhemu'l-Kebijr* i Taberanijut, 18: 128/265. Xhamiu'l-Usul, 8: 652/6493.

[259] Biografia e Imam Aliut nga *Tarijkh Ibn Asakir*, 3: 5/1030 dhe 1031. *Er-Rijadu'n-Nadireh*, 3: 138. *Dhekhairu'l-'Ukba*, 71. *Menakibu'l-Khauarizmij*, 42. *El-Firdeus* i Dejlemijut, 3: 336/5009. *El-Menakib* i Ibn Megazilit, 201/238. *Kifajetu't-Talib*, 260.

[260] *Musned Ahmed*, 3: 483. *El-Mustedrek* i Hakimit, 3: 122 dhe e cilësoi të saktë atë. *Delailu'n-Nubuve* i Bejhakijut, 5: 395. *El-Xhamiu's-Sagijr*, 2: 547 8266. *Mexhmau'z-Zeuaid*, 9: 129. *El-Bidaje ue'n-Nihaje*, 7: 359. *Er-Rijadu'n-Nadireh*, 3: 121. *Es-Saua'iku'l-Muhrika*, 123, etj.

Këto tekste profetike e shumë të tjera, janë argumente të qarta që flasin për dallimin e prijësit të besimtarëve, Ali ibn Ebi Talibit *(paqja qoftë mbi të!)*, mbi të gjithë individët e ummetit dhe qenia e tij i merituesshëm për të marrë rolin e udhëheqësit të ummetit dhe bartjen e përgjegjësive të Mesazhit të Zotit pas të Dërguarit të Allahut *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

KAPITULLI I KATËRT

Dobitë nga dashuria për Ehli Bejtin

Dashuria ndaj Ehli Bejtit është një parim i Mesazhit të Zotit që përmban dimensione të rëndësishme. Ajo ndikon në jetën e individit mysliman dhe në jetën e shoqërisë islame.

Dashuria ndaj tyre nuk është thjesht një lidhje me zemër apo lidhje emocionale, që na tërheq tek individë të caktuar, ngaqë ata janë të afërmit e Profetit dhe gjeneza e tij, por ajo dashuri ka lidhje me Librin e Allahut që zgjatet nga qielli e deri në tokë.

Përmes saj realizohet lidhja e jetës së individit dhe shoqërisë me direktivat dhe vullnetin e Krijuesit të Plotfuqishëm.

Kjo për arsyen se ata përfaqësojnë një peshë të rëndë e të rëndësishme të Zotit në Tokë, janë argumentet e Allahut dhe treguesit e rrugës së Tij. Tek ata mishërohen cilësitë dhe përsosuritë, të cilat i dëshiron Allahu i Lartësuar.

Dashuria ndaj tyre, në të vërtetë, përfaqëson dashurinë për Allahun dhe dashurinë për vlerat dhe përsosuritë hyjnore. Kjo dashuri e bën besimtarin që të përshkojë shkallët drejt plotësimit e përsosurisë, të cilën e dëshiron Allahu i Lartësuar.

Nga ana tjetër, dashuria ndaj tyre garanton sigurinë e rrugës që çon drejt qëllimeve që dëshiron mesazhi islam. Kjo sepse ata janë burimi i pastër dhe besnik i dispozitave të mesazhit të Zotit, i koncepteve të tij dhe i vlerave morale e edukative.

Me këtë, dashuria e Ehli Bejtit është garanci për mbrojtjen e sheriatit islam, vijës së misionit të profetit Muhamed dhe ideve të tij.

Ata janë garanci për mbrojtjen e ummetit nga devijimi, në mënyrë që të ecë në rrugë të drejtë, e cila i siguron këtij ummeti të mirën dhe përsosurinë.

Në vijim, ju paraqesim ndikimet më të rëndësishme konsekuente të dashurisë ndaj Ehli Bejtit, gjenezës së Profetit të zgjedhur e të pagabueshëm, si dhe dobitë e kësaj dashurie në këtë botë dhe në Botën Tjetër, në përputhje me çfarë ka ardhur në tekstet islame:

1- Dashuria për Ehli Bejtin, është dashuri për Allahun dhe në Allahun

Me të vërtetë, dashuria për Ehli Bejtin mishëron dashurinë për Allahun e Lartësuar dhe dashurinë për të Dërguarin e Tij në format më aparenciale dhe ky është synimi i besimtarëve.

Allahu i Lartësuari ka thënë: **"Ata të cilët kanë besuar, kanë dashuri ekstreme për Allahun."**[261]

[261] Surja "El-Bekare", ajeti 165.

Dhe: **"Thuaj: 'Nëse me të vërtetë jeni nga ata që e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Allahu t'ju dojë juve."**[262]

E kemi thënë edhe më parë, në kapitullin e dytë, se dashuria për ta është dashuri për Allahun e Lartësuar dhe dashuri për të Dërguarin e Tij *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Gjithashtu, dashuria për ta është prej argumenteve më të mëdha të dashurisë ndaj Allahut, sepse është një dashuri që u drejtohet individëve që i do Allahu dhe për të cilët urdhëron që të duhen.

Urrejtja ndaj armiqve të tyre mishëron urrejtjen për hir të Allahut, sepse është një urrejtje që u drejtohet individëve që i urren Allahu dhe urdhëron për urrejtjen e tyre. Ky është realiteti i besimit dhe lidhja më e fortë.

I Dërguari i Allahut *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: "*Lidhja më e fortë e besimit është dashuria dhe urrejtja për hir të Allahut.*"[263]

Kur dashuria e tyre është për hir të Allahut, arrijmë lumturinë në të dy botët dhe u afrohemi vendqëndrimeve të vepërmirëve në Ahiret.

Imam Hysejni *(paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: "*Ai që na do ne për këtë botë, kërkuesin e kësaj bote e duan vepërmiri dhe i shthururi. Ai, i cili na do ne për hir të Allahut, do të jetë me ne në*

[262] Surja "Ali Imran", ajeti 31.
[263] *El-Kafij*, 2: 125-126/6. *Kenzu'l-'Ummal*, 1: 43/105 dhe ngjashëm me të 9: 6/24657.

Ditën e Ringjalljes si këto të dy." dhe ka bërë krahasimin ndërmjet dy gishtave tregues të tij."[264]

2. Njohja e së drejtës (vërtetës) **dhe siguria nga devijimi**

Nuk ka dyshim, se individi mysliman ka nevojë për një burim të kthjellët dhe të pastër, i cili i siguron atij njohjen e së drejtës nga e shtrembëta dhe i mundëson atij metodat më të afërta, të cilat i sigurojnë arritjen drejt së mirës së kësaj bote dhe Botës Tjetër.

Përderisa njeriu anon nga ai që do dhe nga ai që zemra e tij është e lidhur me të, atëherë ai që do Ehli Bejtin, do ta marrë diturinë nga vetë ata, fenë nga burimi i saj dhe besimin nga origjinaliteti i tij.

Me këtë, dashuria ndaj tyre (Ehli Bejtit) është ruajtëse dhe mbrojtëse nga devijimi në rrymat dhe fraksionet e shtrembëta e të humbura.

Ajo është një kriter i plotë për fenë e drejtë nga kamuflimet e të padrejtëve dhe iluzionet e tendenciozëve dashakeqës.

3. Kërkimi i plotësimit të fesë

I Dërguari i Allahut *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: *"Dashuria e Ehli Bejtit tim, e gjenezës sime, është plotësimi i fesë."*[265]

---

[264] *El-Mu'xhemu'l-Kebijr* i Taberanijut, 3: 134/2880.
[265] Emali's-Saduk, 161/1.

4. Bindja ndaj Allahut të Lartësuar dhe të Dërguarit të Tij

Vërtet, dashuria ndaj Ehli Bejtit dhe kapja pas udhëheqjes së tyre është një urdhër i Zotit i transmetuar në Librin e ndritur dhe i përcjellë me gjuhën e Profetit më madhështor *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, siç e kemi thënë edhe më parë në kapitullin e dytë të këtij kërkimi.

Si rrjedhojë, dashuria ndaj tyre është bindje ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij: **"Ai që i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, ka fituar një fitore madhështore."**[266]

5. Kapja pas lidhjes më të fortë

I Dërguari i Allahut *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, duke iu drejtuar prijësit të besimtarëve, Aliut *(paqja qoftë mbi të!)*, i ka thënë: *"O Ali, ai që ju do juve dhe kapet me ju, është kapur me lidhjen më të fortë."*[267]

Dhe: *"Ai, që dëshiron të kapet me lidhjen më të fortë, atëherë le të kapet me dashurinë ndaj Aliut dhe Ehli Bejtit tim."*[268]

Prijësi i besimtarëve, imam Aliu *(paqja qoftë mbi të!)*, ka thënë: *"Lidhja më e fortë është dashuria e Familjes së Muhamedit."*[269]

---

[266] Surja "El-Ahzab", ajeti 71.
[267] *Kifajetu'l-Ether*, 71. *Irshadu'l-Kulub* i Dejlemijut, 415, Menshuratu'sh-Sherijfi'r-Radijj, Kum, botimi 2.
[268] *'Ujun Akhbari'r-Rida*, 27: 58/216. *Jenabi'u'l-Meueddeh*, 2: 268/761.
[269] *Jenabi'u'l-Meueddeh*, 1: 331/2.

6. Qetësimi i zemrës dhe pastrimi i saj

Prijësi i besimtarëve *(paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: "Vërtet, i Dërguari i Allahut kur zbriti ky ajet **"Me përmendjen e Allahut, a nuk qetësohen zemrat"**[270], tha: *'Ky është për atë që e do Allahun dhe të Dërguarin e Tij, e do Ehli Bejtin tim sinqerisht e jo me gënjeshtra dhe i do besimtarët në prani e në mungesë. Me të vërtetë, me përmendjen e Allahut, e duan njëri – tjetrin."*[271]

Imam Bakiri *(paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: "*Nuk na do ne njeri dhe nuk na ndjek ne, deri sa Allahu t'ia pastrojë atij zemrën. Nuk e pastron Allahu zemrën e dikujt, derisa të jetë në paqe me ne. Nëse është në paqe me ne, e shpëton Allahu nga llogaria e ashpër dhe e siguron atë nga frika Ditën e Ringjalljes më të madhe."*[272]

Imam Sadiku *(paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: "*Kushdo që do të na dojë ne, do të jetë me ne Ditën e Ringjalljes, do të qëndrojë në hijen tonë dhe do të na shoqërojë ne në pozitat tona."*[273]

7. Mençuria

I Dërguari i Allahut *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: "*Ai që dëshiron të*

---

[270] Surja "Er-Ra'd", ajeti 28

[271] *Kenzu'l-'Ummal*, 2: 442/4448. *Ed-Durru'l-Menthur*, 4: 642 nga Ibn Merdeuejh. *El-Xha'ferijat*, 224

[272] *El-Kafij*, 1: 194/1 Bab Enne'l-Eimmete Nurull'llahi Azze ue Xhel'le.

[273] *De'aimu'l-Islam* i Ebu Hanijfes, 1: 73, Daru'l-Me'arif, Kajro. *Sherhu'l-Akhbar fi Fadaili'l-Eimmeti'l-Et'har* i Ebu Hanijfes, 3: 471/1367, Muessesetu'n-Neshri'l Islamij, Kum, botimi 1.

mbështetet tek Allahu, atëherë le ta dojë Ehli Bejtin tim. Ai që do mençuri, le të dojë Ehli Bejtin tim. Betohem në Allahun, ai që do t'i dojë ata, do të fitojë në këtë jetë dhe në Tjetrën."[274]

Imam Sadiku *(paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: *"Ai, i cili na do ne, Ehli Bejtin dhe realizohet në zemrën e tij dashuria për ne, burimet e mençurisë do të ecin në gjuhën e tij dhe do të ringjallet besimi në zemrën e tij."*[275]

8. Kënaqësia në momentin e vdekjes

Prijësi i besimtarëve *(paqja qoftë mbi të!)* i ka thënë Harith El-A'uerit: *"Dashuria ndaj nesh do të të sjellë ty dobi në tri gjëra: Në momentin e zbritjes së melekut të vdekjes, gjatë marrjes në pyetje në varrin tënd dhe në momentin e qëndrimit tënd përpara Allahut."*[276]

9. Ndërmjetësimi në Ditën e Ringjalljes

I Dërguari i Allahut *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: *"Ndërmjetësimi im për ummetin tim është për atë që do Ehli Bejtin tim dhe ata janë ndjekësit (shi'at) e mi."*[277]

---

[274] *Maktelu'l-Husejn* i Khauarizmijut, 1: 59 Mektebetu'l-Mufijd, Kum. *El-Menakibu'l-Mieh*, 106. *Feraidu's-Simtajn*, 2: 294/551. *Jenabi'u'l-Meueddeh*, 2: 332/969. *Xhamiu'l-Akhbar*, 62/77.

[275] *El-Mehasin* i El-Berkij, 1: 134/167.

[276] *A'lamu'd-Dijn* i Dejlemijut, 461.

[277] *Tarijkh Bagdad*, 2: 146. El-Xhamiu's-Sagijr, 2: 49.

Dhe: "*Zbatojeni dashurinë ndaj nesh, Ehli Bejtit, sepse ai që do takojë Allahun Ditën e Ringjalljes dhe që na do ne, hyn në Xhenet me ndërmjetësimin tonë.*"[278]

10. Pendimi, falja dhe pranimi i veprave

Dërguari i Allahut ka thënë: "*Ai që vdes me dashuri ndaj familjes së Muhamedit, vdes si dëshmor; ai që vdes me dashuri ndaj familjes së Muhamedit, vdes me mëkate të falura për të; ai që vdes me dashuri ndaj familjes së Muhamedit, vdes pendimtar; ai që vdes me dashuri ndaj familjes së Muhamedit, vdes besimtar me besim të plotësuar.*"[279]

Dhe: "*Dashuria për ne, Ehli Bejtin, fshin mëkatet dhe shumëfishon të mirat.*"[280]

Prijësi i besimtarëve *(paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: "*Kush na do ne, Ehli Bejtin, madhështohet bamirësia e tij, rëndon peshorja e tij për të mirë, pranohet vepra e tij, e fal atë Allahu dhe ai që na urren ne, nuk i vlen Islami i tij.*"[281]

---

[278] *El-Mu'xhemu'l-Eusat*, 3: 26/2251. *Mexhmau'z-Zeuaid*, 9: 172. *El-Emalij* i Shejkh Mufijdit, 13/1. *El-Emalij* i Shejkh Tusijut, 187/314. *El-Mehasin* i El-Berkijut, 1: 134/169. *Bisharetu'l-Mustafa li Shij'ati'l-Murteda* i Ebu Xha'fer Et-Tabarij, 100, El-Matba'atu'l-Hajdarije, En-Nexhef, botimi 2. *Irshadu'l-Kulub*, 254.

[279] *Tefsijru'l-Kesh'shaf* i Zemakhsherijut, 4: 220-221. *El-Xhami'u li Ahkami'l-Kur'an*, 16: 23. *Tefsijru'r-Razij*, 27: 165. *Feraidu's-Simtajn*, 2: 255/524. *Jenabi'u'l-Meueddeh*, 2: 333/972. El-'Umdeh i Ibn Batrijkut, 54/52. *Bisharetu'l-Mustafa*, 197. *Xhamiu'l-Akhbar*, 473/1335. *El-Fusulu'l-Muhimmeh*, 110.

[280] *El-Emalij* i Shejh Tusijut, 164/274. *Irshadu'l-Kulub* i Delejmijut, 253.

[281] *Meshariku Enuari'l-Jekijn* i El-Bursij, 51, Muessesetu'l-A'lemij, Bejrut.

Imam Hasani *(paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: *"Me të vërtetë, dashuria ndaj nesh i rrëzon mëkatet nga biri i Ademit, ashtu siç i rrëzon era gjethet nga pema."*[282]

Imam Bakiri ka thënë: *"Me dashurinë për ne, juve iu falen mëkatet."*[283]

11. Drita në Ditën e Ringjalljes

I Dërguari i Allahut *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: *"Ai që do të ketë më shumë dritë (nur) Ditën e Ringjalljes, do të jetë ai që ka dashur më shumë familjen e Muhamedit."*[284]

Dhe: *"Betohem në Allahun, atij që e do Ehli Bejtin tim, Allahu do t'i japë atij plot nur deri sa të kthehet në burimin tim. Ai që e urren Ehli Bejtin tim Allahu ia pengon atij këtë në Ditën e Ringjalljes."*[285]

12. Siguria prej tmerreve të Ringjalljes

I Dërguari i Allahut *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: *"Sigurisht, ai që do familjen e Muhamedit, sigurohet për llogarinë, peshoren dhe siratin (urën)."*[286]

---

[282] *El-Ikhtisas* i El-Mufijdit, 82, Mektebetu'z-Zahra, Kum. *Rixhalu'l-Kishij* i Tusijut, 111-112/178, botuar në Meshhed.
[283] *Emali't-Tusij*, 452/1010. *Bisharetu'l-Mustafa*, 67.
[284] *Sheuahidu't-Tenzijl*, 2: 310/948.
[285] *Sheuahidu't-Tenzijl*, 2: 310/947.
[286] *Fadailu'sh-Shij'a* i Sadukut, 47/1, Muessesetu'l-Imami'l-Mehdij, Kum, botimi 1. *A'lamu'd-Dijn*, 464. *Bisharetu'l-Mustafa*, 37. *Miatu Menkabeh*, 93.

Dhe: "*Ai, i cili na do ne, Ehli Bejtin, Ditën e Ringjalljes Allahu do ta tubojë të sigurtë.*"[287]

Dhe: "*Dashuria për mua dhe dashuria për Ehli Bejtin tim është e dobishme në shtatë raste, tmerri i të cilave është i madh: Në ndërrimin e jetës, në varr, në tubimin, në dhënien e Librit të veprave, në llogari, në peshore dhe në Sirat.*"[288]

Dhe: "*Ai që do i ketë këmbët më të qëndrueshme mbi Sirat prej jush, është ai që ka qenë më shumë i dashur ndaj Ehli Bejtit tim.*"[289]

Dhe: "*Nuk ka ndonjë që na ka dashur ne, Ehli Bejtin, e t'i tronditen këmbët, veçse i bëhet atij e qëndrueshme këmba tjetër, saqë e shpëton atë Allahu Ditën e Ringjalljes.*"[290]

13. Hyrja në Xhenet dhe shpëtimi nga Zjarri

I Dërguari i Allahut *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: "*S'ka dyshim se atë që vdes me dashuri ndaj familjes së Muhamedit, e përgëzon meleku i vdekjes me Xhennet e pastaj Munkeri e Nekiri. S'ka dyshim se ai që vdes me dashuri ndaj familjes së Muhamedit, përcillet për në Xhennet, ashtu siç përcillet nusja tek shtëpia e bashkëshortit të saj. S'ka dyshim se atij që vdes me dashuri ndaj familjes së Muhamedit, i hapen tek varri dy porta prej portave të Xhennetit.*

Irshadu'l-Kulub, 235. *Feraidu's-Simtajn*, 2: 258/526. *Maktelu'l-Husejn* i El-Khauarizmijut, 1: 40 dhe *El-Menakib* po i Khauarizmijut, 73/51

[287] *'Ujun Akhbari'r-Rida*, 27: 59/220.

[288] *Raudatu'l-Ua'idhijn*, 271. *Emali's-Saduk*, 18/3. *El-Khisal*, 360/49. *Bisharetu'l-Mustafa*, 17-18. *Xhamiu'l-Akhbar*, 513/1441. *Kifajetu'l-Ether*, 108

[289] *Kenzu'l-'Ummal*, 12: 97/34163. *Es-Saua'iku'l-Muhrika*, 187.

[290] *Duraru'l-Ehadijthi'n-Nebeuijeh bi'l-Esanijdi'l-Jahjauijjeh* i Jahja ibni'l-Husejn, 51, Muessesetu'l-A'lemij, Bejrut botimi 1.

S'ka dyshim se atij që vdes me dashuri ndaj familjes së Muhamedit, Allahu ia bën varrin vendprehje të melekëve të mëshirës…"[291]

Dhe: "*Ai, i cili na do ne për hir të Allahut, Allahu e strehon atë në hijen e një tende Ditën e Ringjalljes, ditë që s'ka hije me përjashtim të hijes së Tij dhe ai, i cili na do ne dhe dëshiron shpërblimin tonë, e shpërblen atë Allahu prej nesh me Xhennet.*"[292]

Hudhejfeja ka thënë: "Kam parë të Dërguarin e Allahut që kishte kapur për dore Hysejn ibn Aliun dhe tha: "*O ju njerëz! Gjyshi i Hysejnit është më i nderuar tek Allahu sesa gjyshi i Jusufit, birit të Jakupit dhe me të vërtetë: Hysejni është në Xhennet, babai i tij në Xhennet, nëna e tij në Xhennet, vëllai i tij në Xhennet, i dashuri i tyre në Xhennet dhe i dashuri i të dashurit të tyre në Xhennet.*"[293]

Imam Sadiku *(paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: "*Betohem në Allahun, ai që vdes dhe e do Allahun, të Dërguarin e Tij dhe i ndjek imamët atë nuk do ta prekë zjarri.*"[294]

14. Tubimi me Profetin dhe familjen e tij

I Dërguari i Allahut *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: "*Kthehen tek unë, te burimi, Ehli Bejti im dhe ata të cilët i kanë dashur ata prej ummetit tim si këto të dy…*" (d.m.th. dy gishtërinjtë tregues)[295]

---

[291] *El-Kesh'shaf* i Zemakhsherijut, 4: 220-221 si dhe burime të tjera që i kemi përmendur në paragrafin e dhjetë.
[292] *El-Fusulu'l-Muhimmeh*, 203. *Nuru'l-Ebsar*, 154.
[293] *Maktelu'l-Husejn* i El-Khavarizmit, 1: 67.
[294] *Rixhalu'n-Nexhashij*, 1: 138, Daru'l-Edua, Bejrut, botimi 1. *Sherhu'l-Akhbar*, 3: 463/1355.
[295] *Mekatilu'-Talibijjin* i Ebu'l-Ferexh El-Isfahanij, 76 Muessesetu'l-A'lemij, Bejrut, botimi 2. *Sherh Ibn Ebi'l-Hadijd*, 16: 45. *Dhekhairu'l-'Ukba*, 18. *El-Garat*, 2: 586.

Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu *(paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: Me të vërtetë, i Dërguari i Allahut mori për dore Hasanin dhe Hysejnin e tha: "*Ai, i cili më do mua, i do këta të dy, babain e tyre dhe nënën e tyre, ai do të jetë me mua në gradën time Ditën e Ringjalljes.*"[296]

Dhe: "*Ai, i cili na do ne, do të jetë me ne Ditën e Ringjalljes. Edhe sikur dikush të dojë një gur, Allahu do ta tubojë së bashku me të.*"[297]

Imam Sadiku *(paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: "*Ai, i cili na do ne, nuk na do për afrimitetin ndërmjet nesh dhe ndërmjet tij, as përshkak të një mirësie që i kemi bërë atij, përkundrazi, ai na do ne për hir të Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Ai që na do ne, do të shoqërohet me ne Ditën e Ringjalljes, si këta të dy* (…dhe i bashkoi dy gishtat e tij tregues.)"[298]

15. E mira e kësaj bote dhe e Botës Tjetër

I Dërguari i Allahut *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: "*Atë që e begaton Allahu me dashurinë ndaj imamëve prej Ehli Bejtit tim, ka fituar më të mirën e kësaj bote dhe të tjetrës dhe të mos dyshojë asnjë, se ai do jetë në Xhennet. Në dashurinë e Ehli Bejtit tim ka njëzet cilësi, dhjetë prej tyre, në këtë botë dhe dhjetë prej tyre, në tjetrën.*

---

[296] *Musned Ahmed*, 1: 77. *Sunenu't-Tirmidhij*, 5: 641/3773. *Fadailu's-Sahabe* i Ahmed ibn Hanbelit, 2: 694/1185. *Tarijkh Bagdad*, 13: 287. *Menakibu'l-Khauarizmij*, 138/156. *Emali's-Saduk*, 190/11. *Bisharetu'l-Mustafa*, 32.

[297] *Emali's-Saduk*, 174/9. *Reudatu'l-Ua'idhijn*, 457. *Mishkatu'l-Enuar fi Gurari'l-Akhbar* i Tabrasijut, 84, El-Mektebetu'l-Hajdarije, botimi 2.

[298] *A'lamu'd-Dijn*, 460.

Përsa i përket cilësive të kësaj bote, janë: Asketizmi, kujdesi në punë, devotshmëria në fe, dëshira për adhurim, pendimi para vdekjes, ngritja në mes të natës, mosinteresimi për atë që kanë në dorë njerëzit, kujdesi ndaj urdhrit të Allahut dhe ndalesës së Tij, përçmimi i kësaj bote dhe bujaria.

Cilësitë në Botën Tjetër janë: Nuk i hapet atij libri, nuk i ngrihet atij peshorja, i jepet libri i tij në të djathtë të tij, shkruhet për të 'i shpëtuar nga zjarri', fytyra e tij zbardhet, mbulohet me një veshje nga veshjet e Xhennetit, ndërmjetësohet për njëqind nga ehli bejti i tij, Allahu i Lavdishëm vështron drejt tij me mëshirë, kurorëzohet me kurora të Xhennetit dhe e dhjeta, hyn në Xhennet pa dhënë llogari. Lum për ata që e duan Ehli Bejtin tim!"[299]

Nga ky hadith dhe nga hadithet që i paraprinë këtij kapitulli, qartësohet se dashuria për Ehli Bejtin do të thotë dashuri ndaj cilësive të mira dhe moralit më të bukur për të cilat na nxit Allahu i Lartësuar dhe i Dërguari i Tij fisnik si: Asketizmi, kujdesi në punë, devotshmëria në fe, dëshira për adhurim, pendimi para vdekjes, ngritja në mes të natës, e të tjera që e shpien robin në pozita të më të zgjedhurve dhe fitimin e kopshtit të Xhenetit.

Gjithashtu, këtu bëhet e qartë se detyrimi i dashurisë ndaj tyre nënkupton detyrimin e kapjes me ta si udhëheqës të mesazhit të Zotit, që përfaqësojnë dëshirën e së drejtës dhe synetin e zotërisë së të dërguarve për ngritjen e shtyllave të fesë dhe disiplinimin e qenieve që të arrijnë pozita perfekte e të plota që i do Allahu i Lartësuar për ta.

[299] *El-Khisal*, 515/1. *Reudatu'l-Ua'idhijn*, 298.

Po ashtu duhet të duhen edhe ata që i duan dhe i pasojnë Ehli Bejtin dhe të kundërshtohen kundërshtarët e tyre. Thjesht dashuria për ta, pa vepra që e përmbushin këtë dashuri, nuk i vlen asgjë poseduesit të saj, nuk e shpie atë tek arritja e të dhënave për të cilat folëm në këtë kapitull.

Për këtë, transmetohet nga imam Sadiku *(paqja qoftë mbi të!)*, i cili ka thënë: "*Nuk është nasibij (armik) ai që armiqësohet ndaj nesh, Ehli Bejtit, sepse ti nuk do të gjesh njeri të thotë: 'Unë e urrej Muhamedin dhe familjen e Muhamedit. Por armik (nasibij) është ai, që armiqësohet ndaj jush dhe ai e di që ju na ndiqni neve dhe kundërshtoni armiqtë tanë.*"[300]

Transmetohet nga Imam Kadhimi *(paqja qoftë mbi të!)*, i cili ka thënë: "*Ai që është armik i pasuesve tanë, është armiku ynë; ai që i do ata, na do neve, sepse ata janë prej nesh, u krijuan nga balta jonë. Ai që i do ata, është prej nesh dhe ai që i urren, nuk është prej nesh…*"[301]

[300] *Me'ani'l-Akhbar*, 365/1. *Sifatu'sh-Shij'a*, 9/17.
[301] *Sifatu'sh-Shi'a*, 3-4/5.

KAPITULLI I PESTË

Ehli Bejti ndërmjet dashurisë së tepruar (*guluv*) dhe urrejtjes (*bugd*)

Ajo që s'ka dyshim, është se cilësitë e mira dhe shembulli më i mirë i moralit qëndrojnë ndërmjet dy ekstremeve ose ndërmjet dy veseve. Kështu që, trimëria qëndron ndërmjet guximit dhe frikës, bujaria ndërmjet koprracisë dhe shpenzimit të tepërt dhe ekuilibri në dashurinë e Ehli Bejtit qëndron ndërmjet dashurisë së tejkufijshme dhe urrejtjes.

Profeti i zgjedhur dhe imamët e udhëzuar na kanë paralajmëruar për shkatërrimin e tepruesve ekstravagantë dhe urryesve dhe shpëtimin e të moderuarve në dashurinë e tyre.

Prijësi i besimtarëve *(paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: Më ka thënë mua Profeti: "*Tek ti ka një shembull nga Isai. E urryen atë jehudinjtë, saqë shpifën ndaj nënës së tij. E deshën atë të krishterët, saqë e zbritën atë në një pozitë që s'është për të.*" Pastaj tha: "*Shkatërrohen dy persona: Një i dashuruar i shfrenuar që thotë për mua atë që s'ka lidhje me mua dhe një urryes që merret me çështjet e mia që të më përgojojë e të shpifë për mua.*"[302]

[302] *Musnedu Ahmed*, 1: 160. *Es-Saua'iku'l-Muhrika*, 123. *Musned Ebi Ja'la*, 1: 406/534. Biografia e prijësit të besimtarëve nga *Tarijkh Medineti Dimashk*,

Kështu që duhet të sqarojhet patjetër pozita e dashurisë për ta, në mënyrë që të bëhet e mundur për ne kapja me modelin e mesëm e shembullin mesatar.

Teprimi (*guluv*)

Teprimi (*guluv*) në gjuhë ka kuptimin: tejkalimi i kufirit dhe dalja jashtë synimit.[303] Allahu i Lartësuar thotë: **"O ithtarë të Librit, *mos e teproni* në fenë tuaj dhe mos thoni gjë tjetër për Allahun, përveç asaj që është e vërtetë. Mesihu Isa është vërtet biri i Merjemes, i Dërguari i Allahut dhe fjala e Tij që e hodhi tek Merjemi dhe shpirt prej Tij. Besojeni pra Allahun dhe të Dërguarin e Tij e mos thoni: "Tre." Jepini fund kësaj se është më mirë për ju. Me të vërtetë, Allahu është një Zot i Vetëm, i Lartësuar është Ai! Larg qoftë asaj, që Ai të ketë fëmijë."[304]**

Shejkh Mufijdi ka thënë: "Ndaloi (Allahu) tejkalimin e kufirit për Mesihun, Isain dhe paralajmëroi për daljen nga synimi. Atë që pretendonin të krishterët për të e ka konsideruar teprim (*guluv*) për shkak se tejkaluan kufirin."[305]

2: 237/742. *Emali't-Tusij*, 256/462. *Es-Sunneh* i Ibn Ebi Asimit, 470/1004, El-Mektebu'l-Islamij, Bejrut, botimi 2.

[303] *Lisanu'l-'Arab*, 15: 2, fjala (*Galà*). *Mukhtaru's-Sihah*, 480.

[304] Surja "En-Nisa", ajeti 171.

[305] *Tas'hijhu'l-I'tikad* i El-Mufijd, 109, një seri e botimeve të Shejh Mufidit, Daru'l-Mufijd, Bejrut, botimi 2.

Teprimi (*guluv*) në terminologji ka kuptimin e tejkalimit të kufirit logjik e obligativ në besimin fetar dhe detyrimet legjitime nga Allahu.

Tepruesit (*gulat*) tek shiitët imamitë janë ata që thonë për Ehli Bejtin atë që s'e thonë ata për veten e tyre, siç pretendojnë për ta Profetësinë e Hyjninë.[306]

Imam Sadiku *(paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: "*Allahu e mallkoftë atë që thotë për ne çfarë nuk themi vetë ne për veten tonë! Allahu e mallkoftë atë që na largon ne nga adhurimi për Allahun i Cili na krijoi! Tek Ai është kthimi dhe takimi ynë dhe në dorën e Tij është skalpi (balluket) ynë.*"[307]

Shkaqet e përhapjes së teprimit

Teprimi (*guluv*) është një fenomen jo i natyrshëm që kultivohet nga degradimi ideor dhe perversiteti ideologjik. Ky perversitet kthehet tek moskuptimi i fesë, largimi nga e vërteta e adhurimit ndaj Allahut dhe mahnitja me kerametet njerëzore e jo me mrekullitë e Krijuesit.

Teprimi (*guluv*) është përhapur për shkaqe të shumta, e prej tyre, ndjesitë dhe gjurmët ideologjike, të cilat rrjedhin nga fetë e kaluara. Kur'ani i ndritur tregon për ekzistencën e këtij devijimi tek Ithtarët e Librit, siç u përmend edhe tek ajeti i mësipërm thënia e Tij e Lartësuar:

---

306 *Mexhmau'l-Bahrejn*, Fakhruddijn Et-Turejhij, fjala (*guluv*), 2: 1332, Muessesetu'l-Bi'theh, Kum, botimi 1.

307 *Biharu'l-Enuar* i Mexhlisijut, 25: 297/59 nga *Rixhalu'l-Kishij*, Muessesetu'l-Uefa, Bejrut, botimi 2.

"E mohuan të vërtetën ata që thanë se Allahu është ai, Mesihu, biri i Merjemes."[308]

Prej atyre shkaqeve, ka edhe shkaqe politike që synojnë pushtetin dhe sundimin e njerëzve, kërkimin e udhëheqjes dhe autoritetit. Apo synojnë degjenerimin e personave të cilët hiperbolizojnë, shtrembërimin e reputacionit të tyre, uljen e rëndësisë së tyre dhe mohimin e tyre ose për të akuzuar një prej sekteve apo fraksioneve për hyjnizimin e njeriut, shthurjen e ideologjisë, shtrembërimin e parimeve të saj, si dhe largimin e njerëzve prej saj.

Imam Rizai *(paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: "*Vërtet, kundërshtarët tanë kanë trilluar lajme për cilësitë tona duke i ndarë ato në tri pjesë. Një prej tyre është hiperbolizimi; e dyta, mosinteresimi për çështjen tonë dhe e treta, deklarimi i hapur për shpifje ndaj armiqve tanë. Kështu, nëse dëgjojnë njerëzit për hyjzimin tonë, do t'i quajnë të pafe pasuesit tanë dhe do t'u atribuojnë atyre thënien për hyjninë tonë. Nëse dëgjojnë mosinteresim, besojnë se është tek ne. Kur dëgjojnë shpifjet e armiqve tanë me emrat e tyre, do të shpifin me emrat tanë." Allahu i Lavdishëm ka thënë:* **"Ju mos i shani ata** (zotat, idhujt) **që ju luten, pos Allahut, e si hakmarrje, të fyejnë Allahun nga armiqësia, duke mos e ditur."**[309]

Prej atyre shkaqeve janë interesat materiale dhe ambicjet personale që synojnë shantazhimin e pasurive të njerëzve dhe ngrënien e tyre pa të drejtë. Prej tyre tekat e

---

[308] Surja "El-Maide", ajeti 17.

[309] *'Ujun Akhbari'r-Rida*, 17: 237/63. *Bisharetu'l-Mustafa*, 221 dhe ajeti 108 nga surja "El-En'am".

ulta individuale që burojnë nga shthurjet morale dhe problemet psikologjike që i ftojnë mbartësit e këtyre veseve në rebelim kundër ligjeve të Krijuesit të Lavdishëm. Kështu, lejuan të ndaluarat, pakësuan adhurimet dhe u stacionuan tek argëtimet.

Me të gjithë shkaqet që përmendëm, në mënyrë të përgjithshme, mund të themi se me të vërtetë teprimi me manifestimet e tij të ndryshme është një fenomen emergjent i përhapur me donacione sistematike nga ana e armiqve të Islamit, të cilët dështuan në përballjen me të në vendbanimet e luftës e fushëbeteja.

Ata vazhdojnë të intrigojnë ndaj tij që të zhveshin parimet islame nga qeniet e bijve të tij, duke shtrembëruar bazat e tij, gjërat e domosdoshme dhe bindjet e tij, por nuk e kanë plotësuar qëllimin e tyre, sepse ia kanë prerë imamët e udhëzuar rrugën përpara kësaj sëmundjeje epidemike, duke e luftuar atë me gjithçka që u është dhënë atyre nga elementet e forcës e mundësisë.

Thëniet e *gulat*ëve dhe fraksionet e tyre

Nga thëniet më të rëndësishme të *gulat*ëve janë: hyjnizimi i Profetit dhe imamëve dhe se ata janë partnerë të Allahut të Lartësuar në krijim, se ata furnizojnë dhe krijojnë dhe se Allahu i Lartësuar ka hyrë në ta ose është unifikuar me ta. Ata e dinë të fshehtën pa shpallje apo inspirim, pretendojnë se ata janë pa fillim dhe mohojnë krijimin e tyre. Ata thonë se njohja e tyre (Profetit dhe imamëve)

mjafton nga të gjitha bindjet e adhurimet dhe nëse dikush mbart këtë njoje nuk ka detyrime të tjera.

Po ashtu thonë se Allahu i ka autorizuar ata me çështjen e robve me autorizim absolut e në mënyrë të pavarur.

Gjithashtu, thonë se imamët janë profetë, shpirtrat rimishërohen me njëri-tjetrin. Mohojnë vdekjen për ta dhe martirizimin, me kuptimin se ata nuk vriten, por u është dukur atyre, pra të tjerëve.

Ata theksojnë përparësinë e imamëve mbi Profetin në dituri, trimëri etj., nga shembujt më të lartë të moralit e të tjera ideologji e besime abuzive e të pabaza si këto, që zvogëlojnë Madhështinë e Allahut, Aftësinë e Tij, Çështjen e Tij dhe vendosin krijesën në pozitën e Allahut të Lartësuar.

Me këtë shihet një hiperbolizim ose teprim në lidhje me imamët, duke i vendosur ata në një pozitë jo si ajo që ka caktuar Allahu për ta e gradën me të cilën i specifikoi.

Fraksionet e gulatëve janë të shumta që janë përhapur në etapa të ndryshme, ku prej tyre dallojmë: El-Bejanije, El-Khitabije, Esh-Sha'ijrije, El-Mugijrije, El-Baije, El-Gurabije, El-'Uljaije, El-Mukhammese, El-Bezijije dhe El-Mensurije[310] e të tjera si këto nga fraksionet e humbura, të cilat dështuan dhe u zhdukën e falënderimi i takon vetëm Allahut.

[310] Shih: *El-Farku bejne'l-Firak* i Bagdadijut; *El-Mekalat ue'l-Firak* i Esh'arijut; *Firaku'sh-Shi'a* i Neubekhtijut; *El-Milel ue'n-Nihal* i Shehrestanit; *Meusu'atu'l-Firaki'l-Islamijjeh* i Muhamed Xhevad Meshkur.

Ai që beson, qoftë edhe me disa prej bindjeve të tyre, ai është i pafe (*kafir*), është i mallkuar dhe është jashtë Islamit, sipas tekstit të Kur'anit të ndritur, Synetit të pastër dhe sipas unanimitetit të medhhebit real e të drejtë të të dymbëdhjetëve (*ithna'asherij*), siç do ta sqarojmë në vijim.

Qëndrimi i Ehli Bejtit (paqja qoftë mbi ta!) **ndaj gulatëve**

Ehli Bejti (paqja qoftë mbi ta!) ka mbajtur një qëndrim të hapur kundër lëvizjes së *gulatëve*. Ata kanë sakrifikuar në luftimin e tyre duke shpenzuar të gjitha kapacitetet për t'u dhënë fund *gulatëve*, hiperbolizimit dhe parandalimit të përhapjes së tyre.

Ehli Bejti *(paqja qoftë mbi ta!)* qartësuan se teprimi (*el-guluv*) është mohim, politeizëm e dalje nga Islami. Ata i mallkuan *gulatët* dhe u shmangën prej tyre. Ua ndërprenë rrugën dhe zbuluan shtrembërimet dhe gënjeshtrat e tyre dhe paralajmëruan shi'at prej tyre.

Më poshtë po paraqesim disa thënie të transmetuara në lidhje me këtë çështje.

1- I Dërguari i Allahut *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: *"Mjerë ju dhe teprimi, sepse janë shkatërruar ata që kanë qenë para jush për shkak të teprimit."*[311]

2- Prijësi i besimtarëve *(paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: *"Është ndërtuar mohimi mbi katër shtylla: imoralitetin, teprimin, dyshimin dhe iluzionin."*[312]

---

[311] *Et-Tabakatu'l-Kubra* i Ibn Sa'dit,2: 180-181. *Es-Sunenu'l-Kubra* i Bejhakijut,5: 127.
[312] *Usulu'l-Kafij*, 2: 391/1.

3- Dhe: "*Mjerë ju dhe teprimi ndaj nesh. Thoni: 'rob të krijuar' dhe thoni për virtytet tona çfarë të doni."*[313]

4- Imam Sadiku *(paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: "*Thuaju gulatëve: 'Pendohuni tek Allahu, sepse ju jeni imoralë, mohues dhe politeistë."*[314]

5. Dhe: "*Mallkimi i Allahut qoftë mbi Abdulla ibn Sebein, sepse ai pretendoi hyjninë për prijësin e besimtarëve! Betohem në Allahun, prijësi i besimtarëve ka qenë rob i bindur i Allahut! Mjerë për atë që gënjen ndaj nesh dhe atë popull që thotë për ne atë që se themi ne vetë për veten tonë! Shfajësohemi tek Allahu prej tyre, shfajësohemi tek Allahu prej tyre!"*[315]

6. Sedijri e pyeti atë (Imam Sadikun): "*Ka një popull që pretendon për ju se jeni zota dhe për këtë na lexojnë ne nga Kur'ani:* **"Dhe ai është i cili në qiell ka një Zot dhe në Tokë ka një Zot."**[316] Imami i tha: "*O Sedijr, dëgjimi im, shikimi im, qenia ime, mishi im, gjaku im dhe flokët e mi janë të dlira prej tyre. I Dlirë dhe i Pastër është Allahu prej tyre! Ata nuk janë në fenë time, as në fenë e baballarëve të mi. Betohem në Allahun, kur të më bashkojë Allahu mua me ata në Ditën e Ringjalljes, Ai do të jetë i zemëruar ndaj tyre."*[317]

7- Dhe: "*Ruajini të rinjtë tuaj nga Gulatët që të mos i prishin, sepse Gulatët janë krijesa me e keqe e Allahut, zvogëlojnë*

---

[313] *El-Khisal*, 614/10. *Tuhafu'l-'Ukul 'an Ali'r-Resul* i Ibn Shu'be El-Harranij, 104, El-Mektebetu'l-Hajdarije, En-Nexhefu'l-Eshref, botimi 5. *Gururu'l-Hikem*, 2740.

[314] *Rixhalu'l-Kishij*, 297/527.

[315] *Rixhalu'l-Kishij*, 106/170-174.

[316] Surja "Ez-Zukhruf ", ajeti 84.

[317] *Usulu'l-Kafij*, 1: 269/6.

Madhështinë e Allahut, pretendojnë hyjni për robtë e Allahut. Betohem në Allahun, gulatët janë më të këqinj sesa jehudët, të krishterët, mexhusët dhe politestët."[318]

Qëndrimi i dijetarëve imamit (shiit) ndaj gulatëve

Ndjekësit e medh'hebit të Ehli Bejtit, veçanërisht dijetarët e medhhebit të drejtë, kanë mbajtur një qëndrim të qartë e të hapur ndaj lëvizjes ekstreme të gulatëve.

Ky qëndrim i tyre bazohet në lajmet e imamëve të Ehli Bejtit *(paqja qoftë mbi ta!)*. Kështu, ata u bashkuan me unanimitet me pafajësi nga thëniet e tyre të fëlliqura, i mallkuan ata dhe bënë të qartë gënjeshtrat dhe shpifjet e tyre në shumë prej librave të besimi dhe apologjisë (ilmul kelam).

Që ju po përcjellim disa prej thënieve të tyre:

Shejkh Saduku ka thënë: *'Besimi ynë për Gulatët dhe për "el-mufauideh" është se ata janë mohues të Allahut të Lartësuar dhe janë më të këqinj se jehudijtë, të krishterët, zjarrputistët, kaderijtë, harurijtë dhe se të gjithë ndjekësit e shpikjeve (bidadit), epsheve e të humburve.'*[319]

Shejkh Mufijdi ka thënë: *'Gulatët janë ata që shtiren me Islam, janë ata të cilët i mveshën prijësit të besimtarëve dhe imamëve trashigimtarë të tij hyjninë dhe profetësinë … Ata janë të humbur dhe mohues. Ka gjykuar për ta prijësi i besimtarëve me*

---

[318] *Emali't-Tusij*, 650/1349.

[319] *I'tikadatu's-Saduk*, 97/37, El-Mu'temeru'l-'Alemij li Elfijjeti'sh-Shejkhi'l-Mufidj, Kum, botimi 1.

vdekje e djegie në zjarr dhe imamët me mohimin dhe nxjerrjen nga Islami."[320]

Shejkh Mudhafferi ka thënë: *'Nuk besojmë tek imamët tanë çfarë besojnë gulatët dhe hululinjtë:* **"U ekzagjerua fjala që doli nga gojët e tyre."** *Madje, bindja jonë e veçantë është se ata janë njerëz si ne dhe kanë të drejta si ne. Ata janë njerëz të nderuar. I specifikoi Allahu i Lartësuar me fisnikërinë e Tij, i deshi ata me përfaqësimin e Tij, ku ishin në gradat më të larta të plotësimit ndër njerëz për nga dituria, devotshmëria, trimëria, bujaria, dëlirësia dhe të gjitha moralet e mira dhe cilësitë e lavdërueshme të cilave nuk u afrohet njeri nga njerëzit në atë që u specifikuan me të.'* Imami ynë Sadiku *(paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: *"Atë që u ka ardhur juve prej nesh si e lejuar tek krijesat, e ju nuk e kuptoni e as nuk e dini, mos e kundërshtoni dhe na e dedikoni ne. Atë që ju ka ardhur juve prej nesh që nuk është e lejuar për krijesat, luftojeni dhe mos na e dedikoni neve."*[321]

Shejkh Kashifu'l-Gita ka thënë në fillim të bisedës së tij për gulatët e thëniet e tyre: *'Shiitët imaminj dhe imamët e tyre janë të pastër nga këto fraksione me pastërtinë e ndalimit absolut të tyre… e janë të dlirë nga këto thënie. I konsiderojnë ato si mohimin dhe humbjen më të turpshme. Feja e tyre* (shiitëve) *s'është gjë tjetër, veçse Njësimi absolut. Ata thonë se Krijuesi është i pastër nga çdo ngjasim me krijesat…'*[322]

---

[320] *Tas'hijhu'l-I'tikad*, 131, Faslun fi'l-Guluvi ue't-Tefuijd.

[321] *'Akaidu'l-Imamijjeh* i Shejkh El-Mudhaffer, 326/28 Akijdetuna fi'l-Eimmeh, Muessesetu'l-Imam Ali, Kum, botimi 1.

[322] *Aslu'sh-Shi'a ue Usuluha* i Shejh Kashifu'l-Gita, 173-177 Muessesetu'l-Imam Ali, Kum, botimi 1.

Urrejtja e Ehli Bejtit

Përveç aspektit të *teprimit* në hak të Profetit dhe imamëve, disa neglizhojnë kundrejt të drejtave të tyre duke pakësuar aftësinë e tyre, duke ulur vendin e tyre të drejtë tek Allahu i Lartësuar, pozitën dhe rolin e tyre në përçimin e mesazhit të Zotit e misionit të tyre, mbrojtjen dhe ekzekutimin e dispozitave të saj, duke mohuar atyre prej mrekullive e kerameteve që janë thënë e dëshmuar nga paraardhësit e pasardhësit e tyre, duke i bërë ata si njerëzit e tjerë.

Më e keqja është se disa armiq i tejkalojnë kufijtë e urrejtjes së neveritshme e smirës vdekjeprurëse për gjithçka që i dedikohet Ehli Bejtit prej besimit, moralit, virtyteve.

Po ashtu edhe për këdo që beson në dashurinë ndaj tyre dhe i merr ata si udhëheqës misionarë që i zgjodhi Allahu i Lartësuar për përçimin e fesë së Tij dhe mesazhit të Tij pas profetit Muhamed *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*

Urrejtja ndaj tyre është mosbindje e rebelim ndaj urdhrit të Allahut të Lartësuar dhe Profetit të Tij, që ka gjykuar me dashuri ndaj tyre, kapje me litarin e tyre dhe zbatimin e udhëzimeve të tyre, kështu që ajo është një urrejtje për Allahun dhe të Dërguarin e Tij.

I Dërguari më bujar *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, duke treguar për Ehli Bejtin, ka thënë: "*Ai që i urren ata, më ka urrer mua.*"[323]

[323] Biografia e Imam Hysejnit nga *Tarijkh Medineti Dimashk*, 91/126.

Imam El-Hadij *(paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: "*Ai që i urren ata, ka urryer Allahun.*"[324] Dhe "*Ai që shan Aliun, më ka sharë mua dhe ai që më shan mua, ka sharë Allahun.*"[325]

Urrejtja e tyre është nga shenjat e hipokrizisë, mjerimit e varfërisë së lindjes.

I Dërguari i Allahut *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: "*Ai që na urren ne, Ehli Bejtin, është hipokrit.*"[326]

Dhe: "*Nuk na urren ne, veçse një hipokrit i ligë.*"[327]

Dhe: "*Nuk na urren ne, veçse një i ligë nga gjyshi e lindje të keqe.*"[328]

Ndikimet e urrejtjes së tyre

Nëse dashuria e Ehli Bejtit i siguron njeriut lumturinë në të dy botët, atëherë urrejtja dhe armiqësia ndaj tyre sjellin daljen nga feja, futjen në Zjarr, zemërimin e Allahut, mjerim të përhershëm, ashtu siç tregojnë hadithet në vijim:

1- I Dërguari i Allahut *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: "*Betohem në Atë, në dorën e të Cilit është qenia ime, kushdo që na urren ne Ehli Bejtin, Allahu e fut atë në zjarr.*"[329]

---

[324] *'Ujunu Akhbari'r-Rida*, 27: 279 Ez-Zijaretu'l-Xhami'a.

[325] *El-Mustedrek* i Hakimit, 3: 121. *Kenzu'l-'Ummal*, 6: 401. *Musned Ahmed*, 6: 323. *Khasaisu'n-Nisaij*, 24.

[326] *Fadailu's-Sahabe*, 2: 661/1126. *Ed-Durru'l-Menthur*, 6: 7. *Keshfu'l-Gummeh*, 1: 47. *Dhekhairu'l-'Ukba*, 18.

[327] *Dhekhairu'l-'Ukba*, 18. *Jenabi'u'l-Meuedde*, 2: 134/381. *Es-Saua'iku'l-Muhrika*, 230.

[328] *Er-Rijadu'n-Nadire*, 2: 189. *Erxhahu'l-Metalib*, 309. *Menakibu'l-'Ashera*, 189.

[329] *El-Mustedrek* i Hakimit, 3: 162/4717 dhe e cilësoi të saktë atë. *Ed-Durru'l-Menthur*, 6: 7. *Es-Saua'iku'l-Muhrika*, 143. *El-Khasaisu'l-Kubra*, 2: 266. *Sijeru A'lami'n-Nubela*, 2: 123, etj.

2- Dhe: "Dy lloje nga ummeti im nuk janë pjesë e Islamit: *"Ai që i shpall Ehli Bejtit tim luftë gulatët në fe e renegatët e saj."*[330]

3- I Dërguari i Allahut *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, duke bërë me shenjë nga Hasani dhe Hysejni, ka thënë: *"Ai, i cili i urren këta të dy, më ka urryer mua; ai, i cili më urren mua, ka urryer Allahun dhe ai, i cili urren Allahun, Ai e fut atë në zjarr."*[331]

4- Dhe: *"Ai, i cili i urren ata, atë e urren Allahu."*[332]

5- Dhe: *"Ai, i cili na urren ne, Ehli Bejtin, Allahu e tubon atë Ditën e Ringjalljes jahudi."* Xhabir ibn Abdullah El-Ensarij i tha: *"O i Dërguari i Allahut, edhe nëse personi agjëron, falet dhe pretendon se është mysliman?"* Tha: *"Edhe nëse agjëron, falet dhe pretendon se është mysliman."*[333]

6. Prijësi i besimtarëve, imam Aliu *(paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: *"Për ata që na urrejnë ne, ka dallgë nga zemërimi i Allahut."*[334]

7. Imam Bakir *(paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: *"Erdhi një person tek Profeti dhe i tha: "O i Dërguari i Allahut, e kushdo që thotë La Ilahe Il-lallah (Nuk ka Zot tjetër, përveç Allahut!) është*

---

330 *Men la Jahduruhu'l-Fakijh*, 3: 258/10, Kitabu'n-Nikah, Bab Ma Ehal'lAll-llahu Azze ue Xhel'le mine'n-Nikah ue ma Harreme minhu.

331 *Musned Ahmed*, 2: 288. *El-Mustedrek* i Hakimit, 3: 166. *Sunenu't-Tirmidhij*, 2: 24 dhe 307. *El-Mu'xhemu'l-Kebijr*, 3: 50/2655. *Kenzu'l-'Ummal*, 13: 105. *Mexhmau'z-Zeuaid*, 9: 181. *Dhekhairu'l-'Ukba*, 123. *Tarijkh Bagdad*, 1: 141.

332 *Kenzu'l-'Ummal*, 12: 98/34168. *Bisharetu'l-Mustafa*, 40.

333 *El-Mu'xhemu'l-Eusat* i Taberanijut, 4: 389/4002. *Emali's-Saduk*, 273/2. *Reudatu'l-Ua'idhijn*, 297. *Mexhmau'z-Zevaid*, 9: 172.

334 *Tuhafu'l-'Ukul*, 116. *El-Khisal*, 627/10. *Gureru'l-Hikem*, 7342.

besimtar?" Tha: "*Vërtet, armiqësia ndaj nesh të çon me jehudët e të krishterët."*[335]

Ekuilibri në dashurinë ndaj Ehli Bejtit *(paqja qoftë mbi ta!)*

Nga ajo që u tha më lart, na bëhet e qartë se shpëtimi shëmbëllehet në ekuilibrin e dashurisë për Ehli Bejtin *(paqja qoftë mbi ta!)*. Ai është kufiri i mesëm, i cili qëndron ndërmjet maksimales e minimales, është dashuria me të cilën jemi urdhëruar dhe është detyrë e jona që të besojmë e ta takojmë Allahun me të, e cila është një dashuri për Allahun e Lartësuar.

I Dërguari i Allahut *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: "*O Ali, në ty ka një shembull nga Isai, i biri i Merjemes: E deshi atë një popull, e tepruan dashurinë ndaj tij dhe u shkatërruan për këtë. E urryeu atë një popull, e tepruan urrejtjen ndaj tij dhe u shkatërruan për këtë. Një popull bëri ekuilibër në dashurinë dhe urrejtjen ndaj tij, dhe shpëtuan."*[336]

Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu *(paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: "*Na duani ne me dashurinë e Islamit, sepse i Dërguari i Allahut ka thënë: 'Mos më ngreni më shumë se mbi të drejtën time, sepse Allahu i Lartësuar më ka pranuar si rob, para se të më pranojë si të Dërguar."*[337]

---

[335] *Emali's-Saduk*, 221/17. *Bisharetu'l-Mustafa*, 120.

[336] *Emali-t-Tusij*, 345. *Keshfu'l-Gummeh*, 1: 321. Ngjashëm me këtë përmendëm në fillim të kapitullit si dhe nga burime të tjera.

[337] *El-Mu'xhemu'l-Kebijr* i Taberanijut, 3: 138/2889

Prijësi i besimtarëve, imam Aliu *(paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: "*Do të shkatërrohen për mua dy kategori: i dashuruari ekstrem, dashuria e të cilit shkon në të padrejtën dhe urryesi ekstrem, urrejtja e të cilit shkon në të padrejtën. Nga njerëzit me gjendjen më të mirë në mua është modeli i mesëm, kështu që zbatojeni atë.*"[338]

Dhe: "*Shkatërrohen për ne, Ehli Bejtin, dy grupe: I dashuruari marrëzisht dhe shpifësi përgojues.*"[339]

Imam Rizai *(paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: "*Ne, familja e Muhamedit, jemi modeli i mesëm, që nuk na kupton gulati dhe nuk na e kalon askush.*"[340]

O Allah i Plotpushtetshëm, na bëj ne ndihmës besnikë të tyre, ummetin tonë me dashurinë për ta mbushe, na grumbullo ne nën udhëheqjen e tyre! Vërtet, Ti je Trashëgimtari dhe Triumfatori më i Shkëlqyer.

Lutja jonë e fundit është se falënderimi i takon vetëm Allahut, Zotit të botëve! Lutja më e mirë dhe përshëndetja më e plotë qoftë mbi Muhamedin e zgjedhur dhe familjen e tij të udhëzuar e besnike!

---

[338] *Nehxhu'l-Belaga*, Ligjërata 127.

[339] *Es-Sunneh* i Ibn Ebi Asimit, 470/1005.

[340] *Usulu'l-Kafij*, 1: 101/3, Babu'n-Nehji 'ani's-Sifeti bigajri ma uesafe bihi Nefsehu Te'ala.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

TEMA **FAQJA**

FJALA E SHOQATËS.....**5**
HYRJE.....**9**

KAPITULLI I PARË

KUSH ËSHTË EHLI BEJTI? **12**
KËRKIMI I PARË.....**13**
Ehli Bejti në gjuhë dhe terminologji.....**13**
KËRKIMI I DYTË.....**19**
Ehli Bejti në ajetin e pastrimit.....**19**
Hadithi i mbulesës (mbështjelljes) mes transmetuesve dhe burimeve.....**21**
Burimet e hadithit të mbulesës.....**23**
Saktësia e hadithit.....**27**
Hedhja e dyshimit në konceptin e Ehli Bejtit.....**28**

KAPITULLI I DYTË

Dashuria për Ehli Bejtin në Kur'an.....**44**
KËRKIMI I PARË.....**45**
Dashuria e Ehli Bejtit në Kur'an.....**45**
Çfarë është transmetuar për Imamët e Ehli Bejtit në këtë ajet?.....**49**
Shpjegime (te'uilat) të tjera për ajetin.....**50**
Dyshime dhe sqarime.....**55**

E para: Sure "Shura" është mekkase.....**56**
Përgjigjja.....**56**
E dyta: Ajeti nuk përshtatet me pozitën profetike dhe mohon disa ajete.....**58**
Përmbajtja e këtij dyshimi.....**58**
Përgjigjja.....**60**
KËRKIMI I DYTË.....**65**
Dashuria për Ehli Bejtin në traditën e pastër profetike.....**65**
Nxitja për dashurinë ndaj tyre.....**66**
Dashuria ndaj tyre është dashuri ndaj Allahut dhe ndaj të Dërguarit të Tij.....**67**
Dashuria ndaj tyre është bazë e Islamit.....**68**
Dashuria ndaj tyre është adhurim.....**68**
Dashuria ndaj tyre është shenjë e besimit.....**69**
Dashuria për ta është shenjë e lindjes së pastër.....**70**
Dashuria ndaj tyre është nga ato gjëra, për të cilat, do të pyetet Ditën e Ringjalljes.....**72**
Dashuria për Imam Aliun.....**73**
Mirësia e dashurisë ndaj tij.....**73**
Përse ta duam Aliun?.....**74**
Së pari: Dashuria ndaj tij është një urdhër i Zotit.....**74**
Së dyti: Në të vërtetë, Allahu i Lartësuar dhe i Dërguari i Tij e duan prijësin e besimtarëve.....**75**
1. Hadithi i shpendit *(et Tajir)*.....**76**
2. Hadithi i flamurit *(err Rrajetu)* **77**
Së treti: Dashuria ndaj tij është dashuri për Allahun dhe për të Dërguarin e Tij.....**78**

Së katërti: Dashuria e tij është besim dhe urrejtja e tij është hipokrizi.....**79**
Dashuria për Fatime Zahranë.....**81**
Dashuria për dy nipat, Hasanin dhe Hysejnin.....**84**

KAPITULLI I TRETË

Virtytet e Ehli Bejtit në Kur'an dhe në Synet.....**89**
KËRKIMI I PARË.....**90**
Virtytet e Ehli Bejtit në Kur'anin e shenjtë.....**90**
Dëshmia e parë.....**93**
Dëshmia e dytë.....**93**
Dëshmia e tretë.....**94**
Aliu në Kur'an.....**99**
KËRKIMI I DYTË.....**106**
Virtytet e Ehli Bejtit në synetin e pastër.....**106**
Virtytet e prijësit të besimtarëve.....**110**

KAPITULLI I KATËRT

Dobitë nga dashuria për Ehli Bejtin.....**115**
1. Dashuria e Ehli Bejtit, është dashuri për Allahun dhe në Allahun..... **116**
2. Njohja e së drejtës dhe siguria nga devijimi.....**118**
3. Kërkimi i plotësimit të fesë.....**118**
4.Bindja ndaj Allahut të Lartësuar dhe të Dërguarit të Tij.**119**
5. Kapja me lidhjen më të fortë.....**119**
6. Qetësimi i zemrës dhe pastrimi i saj.....**120**
7. Mençuria.....**120**
8. Kënaqësia në momentin e vdekjes.....**121**

9. Ndërmjetësimi në Ditën e Ringjalljes.....**121**
10. Pendimi, falja dhe pranimi i veprave.....**122**
11. Drita në Ditën e Ringjalljes.....**123**
12. Siguria prej tmerreve të Ringjalljes.....**123**
13. Hyrja në Xhenet dhe shpëtimi nga zjarri.....**124**
14. Tubimi me Profetin dhe familjen e tij.....**125**
15. E mira e kësaj bote dhe e Botës Tjetër.....**126**

KAPITULLI I PESTË

Ehli Bejti ndërmjet dashurisë së tepruar dhe urrejtjes.....**129**
Teprimi.....**130**
Shkaqet e përhapjes së Guluvit.....**131**
Thëniet e Gulatëve dhe fraksionet e tyre.....**133**
Qëndrimi i Ehli Bejtit ndaj Gulatëve.....**135**
Qëndrimi i dijetarëve imamit (shiit) ndaj Gulatëve.....**137**
Urrejtja e Ehli Bejtit.....**139**
Ndikimet e urrejtjes së tyre.....**140**
Ekuilibri në dashurinë ndaj Ehli Bejtit.....**142**

نام كتاب: مودة أهل البيت و فضائلهم في الكتاب و السنة

نويسنده: السيد تقي يوسف الحكيم

مترجم: ولنت مريا

ويرايش: ليسدا راماي

مقابله: ولنت مريا

صحافى: ولنت مريا

ناشر: جمعية النسيم

مودة أهل البيت و فضائلهم في الكتاب و السنة

المؤلف: **السيد تقي يوسف الحكيم**

المترجم: **ولنت مريا**

تيرانا 2013